Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (156) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDHI
në Peshkopi vjen me super oferta!

Profil

A jemi në kohë për të pritur "Rrugën e Arbërit"?

Nga **HAJREDIN TOCA**



Profil

Defrim Methasani respektoi veten dhe bashkëfshatarët

Nga **BASHKIM TUFA**



Profil

Beqir Demiri i Selanes

Nga **OSMAN XHILI**



REPORTAZH / Përshtypje dhe mbresa gjatë vizitës në kantieret e ndërtimit të Rrugës së Arbrit

Ëndrra po bëhet realitet

Me rrugën e vjetër, atë të stërzgjaturën, të lodhshmen dhe të shkatërruarën, po kthehemi në Tiranë. Vetëm se në mendjet tona ka zënë vend shpresa se në qershor 2021 Rruga e Arbërit do të përfundojë. Me këtë rrugë Dibra do të bëhet plotësisht një gjymtyrë e atdheut. Rruga, si një arterie në trupin e njeriut, do t'i japë krahinës jetë; do të zhvillohet bujqësia, do të rritet turizmi, do të marrë zhvillim gjithë ekonomia. Jeta në Dibër do të marrë të tjera përmasa. Ëndrra po bëhet realitet.

Nga **KAMBER FARUKU - FAQE 2 - 3**





Kthimi i Musait

Nuk ka veprimtari, sidomos në Tiranë, që lidhet me kulturën e sportin, ku emri i Musait të mos jetë i pranishëm me një kontribut sado të vogël. Dhe këtë nuk e bën se është i pasur e ka miliona në bankë, se të pasur e milionerë ka më shumë se ai, por ai ka një dashuri të madhe për vendlindjen, për Dibrën. Dhe gjithmonë e ka vrarë mendjen se çfarë duhet të bëjë. Dhe duket se e ka vendosur kthimin në vendlindje me një investim me një nga markat më të njohura në vend: Big Market.

Për shumëkënd, ndërsa shikon punimet në tunel dhe i duket e largët dita e përfundimit të punimeve, Musait i duket sikur ajo është hapur. Sepse ai u kthye në Peshkopi me një investim. Tani mbetet ta ndjekim ne të tjerët, duke investuar në ndërtim, turizëm, shërbime, industri, bujqësi e frutikulturë, për t'i dhënë një mundësi Dibrës për t'u zhvilluar ekonomikisht.

Faqe 13

12 MAJ 2019, KONFERENCA SHKENCORE

Rruga e Arbërit dhe perspektiva e zhvillimit ekonomik të Dibrës

Një grup qytetarësh, me iniciativën e shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", organizoi më 20 dhe 27 mars një ekskursion në Rrugën e Arbërit.

Grupi prej 30 vetësh, i udhëhequr nga ing. Bashkim Lleshi, njëri nga anëtarët e grupit të studimit të fizibilitetit si dhe aktivistë, më datë 20 mars ndoqën punimet te Ura e Vashës dhe tre tunelet pranë saj, si dhe rrugën që kalon nëpër Gjoricë, përfshirë edhe dy urat, atë mbi lumin Drin dhe Zalli i Bulqizës.

Ndërsa më 27 mars, megjithëse një ditë me shi, mbi 45 vetë u bashkuan për ekskursionin e dytë në Rrugën e Arbrit, në dalje të Tiranës deri te tuneli i Murrizit.

Qëllimi i ekskursioneve ishte vrojtimi i ecurisë së punimeve të Rrugës së Arbërit, pasi **më 12 maj 2019, shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" do të mbajë në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë një konferencë me temë "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me aksin kryesor të Rrugës së Arbërit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe turizmit historik e malor në Qarkun e Dibrës".** Konferenca do të fokusohet kryesisht në zhvillimin e degëve të ekonomisë, sidomos për zhvillimin e turizmit, bujqësisë e blegtorisë, të cilët nuk kanë pasur një zhvillim të qëndrueshëm për shkak të infrastrukturës rrugore.

Në referatet që do të mbahen, do të përshkruhet gjendja e rrugëve të brendshme brenda njësive përkatëse administrative, përmirësimi dhe ndërtimi i tyre (aty ku nuk ka rrugë) për t'u lidhur me aksin kryesor të Rrugës së Arbrit, për t'i shërbyer në të ardhmen zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë duke përshkruar shkurt, pasuritë nën tokësore e mbitokësore, pasuritë minerale, ujore, pyjore, kullotat, tokat arë për prodhimet bujqësore e frutikulturën, dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit historik e malor, duke përshkruar shkurt vendet historike të zonës dhe gjeomonumentet, hidromonumentet, biomonumentet dhe bukuritë e tjera natyrore që i ka falur natyra këtyre zonave të begata.

Gjithashtu, konferenca do të qartësojë nevojën e shtrirjes së Rrugës së Arbërit në territorin e Maqedonisë së Veriut, nga Bllata në Dibër të Madhe, Mavrovë, Gostivar.

Kjo konferencë është e dyta e kësaj shoqate e këtij niveli. E para ishte 12 vite më parë, në maj 2007, ku përmes referateve nga specialistë, u argumentua në mënyrë shkencore fizibiliteti plotësisht i justifikuar i ndërtimit të kësaj rruge.

NË BRENDËSI: Ç'kemi asaj Dibre ■ **Bulqizë**, menaxhimi i mbetjeve urbane, një problem që kërkon zgjidhje të menjëhershme ■ **Kalimi i pyjeve** të ulta në pronësi të banorëve po jep rezultatet e para pozitive ■ **Muharrem Gjoka**, burri i mirë i Dardhës dhe Dibrës ■ Tablo përmbledhëse e historikut të arsimit në **Okshtun** ■ Detaji artistik ■ Misionarja e 36 shkronjave ■ Më gjeni një qen! ■ Në dhé të huaj ■ Fjalë e frazeologjizma të rralla ■ **Turi i Luginës** së Shërimit ■ Arsimi në rrjedhën e viteve për qëndresë dhe përparim ■ Sali Jakup Hoxha – njeriu i kontributeve dhe sakrificave ■ Kur populli të ngre këngë, veprat dhe emri nuk shuhen kurrë ■ Nezir Selita, njeriu i mençur i Matit ■ Njeriu që zgjonte shatërvanë…

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (156). Maj 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Prill 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Kamber FARUKU
Xhafer MARTINI
Hajredin TOCA
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Selman MËZIU
Bashkim TUFA
Nazmi KOÇI
Nehat DACI
Shaqir ÇERPJA
Sefer DUKA
Renato TOTRAKU
Mevlud BUCI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Përshtypje dhe mbresa gjatë vizitës në kantieret e ndërtimit të Rrugës së Arbërit

Nga **KAMBER FARUKU**

Jam nisur për të vizituar kantierin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Ditë më parë lexova në rrjetin social Facebook një njoftim të postuar nga Demir Osmani, anëtar i Kryesisë së shoqatës “Lidhja e Intelektualëve Dibranë”. Dhe ja, ky postim ogurmirë, më lëvizi edhe mua herët në mëngjes në këtë fund prilli. Capita kodrinave të Shën Pjetrit mbi Qytetin Studenti, ku banoj, dhe zbrita në qendër të Tiranës e po pres në kafen në oborrin e pasmë të Pallatit të Kulturës. Aty përballë ndodhet stacioni i autobusëve.

Meqë të tjerët nuk kanë ardhur ende, po rrufis me nge një kafé.

Dhjetëra metra më tej prej këtu ku jam, është Rruga e Dibrës. Buron nga Sheshi Skënderbej dhe vazhdon drejt malit të Dajtit, duke kaluar pika orientimi si Te Selvija, Kafja e Rremës, Shkalla e Tujanit. Nga shkon më tej Rruga e Dibrës? Pse nuk të çon në Dibër, siç edhe emërtohet? Shumëkush mbledh krahët dhe nuk din të përgjigjet. Mbase emërtim historik prej Lagjes së Dibranëve, mbase... Në këtë rrugë vargu i pafund i makinave dhe autobusëve të çon te Qendra spitalore “Nënë Tereza”, në Tufinë. Por, jo në Dibër. Paçka se tabela shkruan: “RRUGA E DIBRËS”. Dhe është një ndër rrugët më të vjetra në Tiranë.

Po mendohem, duke parë atë pallatin katërkatësh në anë të Rrugës së Dibrës. Pasi del nga sheshi qendror i kryeqytetit, kalon një grumbull shtëpish të vjetra dhe të shëmtuara, të strukura njëra pranë tjetrës, të frikësuara nga ndryshimi modern i kryeqytetit, dhe menjëherë vjen ky pallat i ndërtuar në periudhën komuniste, me një stil të papranueshëm për kohën, Stili Kubik. Kur u dënua për agjitacion e propagandë nga Diktatura, thonë se arkitektit Maks Velo, në aktakuzë iu shënua edhe ky ndërtim “me shije borgjezo-revizioniste”. Tjetërkund tërhiqet vëmendja ime te ky pallat i Rrugës së Dibrës, aty ka shtëpinë shkrimtari ynë me famë botërore Ismail Kadare. Kadareja ka lidhje me Rrugën e Dibrës jo vetëm se aty kishte shtëpinë, por disa ngjarje të të rinjve të viteve 60-të në romanin “Dimri i vetmisë së madhe” i vendos pikërisht në Rrugën e Dibrës. Të rinjtë e Tiranës diskutonin me njëri-tjetrin në shëtitjet e përmbrëmshme pikërisht në një nga rrugët me emër të madh, por që ishte e mbyllur e nuk të çonte askund. Disa uzina dhe depo ushtrie, apo vendstrehime në Dajt në fund të Rrugës shënonte një përfundim apokaliptik të saj. Ja, Rruga e Durrësit shkonte në Durrës, ajo e Elbasanit në Elbasan. Po kështu Rruga e Kavajës. Kjo e Dibrës të çonte te Kafja e Rremës, por jo në Dibër. Hahaha! Përse nuk ia vunë emrin Rruga “Kafja e Rremës”?


Pamje nga punimet te Ura e Vashës

Te Ura e Re e Vashës të rrëmben fantazia. Si një ogur, si një simbol vetëflijimi për të tjerët, kjo Vashë e panjohur, si një Zanë Mali, e mbajti të pashuar ndjenjën e njerëzve për të kapërcyer e hapur malet, për t’u bashkuar e miqësuar me njëri-tjetrin. Pas Urës së Vashës vijnë edhe pesë ura të tjera të gurta me harqe, njëra pas tjetrës deri në Urën e Brarit, kur zbret në ultësirën e Tiranës.

Rruga e Dibrës mbeti një rrugë misterioze. Madje, po të llogarisësh se pas Kafes së Remës u ndërtua dhe Shkolla e Qenve, varreza e Tufinës dhe u vendosën tela me ferra, vërtet që kjo rrugë, rruga shekullore e Dibrës, u bë depresive, e paarritshme, e ftohtë, e huaj. Askush nuk mendonte më për të, nuk diskutoi për të deri në fillimin e viteve 90-të. Sikur ajo të mos ekzistonte. Studiuesi amator, mësuesi i pasionuar pas historisë, Iljaz Kaca, shkroi për këtë rrugë historike të dibranëve, për rrugë e vendbanime të shumta në trevën historike të Dibrës. Madje, ai e quajti Rruga e Arbërit. Kaq. Për më tej mendonte TJETËRKUSHI. Mos vallë Kadareja i vendosi jo rastësisht personazhet e tij rinorë në këtë rrugë të murosur, pa zgjatimin e saj natyral, në këtë rrugë-simbol të një jetë pa të ardhme, të izoluar? Edhe sikur gjithçka të ketë qenë rastësore, kjo rrugë ishte vendi i duhur për mesazhet e veprës së Kadaresë.

* * *

. . . Më shkëputi nga imagjinata këtë mëngjes me sytë te Rruga e Dibrës dhe Pallati i Kadaresë përshëndetja miqësore e Demir Osmanit. Pas pak në shoqërinë tonë erdhi prof. Bashkim Lleshi, bashkë me vajzën e tij, Anën. Hokatar, i qeshur, i veshur me një kostum sportiv. Profesori, inxhinier gjeolog, një ndër hartuesit e projektidesë së ndërtimit të Rrugës, na zgjat të gjithëve disa fletë me të dhëna mbi projektin e Rrugës së Arbërit dhe shtratin e saj historik e kulturor nga kalon. Ja dhe një burrë me trup të drejtë, flokë krejt të bardha, i veshur shik, që drejtohet drejt nesh. Eshtë Medi Dema.

- Profesori i gjuhësisë Enver Hysa nga Peladhia, - na njeh me të porsardhurin tjetër Zabit Lleshi. Profesori, me një trup atleti, i ka kaluar të 80-tat.

Një e nga një, mblidhemi rreth 30 vetë. Kryesisht të moshuar; inxhinierë, pedagogë, ekonomistë, mësues apo gazetarë e historianë. Të gjithë të ardhur aty, pa një shkresë të veçantë apo njoftim telefonik më vete. Thjesht, me dëshirën e madhe për të vizituar Rrugën e Arbërit, apo të Dibrës, siç edhe quhej historikisht. Për ta vizituar këtë rrugë në kantierin e saj të rilindjes moderne, nga rrugë e këmbësorëve dhe e mushkave luginave e shpateve të thepisura, në një rrugë të autobusëve, “benz”-ave e makinave të rënda me krom e mallra.

Autobusi ynë “Alb-Turist” futet menjëherë në Rrugën e Dibrës dhe, pas dhjetëra metrave, merr kthesën majtas te qoshja e Pallatit të Kadaresë në unazën e vogël, që rrethon sheshin “Skënderbej”, duke e lënë Rrugën e Dibrës në vetminë e vetë, morëm Rrugën e Durrësit. Dikush do të bënte habi edhe sot se përse ne lamë Rrugën e Dibrës të përplaset drejt Dajtit në Lindje dhe, për të shkuar në Dibër, marrim Rrugën e Durrësit nga Perëndimi. Kështu na ka dënuar historia ne dibranëve prej 107 vjetësh. Pas vitit 1912, me copëtimin e Shqipërisë, me përgjysmimin e Dibrës, për dibranët u mbyllën rrugët automobilistike për Gostivar, Tetovë e Shkup, për Strugë, Elbasan e Tiranë. Ngeli vetëm rruga e kuajve, e mushkave nga Qafë Murrizi e në Shkallën e Tujanit për të ardhur në Tiranë e Durrës. Në vitet ‘40-të Botorja italiane ndërtoi rrugën nga Rrësheni në Burrel, Klos, Bulqizë e Peshkopi. Dhe tjetrën nga Peshkopia në Lis dhe ura e Burrelit. Kaq mbeti për dibranët, shto këtu një shkurtim të gryka e Shkopetit rreth viteve 60-të. Prandaj autobusi ynë, edhe sot në vitin 2019 niset për Durrës, pastaj kthen nga Veriu për Shkodër, kthehet nga Verilindja për Mat dhe vetëm në Klos kthehet nga Lindja për Dibër.

Në Klos kthejmë djathtas dhe ngjitemi për te një prej kantiereve të ndërtimit të Rrugës së Arbërit, kantierin e Urës së Vashës. Kaluam një tunel dhe dolëm menjëherë te Ura e Re e Vashës, që po ndërtohet. Këmbët e kësaj ure, 150 m të larta, po afrohen drejt lartësisë së urës. Edhe tuneli i vogël në anën tjetër, që vjen nga fshati Plan i Bardhë, ka përfunduar. Ura do të jetë rreth 400 m e gjatë. Vërejmë që punohet në shumë fronte pune. Tuneli është i betonuar, me trotuare, pret vetëm asfaltin.

Inxhinieri nga Malësia e Madhe, Ermal Ramçaj, i shpjegon gazetarit Defrim Methasani se kjo urë, ndër veprat kryesore të objektit, më e gjata dhe më e larta, përfundon brenda këtij viti. -Konstruksionet e urës, - thotë inxhinieri, - janë gati. Ata do të vihen sapo të përfundojnë


Ura mbi Drin.

reportazh

Rruga e vjetër e Arbërit, e përshkuar dikur më këmbë dhe me kuaj, dhe kjo e reja, që po ndërtohet, do të jenë në një marrëdhënie të pandashme me njëra-tjetrën. Rruga e vjetër është historia, është kultura. Ajo është një atlas me vendbanime antike, kala të Skënderbeut si Petralba, me toponime e histori të pafundme. Historia e re, e ndërthurur me të vjetrën, do të bëjnë bazën e udhëtimeve turistike me guida të mirëstudiuara nga Hazis Keta me shokë.

Ëndrra po bëhet realitet



Një foto mbi urën e Drinit.

Rruga e re që po ndërtohet nuk prek gjurmën e rrugës së vjetër, nuk e "djeg" bibliotekën e saj. Rruga e re shpon malet tejpërtej me 6 tunele me rreth 5 km gjatësi. Më i madhi, ndërtimi kryesor i Rrugës së Arbërit, është tuneli i Murrizit me 3246 m gjatësi. Inxhinieri Mark Pepkola i shpjegon botuesit të gazetës "Rruga e Arbërit" Musa Rriçku, se po punohet pa u ndalur në dy tunelet, kryesorin dhe atë të emergjencës. Deri më tani është ecur me 550 metra thellësi nga ana e Tiranës. Së shpejti do të punohet edhe në anën tjetër.

kamat. Po ecet pa asnjë pengesë dhe vonesë, sipas objektivit të kompanisë "Gjoka".

Pothuaj të gjithë pjesëmarrësit, me telefonat e tyre vrapojnë të bëjnë foto, duke kërkuar këndet më të përshtatshme për Urën apo duke dalë me njëri-tjetrin me sfond kantierin.

Në hyrje të tunelit, ngjitur me urën, masivi shkëmbor del si kapele kaubojsi.

- Këtu do të zgjatet tuneli me mbulesë betoni për të pasur siguri nga ndonjë rënie guri, - thotë specialisti dibran Gëzim Demiri, me origjinë nga Katër Grykët.

Hysen Uka më tërheq mënjanë dhe më nxjerr pak më poshtë te një kthesë, qe zbret poshtë te këmbët e urës. Zgjat dorën drejt luginës:

- Shih atje te lugina, duket një pjesë e harkut të Urës së Vashës.

Letrar dhe publicist, i dhënë shumë pas arkeologjisë dhe historisë, Hyseni është ndër maratonomakët e parë që rendi në gjurmët e Rrugës së Arbërit. I bëri këto përpjekje me dashuri të madhe për Dibrën, organizoi ballafaqime të vazhdueshme me qeveritarët e radhës dhe organizoi peticione kohë pas kohe. Kjo arritje sot, ndërtimi i Rrugës së Arbërit, ka brenda dhe lodhjen intelektuale e fizike të Hysenit. Ai e ka shkelur Rrugën shteg më shteg e shkrep më shkrep disa herë. Gjurmët e kësaj rruge, me dëshmitë e saj historike, e frymëzuan në pandalje atë.

- Jo, nuk bëra asgjë. Rrugën e projektuan, e ndërtuan dhe e shkelën në shekuj gjyshërit tanë. Ne e gjetëm të gatshme, - thotë Hysen Uka.

Te Ura e Re e Vashës të rrëmben fantazia. Si një ogur, si një simbol vetëflijimi për të tjerët, kjo Vashë e panjohur, si një Zanë Mali, e mbajti të pashuar ndjenjën e njerëzve për të kapërcyer e hapur malet, për t'u bashkuar e miqësuar me njëri-tjetrin. Pas Urës së Vashës vijnë edhe pesë ura të tjera të gurta me harqe, njëra pas tjetrës deri në Urën e Brarit, kur zbret në ultësirën e Tiranës. Urat kanë emrat e tyre. Ura e Hoxhës. Ura e Kulmares. Ura e Gurrës. Po ky emër i veçantë, Ura e Cime Toskës?! Ndofta, një specialist nga Toskëria e ndërtoi. Dhe, nuk u harrua Cime Toska, sepse ai i lidhi e shtyu përpara karvanët e jetës. Erdhi Cimja drejt Veriut dhe aty ngurtësoi pavdekësinë e tij. Siç vrapoi drejt Veriut edhe një Gegë dhe mbeti i pavdekshëm me tunelin e Semeringut në malet austriake. A mund të krahasohet Cime Toska me një urë modeste në fshatin Gur i Bardhë me Karl Gegën e madh? Po, krahasohet. Përgjigjen na e jep Nënë Tereza: "Bëni gjëra të vogla, por me një dashuri të madhe". Këtë rrezaton Ura e Cime Toskës kur shkel mbi të, dashurinë njerëzore. Se këto ura madhështore përcollën dibranët për në Jalli dhe i shoqëruan edhe në kthim. Në shi e në furtunë, në verë e në dimër. Urat janë një gjerdan sermi në kraharorin e Rrugës së Arbërit. Në këto ura të njëpasnjëshme guri këndohen balada të brezave që shkelën mbi ta, ata janë korda muzikore të lumturisë dhe mjerimit njerëzor. Ja, anas Rrugës është Varri i Dibranit. Kush ishte ky njeri? Emri i tij tashmë dihet nga të gjithë. Ai quhet Dibran. Urat mund të të tregojnë më tej; si u vra pas shpine apo mbeti nga i ftohti. Kishte një copë bukë misri me qepë e gjizë me vete apo deshën t'i marrin një kusi bakri, që e mbante në krah. Apo e vrau mushka?. . .

Më 1913-tën kobzezë, duke lënë prapa flakë e shkrumb nga hordhitë serbe, dhjetëra-mijëra qytetarë të Dibrës së Madhe dhe krahinave përreth kaluan në këto ura në një rrugë pa kthim. Shkrimtari Haki Stërmilli shkruan se në qytetin e Dibrës kasaphana, që përdorej për therje bagëtish, u kthye nga kanibalët serbë në vend ku thereshin njerëzit. Kjo rrugë atëmot përcolli një nga dhembjet më të mëdha, që ther edhe sot në palcën e kombit shqiptar.

Por, Rruga e Arbërit, përcillte edhe personazhe si Tokërr Qoka nga Muhurri. Tokrri ishte një burrë shpatullgjerë, me mustaqe të mëdha të varura dhe të përskuqura nga tymi i duhanit. Sepse rrallëherë e shihnin Tokrrin pa një llullë të madhe, që e shtrëngonte mes dhëmbëve. Ndofta vetëm kur flinte e hiqte llullën me duhan. Tokrri e bënte shpesh rrugën nga Qafë Shtama e Qafë Murrizi për Tiranë. Një rast, sa mori vesh se ishte në Tiranë edhe Dine Hoxha, shkon dhe e takon te hani i tij ku banonte dhe i drejtohet gjithë pompozitet:

- Aga, ndize n'këtë zjarm Dibre!

Tokrri nuk gënjente, për dy ditë me radhë nuk e kishte fikur llullën me duhan.

* * *

Rruga e re që po ndërtohet nuk prek gjurmën e rrugës së vjetër, nuk e "djeg" bibliotekën e saj. Rruga e re shpon malet tejpërtej me 6 tunele me rreth 5 km gjatësi. Më i madhi, ndërtimi kryesor i Rrugës së Arbërit është tuneli i Murrizit me 3246 m gjatësi. Inxhinieri Mark Pepkola i shpjegon botuesit të gazetës "Rruga e Arbërit" Musa Rriçku se po punohet pa u ndalur në dy tunelet, kryesorin dhe atë të emergjencës. Deri më tani është ecur me 550 metra thellësi nga ana e Tiranës. Së shpejti do të punohet edhe në anën tjetër.

- Tunelin do e përfundojmë 6 muaj para afatit, - thotë Marku. Ne, që jemi të pranishëm atje, shikojmë njëri-tjetrin. Na u duk Marku si një personazh i 50 viteve më parë. Urojmë te dalë siç thotë inxhinieri, por jemi të kënaqur ta përfundojë edhe në afatin sipas projektit.

Rruga e vjetër e Arbërit, e përshkuar dikur më këmbë dhe me kuaj, dhe kjo e reja, që po ndërtohet, do të jenë në një marrëdhënie të pandashme me njëra-tjetrën. Rruga e vjetër është historia, është kultura. Ajo është një atlas me vendbanime antike, kala të Skënderbeut si Petralba, me toponime e histori të pafundme. Historia e re, e ndërthurur me të vjetrën, do të bëjnë bazën e udhëtimeve turistike me guida të mirëstudiuara nga Hazis Keta me shokë.

... Doktori i Shkencave Gjeologjike Vesel Hoxha sikur mediton më vete. Ai vëren formacionet brenda tuneleve, format e maleve përreth, lexon nëntokën. Të hyrja e tunelit të dytë shmanget dhe filmon një shpat mali.

- Mrekulli, shikoni si është vendosur mbi gëlqeror shtresa tjetër më e re. Ky është një rast tipik i dukshëm dhe i qartë. Më duhet për ilustrim në fakultet, - thotë.

* * *

Ndahemi nga kantieri i Urës së Re të Vashës. Pasi kalojmë Qafën e Buallit, ku ka përfunduar një tunel i shkurtër, autobusi ynë rrëshqet luginës së Bulqizës, në 17 km e përfunduara të Rrugës.



Pamje nga Tuneli i Murrizit

Kur rruga shmanget në anën tjetër të luginës, përballë fshatit Dragu, ing. Bashkim Lleshi na shpjegon se projekti i Rrugës së Arbërit parashikonte kalimin drejt në fund të fshatrave Dragu, Valikardhë e Fushë Bulqizë, deri te Ura e Xhitetit dhe jo këtej nga ish-rruga e vjetër. Rruga do të ishte e drejtë dhe në anën e diellit, nuk do të kishte bllokim të saj gjatë dimrit. Sepse këtu dimri është shumë i egër. Edhe fshatrat do e kishin rrugën ngjitur. Edhe te fshati Peladhi rruga nuk do të ngjitej lart rrugës së vjetër, por do të shkonte drejt ngjitur me Zallin e Bulqizës dhe do të dilte në Krajkë, ku del sot deri te Tre Çezmat e Zerqanit. Do të ishte shumë më panoramike dhe turistike.

- Pse nuk u bë kështu, - e pyet dikush.

- Këtë nuk e di, - përgjigjet Bashkimi.

Një pamje mbresëlënëse na shfaqet në hyrje të Shupenzës, qindra metra më poshtë Urës së Çerenecit, ura për në Gjoricë ka përfunduar. Është një urë e gjatë 212 m. Shëtisim pak mbi urë dhe bëjmë foto me njëri-tjetrin edhe këtu. Përsëri nisemi. Rrëshqasim në një rrugë të drejtë anas fshatrave të Gjoricës dhe ndalemi buzë lumit Drin. Atje na pret ura tjetër mbi lum, e përfunduar edhe ajo dhe që të nxjerr në skajin fundor të Rrugës së Arbërit, në Bllatë, afër doganës me Maqedoninë e Veriut. Nga Tirana duhen rreth 70 km për të arritur këtu. Dhe, deri në Peshkopi, 80 km. Një realitet që na mbush të gjithëve me një gëzim të brendshëm. Është nënshtruar Drini, ky lum i madhërishëm, i gjerë, i sertë. Pakkush e besonte, po ja, urën e kemi përpara, e gjatë rreth 300 m, me trotuare. Shëtisim mbi të, dalim në anën e përtejme. Të gjithë bashkë bëjmë një foto mbi urë. Botuesi dhe gazetari Bujar Karoshi me të shoqen, Mirandën, nuk pushon duke bërë foto e filmime për të plotësuar arkivën e tij shumëvjeçare të Rrugës së Arbërit.

* * *

Në rrugën e kthimit, mes pishave në Bulqizë, na ndalin për një kafe festive ing. Osman Miha me vëllanë e tij, biznesmenin Latif Miha. Çuditërisht, tryeza është e plotësuar me përfaqësues nga të gjitha krahinat e Dibrës. Që nga Lura me Osman Vladin, Golloborda me Agim Kasën e deri nga Baldushku i Tiranës me Rrahman Dapin. Kjo përzgjedhje ishte krejt e rastit. Një grup i bashkuar me zemër. Latif Miha na shtroi një drekë tek Pishat e fshatit Dragu, që shërbeu jo vetëm si çlodhje, por edhe u këmbyen disa mendime për ecurinë e Rrugës së Arbrit, duke e gjallëruar më shumë veprimtarinë e asaj dite.

Me rrugën e vjetër, atë të stërzgjaturën, të lodhshmen dhe të shkatërruarën, po kthehemi në Tiranë. Vetëm se në mendjet tona ka zënë vend shpresa se në qershor 2021 Rruga e Arbërit do të përfundojë. Me këtë rrugë Dibra do të bëhet plotësisht një gjymtyrë e atdheut. Rruga, si një arterie në trupin e njeriut, do t'i japë krahinës jetë; do të zhvillohet bujqësia, do të rritet turizmi, do të marrë zhvillim gjithë ekonomia. Jeta në Dibër do të marrë të tjera përmasa. Ëndrra po bëhet realitet.

Prill 2019

Është koha, për të menduar e punuar për të ardhmen, për biznes në bujqësi me mundësitë që do të afrojë Rruga e Arbrit.



A jemi në kohë për të pritur **“Rrugën e Arbërit”?**

Nga **HAJREDIN TOCA** *

Nuk do të flas për rëndësinë e kësaj rruge mbasi kanë folur shumë akoma pa u bërë. Askush nuk duhet të dyshoj për rëndësinë e saj por mua më duket se flitet vetëm në një drejtim ose vetëm për të tërhequr vëmendjen e publikut në momente të veçanta. Thuhet se rruga do të sjell shumë të ardhura sikur ajo do punojë e ne do e vjelim. Mendoj se njerëzit duhet të kuptojnë se sot duhet të flitet për kosto jetese e kosto biznesi e se rruga do të zvogëlojë koston e jetesës, do zvogëlojë koston e biznesit. Por gjithmonë kur e ke nisur mbarë një të tillë. Dhe akoma më mirë kur përfundimi i rrugës e gjen këtë biznes të ngritur. Dhe një ndër burimet më të mëdha të zonës nga kalon “Rruga e Arbrit” është **bujqësia dhe pasuria natyrore e këtij vendi**. Prandaj mendoj se rruga duhet ti gjej dibranët atje e jo të presin që të shkojnë pasi të jetë bërë rruga.

Kur është publikuar projekti i “Rrugës së Arbrit” në materialin prezantues thuhet: “Rruga e Dibrës, e quajtur Rruga e Arbrit, rrugë aq e pasur me histori, parashikohet të jetë një ndër rrugët më të bukura turistike në trevat shqiptare”.

Rruga padyshim do të sjellë turistë nga gjithë vendi, por dhe të huaj, të cilët janë të prirur të shikojnë vende të pashkelura. Por sapo themi që do të jetë tërheqëse për turistët menjëherë të shkon ndërmend se çfarë do t’ju ofrojnë turistëve zonat nga kalon ose zonat që kjo rrugë i afron me turistët. Natyrisht që çdo vizitor do të shikoj një peizazh natyror që se ka parë ndonjëherë, një natyrë e virgjër, por jo e bukur, një rrugë e vjetër që në lashtësi, por pa objekte arkeologjike të zbuluara për t’i vizituar, një rrugë që përshkon ultësira lumenjsh, kodra e male, që duhet të jenë të veshura nga pyjet e anash saj një bujqësia e zhvilluar. Realiteti për fatin tonë është jo i mirë. Edhe më parë por dhe për këto njëzetetetë vite zona nga kalon “Rruga e Arbrit” dhe zonat që ajo afron me kryeqytetin janë zhvilluar shumë pak por dhe janë shkatërruar e dëmtuar nga dora e njeriut direkt ose indirekt pa menduar se një ditë do pendohen të gjitha palët.

Zonat nga kalon “Rruga e Arbrit”: ato të Malësisë së Tiranës, të Matit, të Klosit, të Bulqizës, të Maqellarës, të Peshkopisë e deri në Çidhën, në vendlindjen e Kastriotëve, duhet të nxitojnë për të punuar sa më parë për t’a ndryshuar pamjen e saj me projekte konkrete të familjeve, projekte të bizneseve dhe të projekteve nga qeveria.

Ka projekte për zhvillimin e bujqësisë në këto zona si ai i arroreve, i bimëve aromatike, pemtoreve, etj. Këto zona kanë një peizazh që të jep mundësinë që këto projekte të mund të vihen në zbatim. Mirëpo nuk duhet kthyer qëllim i menjëhershëm mbjellja për një objektiv të vënë dhe me rezultat të pritshëm as 50% se fondet shkojnë dëm e zonat ngelen në vendnumro.

Kam dëgjuar që ka projekte zhvillimi për çdo njësi vendore në Dibër që po të zbatohen do të ndihmojnë shumë, por unë dua të tërheq vëmendjen e të gjithë atyre që jetojnë apo kanë prona në krahinën e Dibrës. Ç’do njëri prej tyre duhet të ketë një projekt personal për shpinë, për tokën që punon sot dhe për atë që e ka lënë për ta punuar ndoshta nesër, për territorin rreth e qark shtëpisë. Por, e para punë që duhet zgjidhur për të patur një projekt të zbatueshëm është në çfarë gjendje e ke tokën, terrenin ku ke shtëpinë. Për mendimin tim është problemi i parë që duhet zgjidhur për zonat që përshkon e afron “Rruga e Arbrit”.

Toka dhe terreni në të dy anët e rrugës si dhe në fshatrat e Dibrës janë në një gjendje jo të mirë sepse menaxhimi i tyre është bërë në mënyrën më të keqe të mundshme “sepse pyjet u prenë, lumenjëve ju morën inertet atje ku bëhet më shumë dëm, në faqet e kodrave u hapën gurore pa fund, e m’u poshtë shtëpive tona, pritat e lumenjve u shkatërruan, e ndërtimet e tyre ngelën në letër, dhe ndoshta fondet janë harxhuar për një pritë që s’ekziston. Dhe në rastet e pyllëzimeve, për të luftuar erozionin, nuk është mbjellë në vendet ku duhet, tek përroi i krijuar apo tek méja e shembur, por në arat kur dikur mbilleshin me grurë e misër.

Kjo gjendje ka shtuar fenomenin e erozionit që është një zinxhir që fillon nga minipërrenjtë tek përrenjtë dhe këta tek lumi, të cilët kanë marrë me vete jo vetëm tokë por dhe gurë e drurë.

Kjo ka bërë një rritje të nivelit të lumit duke e sjell atë me lart dhe ai (lumi) i është sulur tokës më të mirë dhe po e merr me vete. Kush kalon sot luginës së Drinit nga Maqellara në Reç do shoh një lum që ecën për qejf të vet. Ka vënë përpara tokat e Luznisë, të Muhurrit e Vaj-Mëdhej, e të Sinës, dhe Kishavecit, po i shkon në shpi. Kthehet Drini sa në tokat e Mustafe e në Fushë-Alie dhe me gjithë furinë e vet po e vé Zall-Dardhën përpara. Lugina e Drinit të Zi ka qenë në shekuj një “hambar i drithit” jo vetëm për Dibrën por dhe për krahinat rreth saj. Por mos ndoshta është lënë qëllimisht për ti ulur vlerën në pritje të një hidrocentrali që do të groposte gjithçka nga pasuria e dibranëve dhe do varroste dhe investimet e harxhuara për projekte e për prita që s’u bënë kurrë.

Zgjidhja bëhet duke u përqëndruar tek hallka e fillimit që janë përrenjtë që sot në shumë zona në të gjithë Shqipërinë janë kthyer në hone ku jo vetëm shtëpitë por edhe njerëzit po thyejnë qafën.

Sistemimi i përrenjëve me prita është baza ku duhet të përqendrohet gjithë vëmendja e shtetit me projekte për subvencione në bujqësi për pemëtore e pyllëzime të cilat pa këto prita nesër do të përfundojnë në det. Ashtu si një shtëpi nuk bëhet pa themele edhe një investim në bujqësi nuk bëhet pa mbrojtur tokën mbi të cilin bëhet ky investim. Dhe kuptohet që një pemëtore e çdo lloj është një investim afatgjatë.

Qeveria bën mirë që të financoj “infrastrukturë” për tokën, sidomos për mbrojtjen e saj nga erozioni. Dhe është rasti të filloj me “Rrugën e Arbrit” ku në të dy anët e rrugës, nga një km thellësi, të projektohet pyllëzimi i saj me drufrutorë e pyjorë sipas një studimi përshtatur me tokat dhe terrenin. Dhe ta vazhdoj me Luginën e Drinit të Zi për në Vendlindjen e Skënderbeut (Sinë) që natyrisht do të jetë një vend tërheqës për turistë e vizitorë të shumtë.

Nga ky objektiv për të mbrojtur tokën nuk duhet të përjashtohet askush qoftë ai që jeton aty qoftë ai që ka pronën, por sot është larguar. Secili duhet të bëj mbrojtjen e tokës e të pronës së vet të paktën deri 50 metra larg saj dhe të mendoj për ta pyllëzuar e mbjell sipas rastit.

Kush kalon sot nëpër terrenin ku kalon “Rruga e Arbrit” vë re përrenj të vegjël e të mëdhenj që nuk është e vështirë ta llogarisë kushdo se sa sipërfaqe zë erozioni. Bëni një foto të këtij tereni dhe matni sipërfaqen e gërryer e pa bimësi dhe nxirrni përqindjen që zë kjo ndaj sipërfaqes së fotos dhe jam i bindur se i afrohet 50%-it, pra gjysmës. Kjo do të thotë se një turist që do të kaloj andej nuk do ti kënaqet syri duke parë një natyrë të shkatërruar si kjo. Ai nuk vjen për rrugën (se rrugë ka njëqind herë më të mira se tonat) por për natyrën, dhe atë e do të bukur ndryshe nuk vjen më.

Krahpërkrah me luftën kundër erozionit të vazhdoj mbjellja e pemëve frutore (mollë dhe dardha vendi, arra dhe lajthi, etj.) që zona e Dibrës i ka traditë. Por dhe i kulturave të tjera që zona i kultivon prej shekujsh e me emër siç është fasulja shoqëruese, misri gushtak, perimet jashtë sezoni kryesisht ato të vonshme.

Banorët e zonave të Dibrës që jetojnë por dhe ato që kanë pronat atje duhet më së pari duhet të bashkojnë tokat sipas vëllazërisë dhe të konsultohen me specialistët e bujqësisë të të gjitha degëve pastaj të mbjellin atë që duhet, se, mbjelljet bëhen për të fituar, e jo për ti shpenzuar lekët se duhet plotësuar ky projekt apo ai projekt i qeverisë.

E rëndësishme është dhe mënyra se si ju tregtojmë produktet tona. Sot mosbesimi për atë që blejmë është i madh dhe sidomos tek perimet dhe frutat. Nuk besojnë se i ke vjelur nga pemëtorja apo kopshti yt kur tregton në rrugë. Mendoj që të kalohet në formën që vizitori ti vjelë vet ato në pemëtore dhe në kopsht. Besueshmëria do shkoj në vend dhe kërkesa për produkte do rritet nga viti në vit. Kjo mund të thuhet dhe për blegtorinë e zonës.

Unë kam për detyrë, meqenëse e njoh tokën e Dibrës, vendin ku linda e punova shumë vite, për të këshilluar se është koha, për të menduar e punuar për të ardhmen, për biznes në bujqësi me mundësitë që do të afrojë Rruga e Arbrit.

Kultura e punës nuk ju mungon dibranëve, por duhet t’ja kërkoj këtë kulturë në radhë të parë vetes, biznesit dhe qeverisë dhe jo të zbatoj qorrazi projekte që përfundojnë në një thes miell, një kosh me arra apo në një gotë çaj boronicë.

Prandaj, sot duket se është vonë, por unë mendoj që jemi përsëri në kohë, nëse fillojmë të interesohemi për të rritur vlerat e pasurive natyrore të Dibrës që përpjekjet të mos përfundojnë e të ngelen vetëm si sllogan: “E dua Dibrën».

** Autori është Doktor në Shkencat e Mbrojtjes së Bimëve.*

Sot mosbesimi për atë që blejmë është i madh dhe sidomos tek perimet dhe frutat. Nuk besojnë se i ke vjelur nga pemëtorja apo kopshti yt kur tregton në rrugë. Mendoj që të kalohet në formën që vizitori t’i vjelë vetë ato në pemëtore dhe në kopsht. Besueshmëria do të shkojë në vend dhe kërkesa për produkte do rritet nga viti në vit.

Kultura e punës nuk ju mungon dibranëve, por duhet t’ja kërkoj këtë kulturë në radhë të parë vetes, biznesit dhe qeverisë dhe jo të zbatoj qorrazi projekte që përfundojnë në një thes miell, një kosh me arra apo në një gotë çaj boronicë.

Prandaj, sot duket se është vonë, por unë mendoj që jemi përsëri në kohë, nëse fillojmë të interesohemi për të rritur vlerat e pasurive natyrore të Dibrës që përpjekjet të mos përfundojnë e të ngelen vetëm si sllogan: “E dua Dibrën».

probleme

Duhet të hartohet plani i menaxhimit të mbetjeve urbane për të gjithë territorin e bashkisë Bulqizë, duke u bazuar në planin kombëtar

Bulqizë, menaxhimi i mbetjeve urbane, një problem që kërkon zgjidhje të menjëhershme

Vëzhgimi në terren ka konstatuar se mbledhja e mbetjeve realizohet në mënyrë të përditshme në qytetin e Bulqizës, ndërsa më rrallë në njësitë administrative. Ndërsa në Trebisht nuk mblidhen fare, duke i lënë mbetjet të hedhura në mjedis të hapur, rrjedhimisht duke sjellë ndotje në tokë, ujë dhe në ajër.

Duhen marrë masa për mirëfunksionimin e landfillit në Qafën e Buallit si dhe ndalimin e djegieve të tyre. Duhet të hartohet plani i menaxhimit të mbetjeve urbane për të gjithë territorin e bashkisë, duke u bazuar në planin kombëtar, fillimi me ndarjen e mbetjeve në burim, rehabilitimi i vend-depozitimit aktual, dhe ndërtimi i një landfilli të ri, ku të trajtohen mbetjet e territorit të Bulqizës. E gjitha kjo duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit, transparencë financiare, projekte dhe programe, me qëllim rritjen e cilësisë së këtij shërbimi.

Pa kontributin e banorëve, përpjekjet tona për një mjedis të pastër e të shëndetshëm do të bëhen gjithmonë e më të vështira

"Menaxhimi i Mbeturinave Urbane në Bulqizë është një ndër problemet kryesore që sot përballet Bashkia Bulqizë, duke u kthyer në një burim te ndotjes së mjedisit, tokës, ujit dhe ajrit. Në të shumtën e rasteve kontenierët janë të tej mbushur dhe përreth tyre ka mbeturina. Banorët ankohen shpesh për mbetjet që nuk pastrohen përditë, numrin e pakët të kontenierëve dhe mungesa e hapësirave të veçanta për hedhjen e mbetjeve. Gjithashtu gjendja e kontenierëve është në kushte jo të mira. Në qytetin e Bulqizes nuk ka një plan të mirëfilltë për menaxhimin e mbetjeve urbane».

Këto janë disa nga konstatimet e organizatës mjedisore "Ekspertët e Rinj Mjedisor" - SHERM, e cila gjatë periudhës 1 gusht 2018 - 30 prill 2019 realizoi projektin "Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Bulqizë", mbështetur financiarisht nga Lëviz Albania.

Organizata ka marrë kontakte me drejtues lokalë, qytetarë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile, të cilët janë të interesuar për një mjedis të shëndetshëm. Në trajnimet e zhvilluara dhe takimet në terren janë marrë mendime nga më shumë se 200 persona.

Drejtuesi i organizatës, Daniel Bica, thotë se "kemi evidentuar se nga ana e strukturave të bashkisë Bulqizë ka mangësi të theksuara për sa i përket planifikimit, menaxhimit, transparencës, edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve urbane. Këtë shërbim bashkia Bulqizë e ofron nëpërmjet Ndërmarrjes së





Shërbimit Publik, e cila është në vartësi të saj, pra përgjegjëse për cilësinë e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane".

Projekti, i cili u mbyll muajin e kaluar, synonte të monitorojë dhe vlerësoje bashkinë Bulqizë për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, diferencimin e shërbimit në zonën urbane kundrejt asaj rurale, gjenden e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale etj.

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një ndër problemet kryesore të ditëve të sotme në të gjithë vendin si pasojë e mosfunksionimit si duhet të sistemit të menaxhimit të mbetjeve, detyrë kjo e përcaktuar në bazë të legjislacionit shqiptar për qeverisjen vendore.

Nga studimet e kryera ka rezultuar se llojet e disponueshme të mbetjeve urbane në Bulqizë janë kryesisht mbetje si: organike,dru, letër, plastikë, qelq, tekstile, metale, mbetje nga shëndetësia, goma, inerte, produkte sanitare, elektrike, pajisje elektronike, bateri dhe produktet nga kafshet etj.

"Problematikat e ndryshme të mosfunksionimit të këtij sistemi për bashkinë e Bulqizës janë identifikuar dhe paraqitur në mënyrë të shkurtuar në raportin e realizuar, thotë Danjel Bica. Gjatë monitorimit në terren grupi i punës ka ndeshur një sërë problematikash. *"Ndërmarrja e Shërbimeve Publike"* nuk e ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe financiar, për shkak të terrenit të vështirë, infrastrukturës së dobët, largësia nga qyteti i Bulqizës e bën shumë të vështirë menaxhimin e mbetjeve në 7 Njësitë Administrative sidomos në kohën e dimrit".

"Bashkia e Bulqizës është e përbërë nga 7 njësi administrative: Krastë, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren, Trebisht. Objektivi i parë i projektit ka qenë "realizimi i një monitorimi qytetar për cilësinë e shërbimit të pastrimit në bashkinë Bulqizë". Për realizimin e këtij objektivi janë zhvilluar aktivitete në funksion të realizimit të tij, duke bërë bashkë të gjithë aktorët lokalë, administratën e njësive administrative, shoqërinë civile, grupet monitoruese, përfaqësuesit me influencë politike, anëtarët e këshillit bashkiak si dhe grupe të tjera interesi. Aktivitetet janë realizar sipas planifikimit dhe nuk është gjykuar dhe s'ka patur arsye për ndryshimin e planifikimit të aktiviteteve. Grupi i punës është trajnuar për mjetet, metodat, raportimet, praktikat gjatë monitorimit", shkruhet në raportin final të organizatës SHERM.

Problematikat e ndryshme të mosfunksionimit të këtij sistemi për bashkinë e Bulqizës janë identifikuar dhe paraqitur në mënyrë të shkurtuar në raportin e realizuar, thotë Danjel Bica. Gjatë monitorimit në terren grupi i punës ka ndeshur një sërë problematikash. "Ndërmarrja e Shërbimeve Publike" nuk e ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe financiar, për shkak të terrenit të vështirë, infrastrukturës së dobët, largësia nga qyteti i Bulqizës

Për të bërë monitorimin në 7 Njësitë Administrative dhe në Bashkinë Bulqizë janë angazhuar një grup qytetarësh prej 25 personash, të cilët kanë monitoruar për një periudhë kohore 5 muaj situatën reale në terren kanë bërë foto, video, marrjen e kordinatave për pikat e nxehta ne terren dhe raportimin e tyre pranë institucioneve vendimmarrëse.

"Nga monitorimi i realizuar ka rezultuar se sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Qytetin e Bulqizës është 0.5-0.6 kg/banorë në ditë", thotë Bica.

PROBLEMATIKAT

Grumbullimi i mbetjeve realizohet nëpërmjet depozitimit të tyre në kontejnerë. Pjesa më e madhe e mbetjeve janë mbetje urbane dhe mbetje inerte dhe një sasi e vogël të mbetjeve spitalore. Kontejnerët janë të një kapaciteti prej 800-1000 litrash, me ngjyrë jeshile dhe nuk funksionon as sistemi i mbylljes dhe as sistemi i frenimit.

Një element shumë i rëndësishëm është edhe prezenca e kafshëve, kryesisht qen, të cilët shkatërrojnë qeskat me mbetje duke përbërë një rrezik real për popullsinë e zonës dhe duke qenë se në asnjë rast nuk bëhet dezinfektimi i kontejnerëve nga ana e bashkisë.

Të gjithë mbetjet, sidomos mbetjet e qytetit, shkojnë në venddeponinë e qytetit, i cili ndodhet në Qafë të Buallit dhe është ndërtuar në fillim të viteve 2000. Aty derdhen në mënyrë të pakontrolluar dhe nuk sistemohen në parcela, me qëllim sistemimin, ngjeshjen dhe mbulimin e tyre. Në shumë rast ato digjen, duke u kthyer kështu në rrezik për shëndetin e banorëve.

KONKLUZIONET E PROJEKTIT

"Shërbimi i grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve funksionon vetëm për qytetin e Bulqizës në mënyre të rregullt, por pa u bërë ndarja e mbetjeve në burim, mbetjet grumbullohen së bashku në një kontejner", thotë Danjel Bica.

Në konkluzionet e raportit shkruhet gjithashtu se "ky shërbim ofrohet në qendër njësi dhe në disa fshatra përreth, jo në gjithë njësitë dhe cilësia e shërbimit është e dobët. Aty ku ofrohet shërbimi rezulton që të ketë kontejnerë grumbullimi pa kapakë, pa sistem frenimi, sistemi i lëvizjes funksionon me vështirësi dhe në asnjë rast nuk bëhet dezinfektimi i tyre".

Më e rëndësishme, thekson Bica, është që gjithçka të kryhet përmes bashkëpunimit me komunitetin.
Pa kontributin e banorëve, përpjekjet tona për një mjedis të pastër e të shëndetshëm do të bëhen gjithmonë e më të vështira.



Vëzhgimi në terren ka konstatuar se mbledhja e mbetjeve realizohet në mënyrë të përditshme në qytetin e Bulqizës, ndërsa më rrallë në njësitë administrative. Ndërsa në **Trebisht nuk mblidhen fare, duke** i lënë mbetjet të hedhura në mjedis të hapur, rrjedhimisht duke sjellë ndotje në tokë, ujë dhe në ajër.

"Duhen marrë masa për mirëfunksionimin e landfillit në Qafën e Buallit si dhe ndalimin e djegieve të tyre, thotë Bica. Gjithashtu është e nevojshme një komunikim më i mirë mes banorëve dhe qeverisë lokale, për të bërë të mundur një mirëmenaxhim të mbetjeve në të ardhmen".

SI TË PËRMIRËSOHET SITUATA?

Drejtuesi i projektit, Danjel Bica, thotë se për në mirëmenaxhim më të mirë duhet në radhë të parë një informim më i mirë dhe më i qartë i publikut. Duhet të bëhet ndarja e shërbimit të pastrimit nga shërbimet e tjera, ofrimi i këtij shërbimi në të gjitha njësitë vendore sipas ligjeve në fuqi, shtrirja e menjëhershme e shërbimit në ato fshatra ku infrastruktura është e mirë, shtimi i kontejnerëve dhe vendosja e taksës për këtë shërbim, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e tij dhe të mbajmë pastër mjedisin etj.

Bica thotë se emergjenca është një pastrim i menjëhershëm i mbetjeve në ato fshatra që janë buzë lumenjve dhe rrjedhave ujore. Situata është alarmante në disa njësi vendore, pasi mbeturinat hidhen në lumenj, digjen, ose dekompozohen në natyrë, duke u kthyer në vatra infeksioni.

Gjithashtu, duhet të hartohet plani i menaxhimit të mbetjeve urbane për të gjithë territorin e bashkisë Bulqizë, duke u bazuar në planin kombëtar, fillimi me ndarjen e mbetjeve në burim, rehabilitimi i vend-depozitimit aktual, dhe ndërtimi i një landfilli të ri, ku të trajtohen mbetjet e territorit të Bulqizës. E gjitha kjo duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit, transparencë financiare, projekte dhe programe, me qëllim rritjen e cilësisë së këtij shërbimi.

Danjel Bica thotë se më 31 nëntor 2018, organizata "Ekspertët e rinj mjedisor" i është drejtuar këshillit bashkiak të Bulqizës me një raport ku evidentohen problematikat e këtij shërbimi dhe një sërë rekomandimesh për përmirësimin e tij. Ne shpresojmë shumë se bashkëpunimi me Bashkinë do të japë frytet e veta. "Por, më e rëndësishme, thekson Bica, është që gjithçka të kryhet përmes bashkëpunimit me komunitetin. Pa kontributin e banorëve, përpjekjet tona për një mjedis të pastër e të shëndetshëm do të bëhen gjithmonë e më të vështira".

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve bashkiake nga komuniteti

Kalimi i pyjeve të ulta **në pronësi** të banorëve **po jep rezultatet** e para pozitive

Nga **OSMAN XHILI**



Shpesh, vlera e një projekti nuk matet me kohëzgjatjen dhe me paratë e harxhuara, se sa me gjurmët që ai le, mësimet që nxirren prej tij, angazhimit dhe bashkimit të njerëzve për të arritur objektivat e duhura dhe të planifikuara. Kështu ndodhi dhe me projektin e cituar më sipër, të zbatuar në pyjet bashkiake të Dibrës. Ai tashmë është në mbyllje, por në fakt, që tani duket sikur nuk do të mbyllet kurrë. Po përse e themi këtë? Sa për të ndezur atmosferën, apo kemi arsye dhe fakte që vërtet na bindin për këtë, duke ju referuar argumenteve të shumtë.

Kanë kaluar vetëm tetë muaj qëkur drejtori i projektit, Maksim Hajrullai, mori përsipër të vinte dhe një gur në themelin e mbrojtjes dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve bashkiakë në Dibër. Ai ishte një kuadër që vinte nga fusha e bujqësisë dhe me jo pak vite eksperiencë në drejtim dhe punë me njerëzit në terren. E kishte të qartë ku do të arrinte, rrugët që duheshin ndjekur dhe mjetet me të cilat realizohej një ide e tillë.

Që në fillim ai e kuptonte se për këtë duheshin bërë bashkë njerëzit, faktorët dhe aktorët, me shumë ndikim, por qofshin dhe të tjerë me ndikim më të vogël. Në shumë panele, takime dhe seminare, për të cilat do të flasim më pas, pati përfaqësues nga bashkia, pushteti vendor, komuniteti, kryetarë këshillash, apo njerëz të thjeshtë, nxënës shkollash, apo specialistë të pyjeve. Kishte dhe njerëz që kishin në marrë në pronësi ngastra të vogla e zabele, si dhe ishin kujdesur maksimalisht për pyjet që gjendeshin në to.

Nëse flasim me gjuhën e shifrave do të thoshim se në harkun kohor të tetë muajve që zgjati projekti u bënë disa hapa të rëndësishëm: u realizuan gjashtë takime të para promovuese, me 60 persona, në njësi të ndryshme administrative; në Peshkopi dhe në Maqëllarë u mbajtën trajnime dy ditore, me rreth 100 persona ; në çdo njësi administrative u realizuan tre takime të mëdha me 300 persona; ekspertë të ndryshëm të fushës asistuan në rreth 40 takime me gati 500 persona; takime të ndryshme u realizuan me rreth 800 nxënës të shkollave të ndryshme,duke i njohur ato me problematikat e pyjeve; në facebook dhe rrjete sociale u publikuan materiale të ndryshme për pyjet, duke thithur mendimet më të mira dhe problematikat për çdo rast; në takime morën pjesë specialistë të AZM së, SHPP së, Qarkut, Prefekturës, etj.; u shkruan gjashtë materiale të ndryshme, me problemet e ndryshme në faqet e shtypit; u mbajtën kumtesa, konferenca dhe u çfaqën spote të larmishme, në lidhje me problematikat e pyjeve.

Të gjithë këto aktivitete të shumta e të larmishme, kanë ndikuar mjaft në ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e banorëve të komunitetit. Jo se më parë nuk e dinin, por tani ata po e ndjejnë akoma më shumë, se pa zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, vetë zhvillimi i jetës njerëzore vihet në pikëpyetje dhe në dyshim serioz.

Në total, u angazhuan 4260 persona, nga të cilët, 800 gra, 1660 burra dhe 1800 të rinj.

Si rezultat i një pune konkrete në zyrë dhe në terren, u mundësua formatimi i 9 hartave me tregues për pyjet, si dhe 3 studime në përpjekje të përmirësimit të situatës aktuale. U mundësua dhe një hartë dixhitale, gjë që do të lehtësojë mjaft menaxhimin e sistemit pyjor dhe koordinimin e veprimtarisë të strukturave të specializuara në këtë drejtim.

Të gjithë këto aktivitete të shumta e të larmishme, kanë ndikuar mjaft në ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e banorëve të komunitetit. Jo se më parë nuk e dinin, por tani ata po e ndjejnë akoma më shumë, se pa zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, vetë zhvillimi i jetës njerëzore vihet në pikëpyetje dhe në dyshim serioz. Mbrojtja e tokës nga erozioni, lulëzimi dhe zhvillimi i turizmit, industria e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit, pastrimi i ajrit, janë vetëm disa nga përfitimet e shumta, që kanë banorët nga këto aleatë të përhershëm, pa marrë asgjë në këmbim të vlerave, që ata japin. Përdorimi i pyjeve për dru zjarri dhe materiale ndërtimi, është një vlerë e shtuar, që duhet eliminuar, sa të jetë e mundur.

Projekti dhe drejtuesit e tij janë të ndërgjegjshëm se situata nuk do të ndryshojë me një frymë, apo me një fjalë goje, por ama rezultatet janë të dukshme dhe të prekshme. Pyjet e ulta dhe zabelet, dikur toka të askujt, po fillojnë të vlerësohen, të sistemohen dhe po merren përgjegjësi për mbrojtjen e tyre, në kufinjtë e vjetër të pronësisë. Si rezultat kemi më pak dëmtime në pyjet e larta, duke shfrytëzuar krasitjet vjetore dhe rigjeneruese të pyjeve të ulta. Nga shumica e banorëve të kontaktuara gjatë veprimtarive të shumta të projektit, shprehet qartë se kalimi i pyjeve të ulta në pronësi të banorëve dhe stimulimi i tyre nga projektet qeveritare për të kryer disa shërbime në to, do të ishte një masë tepër efikase për të zgjidhur njëherë e mirë këto probleme negative, që kemi trashëguar deri tani. Përdorimi i burimeve alternative, si shfrytëzimi i erës dhe paneleve diellore, do të ishin vërtet një shërbim i mrekullueshëm në dobi të pyjeve.

Projekti ka synuar ndërgjegjësimin e gjithë shtresave të popullatës, por duhet thënë se më e shpejta, më e ndjeshme dhe më aktive, është rinia dhe nxënësit e shkollave. Kur pasqyruam disa shifra pak më lartë, jo rastësisht grupi i të rinjve ta angazhuar me projektin, ishte më i madhi, me 1800 pjesëmarrës. Ndaj drejtuesit e projektit i kanë parë shkollat si vatra ku do përgatiten njerëz, që jo vetëm nuk do ti dëmtojnë pyjet, por do ti mbrojnë ata me fanatizëm, do të rigjenerojnë pyjet e dëmtuara dhe do të mbjellin sipërfaqe të reja, që gjërat të shkojnë në kahjen dhe drejtimin e duhur.

Pyjet e ulta dhe zabelet, dikur toka të askujt, po fillojnë të vlerësohen, të sistemohen dhe po merren përgjegjësi për mbrojtjen e tyre. Si rezultat kemi më pak dëmtime në pyjet e larta, duke shfrytëzuar krasitjet vjetore dhe rigjeneruese të pyjeve të ulta.



Për të zbritur në rrafshin konkret të problemit, po synohet që çdo shkollë të ketë një sipërfaqe pylli në dispozicion, duke e konsideruaratë si pyllin e vet. Aty, ata mund të mbjellin pemë të reja, aty mund të shohin kafshët dhe insektet, që rriten mrekullisht në pyje, duke gjetur gjithçka të duhur e të nevojshme. Aty ata mund të bëjnë disa praktika mësimore, duke farkëtuar një dashuri të përjetshme me pyllin, që nuk zhbëhet më kurrë. Shkolla 9 vjeçare e Melanit e ka marrë tashmë një nismë të tillë, por dhe të tjerat, ndoshta do ta ndjekin pa hezitim.

Më 26 prill 2019 në sallën e konferencave të pallatit të kulturës në qytetin e Peshkopisë u zhvillua takim përmbyllës i projektit Agro- Eko – Dibra. Zonja Englantina Gollaj, menaxhere e Programit ReLOaD/ UNDP, falenderoi drejtuesit e projektit për punën dhe përkushtimin e treguar. Përshëndetën takimin përfaqësues nga bashkia dhe prefektura. Në fund, drejtuesi i projektit, Maksim Hajrullai, bëri një përmbledhje të punës tetë mujore dhe falënderoi pjesmarrësit dhe diskutantët për idetë dhe mesazhet, që ata përcollën.

profil

Beqir Demiri ka dhe një mesazh për të rinjtë. U lutet të mos e braktisin vendin e tyre. Më mirë të fitojnë më pak në vendin e tyre, se trefish në dherat e huaja. Ai i fton me fjalën, punën dhe shembullin e tij...

Beqir Demiri i Selanes

Nga **Osman XHILI**

Nuk është më shumë se katër kilometër rruga për në fshatin piktoresk të Selanes. Shoferi mezi pranoi të na përcillte për shkak të rrugës, ku troshiten pasagjerët, bashkë me makinën e gjorë. Shpesh është diskutuar e janë bërë projekte për të asfaltuar rrugën, po deri tani ata kanë mbetur vetëm në letër dhe pse janë ndërruar deputetë, kryetarë komunash e bashkish, nga e majta dhe nga e djathta e krahëve politikë. Përroi i Llixhave të shoqëron më të shumtën e kohës, duke të dhuruar pamje mbresëlënëse me bimësinë, lulet dhe pemët përqark. Kur ke kaluar tre kilometër, përroi vazhdon drejt përpara e derdhet në lumin e Drinit, ndërsa ne vazhdojmë në të majtë për të shkuar në fshat.

Dikur me gati njëqind shtëpi e sot jo më shumë se gjashtëdhjetë të tilla, fshati i Selanes na shfaqet para sysh. I mbrojtur nga erërat, me një lartësi 400 metër mbi nivelin e detit, në ultësirën e tij, fshati Selane është shquar që herët për prodhimin e të gjitha llojeve të perimeve, duke furnizuar veten dhe qytetin. Ka vite që fermerët po kultivojnë dhe qershinë, duke shtuar ndjeshëm prodhimin e saj. Mali, fusha, kodrat e buta pjellore, të veshura me bimësi të egër e pemë frutore, alternohen e gërshetohen bukur, duke dhënë një panoramë, që vetëm Zoti di ta bëjë të tillë. Pa le pastaj, kur e gjithë kjo mrekulli zbret deri në ujërat e Drinit të motshëm dhe prapë ngjitet në të njëjtën mënyrë në krahun tjetër të Hoteshit, duke u plotësuar në të dy anët e saj. Por ndoshta këto bukuri e vlera do të bëhen objekt i një shkrimi tjetër, pasi sot jemi ftuar nga Beqir Demiri, një nga fermerët e shumtë të këtij fshati e do të fokusohemi pak te puna e tij.

Beqiri nuk ka shumë shkollë, por ka punë dhe përvojë të grumbulluar ndër vite. Kur u nda nga vëllezërit, kishte pak më shumë se një dynymë tokë dhe një shtëpi të vogël me dy dhoma. Vuri para vetes disa piketa. Sikur do të blinte dhe një hektarë tokë, sikur do të ndërtonte një vilë të madhe, sikur do të bënte një stallë moderne, sikur do të blinte një dyqan në qytet e do shiste prodhimet e tij dhe më shumë akoma, sikur... Si shumë lart e ke ngritur stekën o Beqir Demiri, i tha vetes. Por të paktën, mos u trego të tjerëve, se do të turpërohesh.

Ca vite punoi në Greqi. Nuk kishte rëndësi





çfarë pune ishte ajo. E rëndësishme ishte që shtoheshin lekët në xhepin e tij. Erdhi një ditë, kur llogaritë i dilnin se mjaftonin për të blerë jo pak, por dhjetë dynymë tokë. Ishte një tokë në hyrje të fshatit, pjellore dhe me ujë të bollshëm. Nuk ndenji dhe shumë për të punuar në shtetin fqinjë. Një nga objektivat e realizoi. Sikur dhe këtu të mbetej ëndrra e tij, mjaft do të ishte. Tashmë ai ishte një fermer me tokë, gjë që aq shumë e kishte dëshiruar. Tani e tutje do të punonte në fshat, duke u përpjekur pak nga pak për objektivat e tjera.

Shumë fermerë të fshatit mbollën mollë

Beqiri mbolli katër dynymë me qershi, kurse gjashtë dynymë i mbolli me perime, traditën e vjetër të fshatit. Farën e lakrës Beqiri thotë se e mban po të njëjtë, me atë që kanë kultivuar gjyshi e stërgjyshi i tij. I prodhon vetë fidanët dhe mbjell çdo vit dy dynymë me këtë kulturë, duke marrë në total rreth 200 kv prodhim. Dy dynymë të tjerë mbillen me patate, duke marrë një prodhim prej 80 kuintalësh në total. Në intervalin kohor 10 – 30 qershor, kjo kulturë shkulet dhe ai mbjell misër gushtak të shijshëm, për tu konsumuar nga njerëzit në periudhën e vjeshtës. Domatet, specat dhe qepët, janë pjesa tjetër e arsenalit të perimeve, duke shtuar kështu kuintalët e prodhuar dhe të ardhurat në xhepin e fermerit. Beqiri ka pasion dhe kungujt. Të mëdhenj e të vegjël, të kuq, të bardhë e me shirita, ai prodhon çdo vit dy kamionë me kunguj, të cilët pëlqehen mjaft nga konsumatorët.

Beqiri mbolli katër dynymë me qershi, kurse pjesën tjetër, gati gjashtë dynymë, ai mendoi ta mbjellë me perime, traditën e vjetër të fshatit. Vit pas viti fermeri i përsos gjërat, përzgjedh farërat dhe përmirëson teknologjinë në çdo hallkë të zinxhirit. Farën e lakrës Beqiri thotë se e mban po të njëjtë, me atë që kanë kultivuar gjyshi e stërgjyshi i tij. I prodhon vetë fidanët dhe mbjell çdo vit dy dynymë me këtë kulturë, duke marrë në total rreth 200 kv prodhim. Dy dynymë të tjerë mbillen me patate, duke marrë një prodhim prej 80 kuintalësh në total. Në intervalin kohor 10 – 30 qershor, kjo kulturë shkulet dhe ai mbjell misër gushtak të shijshëm, për tu konsumuar nga njerëzit në periudhën e vjeshtës. Domatet, specat dhe qepët, janë pjesa tjetër e arsenalit të perimeve, duke shtuar kështu kuintalët e prodhuar dhe të ardhurat në xhepin e fermerit. Beqiri ka pasion dhe kungujt. Të mëdhenj e të vegjël, të kuq, të bardhë e me shirita, ai prodhon çdo vit dy kamionë me kunguj, të cilët pëlqehen mjaft nga konsumatorët.

Tek ëndrrat e hershme të tij, ishte dhe një dyqan. Nuk e donte për tu dukur, se asnjëherë nuk ka luftuar për këtë gjë. I duhej të shiste produktet e tij bujqësore, po pse jo dhe të tjera, që mund ti gjente me një çmim të leverdisshëm te banorët e zonës. Po ku e gjen kohën ky njeri tu shërbejë gjithë atyre bimëve që mbjell, të kryej gjithë shërbimet në to, të menaxhojë dhe blegtorinë, që e ka me po kaq dëshirë dhe gjatë ditës të shesë tek dyqani i tij, tek ura e Peshkopisë? Ai fle pak, vetëm katër, ose pesë orë. Kur të tjerët zgjohen nga gjumi, ai ka bërë dy ose tre orë punë. Në një rast, tregon Beqiri, kur policia natën po patrullonte për kontrollin e drogës, unë kisha vënë një elektrik në ballë dhe prashisja lakrat e mia në parcelë.

Para pak vitesh Beqiri një shtëpi të madhe, por dhe një stallë me të gjitha kushtet për të mbajtur lopë. Viçat e shitur janë një e ardhur neto për fermerin, por dhe plehu i prodhuar prej tyre është mjaft i nevojshëm për aktivitetin e tij prodhues. Por sado punëtor që është Beqir Demiri, ai nuk do kishte arritur të bëjë gjithë këto punë të mëdha, pa ndihmën e të shoqes, Nitës. Në oborrin e shtëpisë së tij ndodheshin mbi 200 metër katror shpore, vendi ku përgatiten fidanët, të gatshëm për tu hedhur në fushë brenda javës. Ndonëse ka dhe një fëmijë të vogël, ajo i kryen të gjitha shërbimet aty, i vadit me ujë dhe me pleh organik të lëngshëm, i pastron nga barërat e këqija, deri në mbjelljen në fushë. Pas shtëpie kanë të tjera shpore, por këto janë me arrë. Gjatë vjeshtës, Beqiri zgjedh kokrrat më të mira dhe i mbjell në fidanishte, për ti shkulur më vonë në trajtën e fidanëve. Shumë njerëz i blejnë, por dhe për vete i duhen për ti mbjellur buzë përrenjve, apo në zabelet e tij.

Krahas perimeve, nga të cilat nuk ka ndërmend të tërhiqet, Beqir Demiri, po hedh sytë nga frutikultura. Katër dynymë me qershi, tashmë janë në vitin e dhjetë dhe japin jo pak prodhim. Në pyllin që kanë si familje, krahas dushkut, ka dhe gështenja, të cilat sjellin të ardhura gjithnjë e më shumë. Këtë vit mbolli dhe 70 rrënjë arrë të shartuar, por do të dëshironte të mbjellë dhe një sipërfaqe me lajthi italiane, që e ka shumë për zemër.

Beqir Demiri është shumë i lumtur me punën që bën. Ëndrrat e tij të hershme, i sheh të realizuara. Stekën dëshiron ta ngrejë në lartësi të reja, por një frikë që ka filluar t'i shtohet kohët e fundit, e shqetëson dhe në ato pak orë gjumi që bën. Ka dëgjuar se njerëz me dhe pa pushtet duan ta marrin ujin e përrenjve pranë fshatit dhe të bëjnë centrale me to. Pa u konsultuar fare me to, pa u treguar projektet, a thua banorët nuk paskan asnjë lidhje me këtë problem. Nuk do të ketë më ujë për vaditje, nuk do të ketë prodhim, nuk do të ketë më para të mjaftueshme për familjen e tij dhe të fermerëve të tjerë. Ai do që ujërat të mos preken e të qëndrojnë aty ku kanë qenë për shekuj e ndoshta mijëvjeçarë. I lutet Zotit që kjo mos të ndodhë, se përndryshe nuk ka më kuptim të jetosh në atë fshat. Po tu heqësh ujin banorëve u ke hequr bukën e gojës, shpirtin, u ke këputur vetë jetën.

Së fundmi, Beqir Demiri ka dhe një mesazh për të rinjtë. U lutet të mos e braktisin vendin e tyre dhe të shkojnë për të punuar në dhera të huaj. U thotë se më mirë të fitojnë më pak në vendin e tyre, se trefish në shtete të huaja. Ai i fton me fjalën e tij, me shembullin e tij, me punën e tij.



Më 8 prill 2019 hapet shkolla e parë shqipe në qytetin e Peruxhias.

shkolla shqipe

Misionarja e 36 shkronjave

Nga **SELMAN MËZIU**





Ulur në karriken pranë një tavoline prej druri arre, Emria kishte mbështetur dy krahët, serioze, fytyrmendueshëm. Në dorë shtërngonte stilografin me dy gishtrinj, gadi për udhëtim në bokërrimat e brengave të kohës. Vështrimin e kishte hedhur në mur, ku qëndronte e varur në një gozhdë, fotografia e së bijës, Eradës.

Edhe pse ishin orët e vona të natës mësuese Emria, mendonte se cilat do të ishin mesazhet e fundit që do të mbyllnin dramën që po shkruante: **"Ne nuk jemi për muranë".** Vërtet, bluante ajo me vete dhe sillte ndërmend, botën e madhërishme pellazgjike, kufizime trojesh, teritoresh. Kështu njëlloi hynte për të kërkuar edhe në botën e ilirëve. Por fatkeqësisht në shtigjet shpatthyme, plotë rrëpira të kohërave ne u vetmurosëm duke na dhunuar kulturën, jetën, trojet, natyrën. Gjaku ynë në dejet e kohërave kërkonte arterje të reja të zgjatueshme. Ato diku i gjenin, dikur i vetëburgosshin këtu në mes malesh me ligje të pashkruara, me kode teje primitive. E këto ligje si rriqnat në barkun e deleve rudë, herë largoheshin e herë rikthe heshin me të njëjtën, egërsi e shpirtëligësi. Mësuesja e gjuhë – letërsisë, mendoi të hedh pyetjen e saj në mbyllje të dramës: *"E fëmijët, përse duhet të mbyllen për fajin e ligjit të gjakmarrjes? A nuk është mbjellje krimi e psikologji terrori nëpër brezni?"*

Ndërsa me shembjen e mureve e të regjimeve, fijet e brishta të jetës duheshin të bashkoheshin me shtyllat e qendresës së familjeve, fiseve, kombit. Por, jeta u trupëzua, nga rreshpet e vrullshme të kohërave të trazuara. Ndaj dramaturgja do të ulesh të shkruaj shqetësimin që brente egërsisht, mallengjyeshëm, me dhimbje therëse në shpirt, familje, fise, fshatra e qytete shqiptare*: Braktisja e detyrueme e mëmëdheut, nëpërmjet gjinisë së dramës*: **"Ti duhet të vish, baba!"** E shkruajtur me dhimbje të thella, me lotë rrëke nëpër faqe; me gjakun e zemrës, shkronjat, fjalët e fjalitë e saja të nxjerra shkulma - shkulma nga thellësite e vetëvetes dhe jetës së mijëra bashkëqyteterëve të saj. Drama u luajt nga nxansit e shkollës . U realizua më së miri artistikisht,me plotë ndjenja e mjaft prekëse, gjurmëlanse, emocionuese, drithëruese ndjenjash, për shikuesit direkt apo në ekranet e televizioneve.

E megjithatë jeta tanima në këtë qytet mbështetur në shpatet e një vargmali të mprehtë, shkëmbor, kryeneç, buzë një shtrati prroi erë ujrash minerale e mbeturinash gjithëfarëshe, nuk ndryshoi. Fatkeqësisht çifti i shkolluar në gjimnazin e këtij qyteti, në Institin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, buzë Liqenit e pranë kalasë ilire, pas katër dhjetë vjeçarësh mësues, do të ndiqnin lëvizjet e rrathëve koncentrik të mijëra vjetëve. Për të çarë muranat e qytetit me emrin e një peshkopate mbuluar nga padrejtësitë e kohërave të pamëshirshme, tinzare, shkretuese. Por, me një piksynim atdhedashurues, me një shpirt stoik atdhetar, me një pastërti ndërgjegje e energji flakëruese: *Të hapnin shkollat shqipe aty ku fisi i Etruskeve kishte ngritur qytetërimin e vetë para mijëra vjetësh,* të shkëputur nga trungu pellazgo-ilir, në Peruxhia të Italisë.

Vajza Erada do t'i priste krahëhapur e gëzuar e me plotë mallëzim e gëzueshëmëri, së pari nanë Emrien e pastaj babain Adrianin, si prindër, NJËKOHESISHT krenar për misionin e tyre ma të artin, ma fisnikun, ma të guximshmin, ma atdhetarin, ma gjurmëlansin e zgjimin e një rilindje të ndjenjave arbëreshëve të rinj, të fundëshekullit të njëzetë e njëzetë vjeçarin e shekullit të njëzetë e njëtin.

E formuar në karakter të fort, këmbëngulse në vendimet e marruna, besnike e premtimit, Emria duhesh të arrinte qëllimin e saj, të ishte mëkuesja me shkronja e fjalën e amël shqipe të fëmijëve shqiptar syrgjinosur në dhe të huaj në ujëdhesën Apenine. Beteja ishte e vështirë, në takimete filluara me familjet e njohura dibrane, e jo të tilla, në qytetin e peruxhias e rrethinat e saja, në krahinën malore të Umbrias. Ajo ishte luftë idesh, konceptesh, ideologjish, bindjesh me njerëz me karaktere malsorësh, fusharakësh, një kacafytje e vërtetet. Prandaj duhesh të veprohesh e të ndërhyhesh, me një maturi e urti prej mëseusje shembullore në qytetin në një shpat mali, duke mpleksur, shkrirë në një, prirjet e psikologjinë e sejcilit prind apo çift atdedhetarësh për të arritur qëllimin final: *Mësimin e gjuhës shqipe*.

Me kohën ajo filloi të shkëpus nga thepat e këtyre shkëmbenjëve copëzat e saja që i duheshin për ti gdhendur me shkronjat, fjalën, artin e mësimdhënjes me kulturë, pasion, maturi e dashuri atdhetare. Në çdo takim asaj ju desh edhe të debatonte ashpër, duke iu rrëfyer ngjarje nga jeta, edhe t'iu jepte shembujt e atyre prindërve që ishin treguar të gatshëm që krahas italishtes në shkollat e detyruara italiane të mësonin në orët e lira shqipen gjuhën e prindërve të tyre, e atdheut ku nga ishin syrgjinosur.

Për të kuptuar më mirë realitetin e hidhur që gjeti ajo në Peruxhia dhe dëshirën e saj, ne po shkëpusim mendimin e mësueses misionare të 36 shkronjave Emries e cila i është shprehur mësuesit çidhnak e historianit Haki Përnezha: *"Kemi fëmijë që flasin shqip, ka që nuk flasin fare, ka që duan të mësojnë dhe që nuk duan të mësojnë. Në këtë katrahure të gatuar nga politikanët tanë, çfarë të mundemi të shpëtojmë. Shifrat të shkruara nga zyrtarë italiane janë mbi 300 mijë fëmijë shqiptarë nga të gjitha trojet tona vetëm në Itali. Ka 10 mijë fëmijë të lindur në vit. Është për të vënë kujën. Trojet tona po shkretohen, por të paktën të mundohemi t'i afrojmë me gjuhën shqipe. Na beso se jemi shumë të lënduar nga ky realitet i hidhur." (F.B 12.04.2019)*

Së bashku me të shoqin Adrianin ato nuk reshtnin në komunikime me organizatorët e kësaj fushate shqiptarizme të kohëve tona, të kësaj ndërmarrje që arbëreshët e italisë e kishin filluar disa shekuj më parë që të mësonin bashkëatdhetarëve të tyre, shkrimin e të folurën shqip, të festoni festat e tyre, të ndiqnin tradita shqiptare në të gjithë veprimtarinë e tyre si dhe duke hapur shkollat shqipe të zyrtarizuara me ligje, rrjedhoj e një kambëngulje të vazhdueshme. E njëjta dëshirë, të njëjtat ligjësi për mbijetesën e detyruar brenda një kombi tërsisht tjetër, por që fatkeqësisht pjesë e së cilës u banë në shekullin e XV dhe sot shqiptarët ka ndjekur çifti Skuka nga Peshkopia e Dibrës së poshtme.

Dhe rezultat i punës me plotë pasion e devotshmëri të çiftit Emrie e Adrian Skuka shfaqet plotë dritëe ardhmësi, rezultati: **Me 8 prill 2019 hapet shkolla e pare shqipe në qytetin e Peruxhias, dhe ja se çfarë shkruan gazeta "Perugia Todey":**

"Hapja e shkollës u organizua nga bashkësia e shqiptarëve të peruxhias me nxënës, prindër dhe mesuesen e gjuhës e literaturës shqipe, Emrie Skuka. Prerja e shiritit u krye nga Presidenti i Shoqatës se Mësuesve Shqiptar në Itali Arjana Kosova, sekretari Nexhat Marku dhe kordinatori i Karitasit Maria Liza Peçeti." Nga administrata e Komunës së Peruxhias morën pjesë Dramane Wague dhe këshillari Antonio Trakexhani.U organizua një koktei, ku nxënësit të veshur me kostume kombëtare dhe prindërit kërcyen valle popullore shqiptare.



Me studimin e saj historik **"Sinoret e Luznisë"** shkruesja e saj Emrie Skuka, pasqyroi historinë e një krahine me ngjarje të dhimbshme, të shumta, heroike të historisë që në lashtësi e deri në ditët tona, duke iu dhuruar studiuesve, mësuesve të shkollave e popullit luznak nje libër dinjitoz, me historinë e tyre. Ndërsa tani ajo i ka kaluar këto sinore pasi i ndriçoi e çimentoi me shkrimet e saja me veprime, kujdesime, me të ushtruarin e misionit te 36 shkronjave, duke punuar e sakrifikuar për të mbajtur të pashuar atdhedashurine, për të kultivuar tek emigrantët shqiptar, kulturën shqiptare, historine e tyre të stërlasht, gjeografine Pellazgo Iliro Albaniane, traditat, zakonet përtë mbajtura të pashuara ato ide e pikësynime të Arbëreshëve Nikoll Keta, Xhulio Variboba, Zef Krispit, Serembes, Skirios, Leonard de Martino, Jeronin De Radës, e qindrave të tjerëve që mësuan e shkruan historinë e shqiptarëve në Italine jugore e qëndrore, duke ju kënduar natyres, heroizmave të Shqiptarëve e Gjergj Kastriotit. E tani i ka ardhur rradha misionares së 36 shkronjave, për të mesuar me dashuri mesuseje, nane, patrioteje zemër zjarr atdhedashurie, të shkruajturën e të folmen shqip dhe pasqyrimin e jetës së emigrantëve shqiptar në krahinën e Umbrias, qytetit të Peruxhias e ma gjane nëpërmjet artikujve e librave të ndryshëm. Vazhdimësi kjo e natyrshme e asaj qe Emria kreu në atdheun e saj, Shqiperinë, Dibrën kreshnike.

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri, Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

- ***I duel lërana:*** *I doli lërana*. Përdoret njëlloj me *i doli fundi kësaj pune*. *Lëranë* quhet një dërrasë që qëndron në fund të mullirit të blojes, mbi të cilën vendosen të gjitha objektet lëvizëse që rrotullojnë gurin e mullirit. Po u prish (*i duel*) *lërana*, mulliri nuk punon.
- ***E theu kolerin:*** *E theu kularin*. Thuhet për dikë që rebelohet. Kau kur thyente kularin ikte me vrap që të mos vihej sërish në zgjedhë.
- ***Ka zrrak:*** *Ka-u zrrak*. Thuhet për dikë që shkon pas femrave, por nuk i ecën. *Vjen vërdallë si ka zrrak*. Kau *zrrak*, *kau i qetun*, kau që është tredhur, por jo krejt. *Kau zrrak* u rrin lopëve në shpinë, por mëkot.
- ***Mos rraj si n'pivana:*** I thuhet dikujt që ka ardhur mik dhe *nuk rrafshohet*, por rrin gati për t'u ngritur. I zoti i shtëpisë i lutet: *Rrafshoju tani, mos rri si n'pivana*. *Pivana* quhen copërat e dërrasave të holla që u vihen kuajve në gju duke i detyruar ato të ecin pa e thyer gjurin.
- ***Si dhaj' llaçk':*** Thuhet për ato gra që nuk kujdesen sa duhet për fëmijën. *Llaçkë* janë ato dhi që pjellin para se t'u ketë ardhur koha dhe pjellin të vegjël të dobët.
- ***E bê (mban) zgjedhën pa qise:*** *E mban zgjedhën pa plis*. Kjo shprehje përdoret për të etiketuar dikë që duron shumë, më shumë se ç'mund të durojnë të tjerët. *Plisi* është një copë rrobe e trashë që vihet poshtë zgjedhës e mbi qafën e kaut që të mos i vritet qafa.
- ***Agje ke qëft':*** *Atje ku qoftë, qoftë larg*. Thuhet për besëtytni për diçka që nuk don ta përmendësh, që dëshiron që të jetë gjithnjë larg teje.
- ***Mugjullon n'dimën:*** *Mugullon në dimër*. *Çel gjethi në dimër*. Thuhet për dikë që është sipërfaqësor në fjalët dhe veprimet e tij.
- ***Ia shtaje ujt' n'shnre:*** *Ia shtie ujit (tokës) në mes të dimrit, në muajin e Shëndreut*. Thuhet për dikë që bën veprim pa mend në kokë.
- ***Dit'n e shajut gjegj oxhakun:*** *Ditën e shiut, ditën me shi - djeg oxhakun*. Thuhet për dikë që është shumë punëtor dhe që nuk e harxhon kohën kot, që edhe ditën me shi i gjen punë vetes.
- ***Vner xherpën e bisht*** çapaj***:*** *Vrer gjarpër e bisht* çapini *(zhapini)*. Thuhet për dikë në dukje është i qetë por fjalët i ka të idhëta.
- ***bllag:*** Një copë lëvore e thatë e pishës, që hyn midis dërrasave të vozave a shekave për të mos rrjedhur.
- ***bici-bici:*** Nga sll. *bistro-bistro, shpejt-shpejt*. Fjalë për nxitje lakmie ndaj dikujt. Zakonisht në gojën e fëmijëve, kur kanë diçka për t'u ngjallur lakminë të tjerëve. *Bici-bici,* ja çfarë kam unë. Na nxore *bicin-bicin*.
- ***besleme:*** Tregon një kafshë të rritur në kullotë lirisht, pa kapistër, nga një arë në një tjetrën. Dele *besleme*. Kjo vajzë është rritur *besleme* (pa kufizime).
- ***bële:*** *Bole*. Në disa raste ka kuptimin fëmijë-mashkull. Kështu thirren fëmijët me përkëdheli (në Sinë) me kuptimin *i vogël*. E njëjta fjalë tek Çabej del me kuptimin *trim, guximtar*. *Nuk është ashtu,* oj *bole*.
- ***bëlb:*** *Bolb/ë-a*. Tufat e leshit të shkurtër të deleve. *Mblidhi bëlbat dhe hidhi në kosh*. Çabej fjalës *bolbë* i jep dhe kuptimit *fatkeqësi*, *hata*.
- ***bët:*** *Bot/ë-a*, *argjil*, baltë që ngjishet për të bërë çerepë. Në Çidhën janë përdorur disa lloje *botash* (argjilesh): *botë* për të larë kryet; *botë* e bardhë për të lyer dhomat; *botë* e zezë për të hequr brezat e shtëpive; *botë* çerepësh dhe *botë* e kuqe për të lyer (zakonisht tavanet).
- ***brenë:*** *Brenas, rrëshqanthi, zvarrë. E mori brênë dhe e futi brenda*. Si folje përdoret në formën *brêno-j* dhe kjo me kuptimin *rrafshoj, fshij* nga faqja e dheut. *Kaçakët u sulën mbi shtëpitë e lagjes dhe i brênuen*.
- ***bridh't:*** *I bridhët*, njësoj më (i/e) *shkriftë*, që është me pak ujë, gati i thatë. Me kuptim të kundërt me çfarë jepet nga Çabej, *i njomë, i butë*[0]: *pa ujë* a *me pak ujë*. *Kjo hallvë qënka shumë e bridh't*.

ANEKDOTA E MUAJIT

Më gjeni një qen!

Pika e mëngjesit. As zgjuar, as në gjumë.

Bie zilja e telefonit. E mbyll me përtesë. Bie prapë, shoh një numër të panjohur, por gjumi më doli dhe vendosa ta hap.

- Alë, alë! A n'ngjën!

- Po, po, ngjëj, po fël! - futem në rol, kurioz se kush mund të ishte ai që më zgjoi sot.

- Jam ni çobën! Na majti uku mër, i griu t'gjitha delet.

- Mos mor, kaq shumë qakan shtue!

- Po, po, kam pas maj' niçin dele, e nizet mi ka pre deri ç'tahaj. Jan t'u mi gri krejt...

- Po çish kërkon prej meje?

- Pashajf, kam katër çen, por veç e han bukën kot... Cigrëjn e shkojn e m'çefen mas deleve. A mun tëm xhejsh ni çen t'majr anej ka Tirana, se vallahi asht t'u m'hik tufa...

- Vallahi sun munem me t'ndihmue! Se na kne e kemi ni çen bir çeni, po e kemi për vete...

TREGIM ALEGORIK

Në dhé të huaj

Një grup njerëzish u larguan nga vendi i tyre për një jetesë më të mirë. U bënë bashkë trikatër familje, se rruga ishte e gjatë, e vështirë. Ata kishin nevojë për njëri-tjetrin. Mbërritën në një vend që u pëlqeu; aty kishte shumë toka të mira dhe prodhuese, kishte lumë, pyll pa hesap, bjeshkë, gjithçka që duhet për jetën e njeriut. Puna e parë që bënë qe takimi me burrat e atij vendi për t'u kërkuar leje që të uleshin aty. Burrat e atij katundi u thanë:


- Ju mund të uleni këtu me një kusht: kur të vdesë njëri prej jush, bashkë me të vdekurin, do të varrosim edhe një të gjallë.

Ata nuk e pranuan kushtin dhe vazhduan përpara. Ec e ec dhe ja ku gjetën një vend tjetër edhe më të mirë se i pari. Takuan vendalinjtë dhe ua thanë hallin që kishin.

Ju mund të rrini këtu e të bëheni vendas, por me një kusht: kur të vdesë njëri prej jush, bashkë me të vdekurin do të varrosim edhe dy të gjallë.

Të ardhurit nuk e pranuan kushtin dhe deshën të shkojnë përpara, në kërkim të një vendbanimi tjetër, por më plaku u tha:

Kthehemi dhe shkojmë në vendin tonë, se me siguri më tutje do të na thonë që bashkë me të vdekurin duhet të varrosim tre të gjallë. Bënë si tha plaku: u kthyen...



(Marrë nga libri "Tregime alegorike" i Xhafer Martinit, Botimet M&B, Tiranë, 2019)

Librin mund ta gjeni duke kontaktuar pranë librarisë së botimeve M&B, rrjetit të librarive Adrion ose libraria Art's te stacioni i trenit në Tiranë.

Rruga e Arbërit nr. 156

Miku, gazetari, kolegu ynë Dëfrim Methasani u kthye në vendlindje, respektoi veten dhe bashkëfshatarët e tij.

vendlindje

Kthim në vendlindje

... i një kolegu





Nga **BASHKIM TUFA**

Në orën 9.30 u nisëm nga Tirana në drejtim të Kukësit. Organizatori i këtij eventi, miku ynë Dëfrim Methasani, na propozoi, që për të shkuar drejt Peshkopisë, në mungesë të rrugës së Arbrit ku ende po vazhdojnë punimet, do të ishte më mirë të merrnim rrugën nga Kukësi, e cila edhe pse nja 40 kilometra më e gjatë nga ajo e Bulqizës, do të na shpëtonte nga troshitjet e gropave të asfaltit. Ashtu bëmë. Dhe shumë mirë kishim bërë. Agron Zerani dhe Ilirjan Hysi, që u bashkuan me grupin në mbrëmje në Peshkopi dhe që kishin udhëtuar nga Bulqiza, na treguan se ishin torturuar dhe kishin hequr picirin për të mbërritur deri në Peshkopi, edhe pse largësia nga kryeqyteti është diçka afër 180 kilometrave.

Nejse, ne grupi kryesor, me lider të zgjedhur unamisht njëzëri, daxh Muharrem Gjokën, një dibran që ka jetuar për 35 vite në Laç dhe ka drejtuar ndërmarrjen e rrugaurës në Kurbin, pasi përshkuam Rrugën e Kombit, në qytetin e Kukësit nuk vazhduam drejt Morinës, por morëm rrugën djathtas, duke kaluar midis Shtiqnit dhe aeroportit të Kukësit, që thuhet se pas 2 vitesh do të vihet në funksionim.

Kur po i afroheshim Sohodollit, e kuptuam menjëherë. Tingujt e muzikës jehonin që larg. Fusha e kalçetos e Liridon Methasanit, ku do të zhvilloheshin edhe ndeshjet e futbollit, ishte shndërruar në një podium feste, që mezi priste të niste.

Kuptohet, që për disa nga pjesëtarët e kësaj ekspedite, ky rrugëtim ishte i panjohur, një përvojë e re. Miku ynë, Shpëtim Gjoshi, i cili është gjysmë-kuksian, pasi ka punuar gati një dekadë në këtë qytet verilindor dhe si gjeolog me profesion, vështirë se ka lënë vend pa shkelur me këmbë, u vu në rolin e guidatorit, duke na treguar fshatrat nëpër të cilët kalonim. Lamë Nangën, Bicajn e njohur të kësaj krahine, Domjen, një fshat thuajse i gjithi i shpërngulur pranë kryeqytetit, iu drejtuam Kolesjanit me grykën e tij të famshme, më pas Bushtricës malore të Safet Gjicit, ku nuk kishte vend për një fushë volejbolli dhe jo më për atë të futbollit.

Befas makina e Dëfrimit, që na udhëhiqte, u ndal në një majë kreshte. Na "urdhëroi" që edhe ne të ndalnim dhe të dilnim nga makinat. Ishte një peisazh natyror mahnitës. Ishte një pikë dominante, ku bashkoheshin dhe shiheshin njëherazi: Kukësi i lënë pas, djathtas Mirdita, Lura dhe Mati. Në mes të kësaj lugine mahnitëse, gjarpëronte Drini i Zi. Përballë, si kujdestar i kësaj pike, qëndronte hijerëndë vargmali i Korabit, i mbuluar me dëborë. Dylber Markaj, një dibran, por dhe mik i hershëm i Dëfrimit, na shpjegonte relievin. Ishte një pamje madhështore, që për fat e kemi, por nuk e vlerësojmë...

Pas pak, hymë në të famshmen Kala e Dodës. Aty qëndruam për të drekuar dhe

Në Kastriot u ndalëm për të bërë një foto në memorialin e këtij fshati, ku përflitet se është prejardhja e heroit tone kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, ashtu siç shkuam edhe tek ura e Drinit të Zi, që ndan Fushë-Aliajn, ku Dëfrimi për disa vite kishte punuar si mësues i edukimit fizik.

për të provuar "flinë", ushqimin tradicional të veriut, për të cilin kuksianët thotë është recetë e tyre, çka e pretendojnë edhe dibranët. Pa bërë gjykatësin për këtë pretendim, "flija" është një ushqim i rëndë, i pasur me kolesterol, pasi gatuhet kryesisht me vezë dhe gjalp, natyrisht bio, prodhime fshati.

Befas, pasi ne kishim zaptuar lokalin, në të hyri një i huaj. E ndihmuam të komunikonte, kërkonte edhe ai të ushqehej. Bëri porosinë dhe preferoi të hante jashtë, në disa tavolina të vendosura në natyrë edhe pse ishte freskët. Me vete kishte një çante të madhe shpine, kuptohej menjëherë se ishte një turist, që po bridhte i vetmuar në ato zona, sa të ashpra, aq edhe të bukura, por të braktisura nga njerëzit. Të gjithë shqiptarët tashmë i janë turrur qyteteve, askush nuk preferon të jetojë në fshat.

Pasi lamë pas Vleshën e ujit të ftohtë, ndalesa tjetër ishte në Sllovë, fshatin e heroit tonë kombëtar Elez Isufi. Edhe këtu kujtime, nostalgji për vitet e shkuara. Miku ynë kishte jetuar për 12 vite aty, pasi të jatin, Shuaipin, partia e kishte transferuar me punë. Dëfrimi na tregoi edhe shtëpinë ku kishte jetuar, në të vetmin pallat 2-katësh të atij fshati, i cili tashmë ishte i pabanueshëm dhe drejt rrënimit.

Në Kastriot u ndalëm për të bërë një foto në memorialin e këtij fshati, ku përflitet se është prejardhja e heroit tone kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, ashtu siç shkuam edhe tek ura e Drinit të Zi, që ndan Fushë-Aliajn, ku Dëfrimi për disa vite kishte punuar si mësues i edukimit fizik.

Kur po i afroheshim Sohodollit, e kuptuam menjëherë. Tingujt e muzikës jehonin që larg. Fusha e kalçetos e Liridon Methasanit, një kushëri i Dëfrimit, ku do të zhvilloheshin edhe ndeshjet e futbollit, ishte shndërruar në një podium feste, që mezi priste të niste. Fehmi Lleshi, me shpejtësi bëri gati gjithçka...

1.

Nën drejtimin e gjyqtarit Sokol Lleshi, një djalë nga Kastrioti që e kishim marrë që nga Tirana, të parët që zbritën në fushën e lojës ishin skuadrat e shkollave 9-vjeçare të Sohodollit dhe asaj të Brezhdanit, të ftuar si miq. Fituan 2-1 vendësit, të cilët u nderuan me fleta nderi, medalje dhe kupën "Fadil Shulku". Trofeun simbolik, fituesve ua dorëzoi bashkëshortja e ish-portierit dibran të Korabit të Peshkopisë, i cili para disa vitesh është ndarë nga jeta.

Risia e kësaj ndeshjeje, por edhe asaj që







DEFRIM METHASANI u kthye në vendlindje, respektoi veten dhe bashkëfshatarët e tij

Sohodollasit pritën dhe respektuan djalin e tyre Dëfrim Methasani, por ndërkohë nderuan dhe i vunë në krye të qoshes miqtë që e shoqëronin atë.

"Kthim në vendlindje" vazhdoi edhe në Tiranë. Dibranët përdorin një shprehje: "Kafja mbahet mend"! Altini bëri më shumë se sa kaq. Si për të dëshmuar se është djalë Sohodolli, një pinjoll fisit Tafa, ai erdhi e "i vuni tri dujt mullarit" në kryeqytet...

do të niste midis të rriturve të Sohodollit dhe atyre të Blliçes, ishte fakti se ato po trasmetoheshin direkt, jo nga një, por nga katër komentatorë nga më të njohurit e RTSH-së. Mikrofoni kalonte sa nga duart e Rrok Preçit me një karrierë 35-vjeçare, aq edhe te brezi i ri i radiokronistëve si Isuf Myrtajt apo Fatmir Eficës, por edhe të Fatmir Zhuzhi që komenton nga Peshkopia. Kurrë, as ka patur dhe vështirë se do të ketë edhe në ardhmen, kaq shumë komentatorë sportivë në një fshat, si



Sohodolli i Peshkopisë.

Edhe në ndeshjen e dytë, vendësit nuk falën. Futbollistët e Sohodollit fituan 3-2, pas një ndeshjeje të fortë dhe mjaft të luftuar. Edhe fituesit e këtij takimi u shpërblyen me fleta nderi, medalje dhe kupa. Liridon Methasani, pronari i këtij kompleksi, në emër të shokëve, 100 eurot e dhëna nga Artur Tafa për ekipin fitues, ua dhuroi shkollës 9-vjeçare të Sohodollit.

Në ceremoninë përmbyllëse të këtij "mini-kampionati", mjeshtri i volejbollit shqiptar, Leonard Tase, këshilltar pranë Presidentit të Republikës, i përshëndeti fituesit dhe gjithë të pranishmit në emër të zotit Ilir Meta, duke u uruar suksese të mëtejshme në jetë dhe veprimtarinë e tyre shoqërore.

2.

Mbrëmja në qytetin e Peshkopisë, në "hotel Piaza" të Pajtim Gjurës, ishte midis miqsh. Dëfrimi përgëzoi miqtë dhe miqtë vlerësuan Dëfrimin. Kështu u lauruan për promovimin që i bëjnë qytetit të Peshkopisë gazetarët lokalë Edmond Hasani, Neki Feta, Adnan Elezi, Islam Shehu, Rruzhdi Xhediku, Fatmir Zhuzhi dhe Artur Xhediku (Rruzhdiu dhe Arturi jane djem te Sohodollit). Ndërkohë, me një simbolikë të eventit "Kthim në vendlindje", u nderuan Muharrem Gjoka, Agron Zerani, dhe unë.

Ndërkaq, veç fjalëve vlerësuese për organizatorin e eventit "Kthim në vendlindje", Isuf Myrtaj, në emër të kryebashkiakut Artur Bardhi, i dorëzoi Dëfrim Methasanit një "Mirënjohje" nga Bashkia e Kurbinit. Gjithashtu, edhe portali i ri sportive "Sporti IM", në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë në këtë dritare sportive, i dha gazetarit Dëfrim Methasani një "Çertifikatë Nderi". Nën tingujt e muzikës, të shoqëruar edhe nga këngët e artistit shumëdimensional dibran, Agim Skarra, akrepat e orës kaluan mesin e natës pa u kuptuar...

3.

Të nesërmen, mëngjesi ka gjeti sërish në Sohodoll. U rikthyem, pasi miku ynë Dëfrimi, nuk kishte mbaruar punë me fshatin e tij të lindjes. Kishte menduar t'i dhuronte shkollës 9-vjeçare komunitare të vendlindjes edhe 55 uniforma sportive, 13 topa, 200 libra dhuratë për bibliotekën, si dhe do të mbillte edhe 16 pemë dekorative në oborrin e shkollës, plus dhurata të tjera.

Sohodolli është një nga tri fshatrat më të mëdhenj të Dibrës, me afro 400 shtëpi, ku fisi Methasani, Tafa dhe Zuna, janë ndër më të dëgjuarit edhe pse në këtë fshat numërohen 26 mbiemra fisesh. Krahas kullës së Zunës



si objekt historik, interesant është fakti se në Sohodoll lejohen martesat brenda fshatit, por jo brenda fisit.

Shkolla e këtij fshati aktualisht numëronte mbi 250 nxënës, të cilët na rezervuan një pritje të veçantë dhe befasuese. Nga bankat e saj, ndër vite kishin dalë mjaft personalitete të njohur, jo vetëm të Peshkopisë, por edhe të mbarë vendit. Gjejmë rastin të përmendim vëllezërit Abdiu, Fehmiun, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese: Sabriun, ish-shefin e klubit të Korabit dhe Studentit. Poetin dhe publicistin Agron Tufa; gjeneralen, të parën femër në Shqipëri, Manushaqe Lami; Xhelil Cibakun, ish-kampion i mundjes dhe prefekt i Dibrës, ish-mësuesit e shkëlqyer Bexhet Cibaku, Xhemë Haraçiu, Besnik Methasani, Shyqyri Horeshka, Bashkim Makishi, etj. Apo dy ikonat e mësuesisë që vazhdonin ende të jepnin mësim në këtë shkollë, si Sul Avdia dhe Vasfi Cibaku.

Drejtorit të shkollës 9-vjeçare komunitare Fatbardh Cena, na befasoi me pritjen që na bëri. Ndërsa Dëfrimi dorëzoi dhuratat, bazën materiale sportive, librat, si dhe mbolli 16 pemë bashkë me djalin e këtij fshati Polikron Horeshka, nxënësit e shkollës kishin organizuar për nder të miqve një koncert artistik, për t'i drejtuar më pas gazetarit sportive, djalin të fshatit të Sohodollit, Dëfrim Methasanit, një mori pyetjesh për jetën e tij profesionale, por dhe atë familjare. Ishin pyetje të zgjedhura me përkujdes...

Kur kërkuam leje për t'u larguar, pasi do të udhëtonim drejt Tiranës, ish-mësuesi, sportisti dhe trajneri i shquar i mundjes shqiptare, Fariz Cibaku, ashtu siç dinë të flasin me nënkuptime dibranët, na tha: "akoma nuk më është ngopur njëri sy". Kishte të drejtë, edhe ne nuk na ikej nga Sohodolli...

4.

Morëm rrugën e rikthimit drejt Tiranës, me kokën pas... Miku, gazetari, kolegu ynë Dëfrim Methasani u kthye në vendlindje, respektoi veten dhe bashkëfshatarët e tij. Ne ishin me fat që ishin pjesë e kësaj ngjarjeje. Sohodollasit pritën dhe respektuan djalin e tyre Dëfrim Methasani, por ndërkohë nderuan dhe i vunë në krye të qoshes miqtë që e shoqëronin atë. Artur Tafa, një djalë kavalier nga Sohodolli, i veçantë në çdo veprim të tij, nuk na u nda deri sa u larguam nga Dibra e Madhe. Pas Strugës shqiptare, udhëtimi drejt Tiranës... Dëfrimi dhe ne ishim në Sohodoll. Ia vlejti...

5.

"Kthim në vendlindje" vazhdoi edhe në Tiranë. Dibranët përdorin një shprehje: "Kafja mbahet mend"! Altini bëri më shumë se sa kaq. Si për të dëshmuar se është djalë Sohodolli, një pinjoll fisit Tafa, ai erdhi e "i vuni tri dujt mullarit" në kryeqytet...

Tiranë-Sohodoll, 18-19 prill 2019

Visit Diber

**Nëse nuk e ke vizituar ende Dibrën,
nuk e ke parë ende Shqipërinë!**

Turi i Luginës së Shërimit

Përshkrimi i shtegut turistik të Luginës së Shërimit

Lugina e ka marrë këtë emër për vlerat kurative nga shfrytëzimi i burimeve termale të Llixhave të Peshkopisë dhe pjesës malore e bjeshkës së Skërtecit, pjesë e vargmalit të Korabit.
Udhëtimi në këtë tur është 3 ditor, por mund të organizohen edhe ture një ditore. Udhëtimi është shumë interesant, ku gërshetohet bukuria natyrore kuruese e ujërave të ngrohta termale, ajri i pastër i malit, gojëdhënat dhe vendbanimet historike të vjetra dhe të reja. Ky itinerar të krijon mundësinë e qëndrimit në shtëpitë pritëse të fshatit turistik Rabdisht, një nga 100 fshatrat turstikë të Shqipërisë, ku njihesh me mikpritjen dhe gatimet tradicionale dibrane.

SHIJO DHE EKSPLORO ME ECJE "LUGINËN E SHËRIMIT"

KOHËZGJATJA:	3 DITORE (mund të jetë edhe 1 ditore)
GJATËSIA E SHTEGUT:	18 - 20 KM
VËSHTIRËSIA:	NIVELI I LEHTË OSE MESATAR











Dita 1

Shijo natyrën dhe ushqimin në fshatin e gurtë turistik të Rabdishtit

8:30 Nisja nga Peshkopia
Eksperiencë në qytetin e vjetër të Peshkopisë, ku njihesh me historinë e lashtë të qytetit, si një qendër "peshkopësh ortodoksë". Lagjja e vjetër e qytetit me ndërtimet e saj karakteristike, rrugicat me kalldrëme dhe "pazari" të tregojnë një qytet të stilit ballkanik otoman. Vizitorët mund të shikojnë dyqane artizanale dhe punime me dorë në pazar.

9:15 Vizitë në ujërat termale të Peshkopisë
Ecje në kompleksin balnear të Llixhave të Peshkopisë dhe një njohje e shkurtër me shërbimet, trajtimet dhe historikun e kësaj qendre kurative balneare. Mund të vizitohet vaskat me ujërat termale dhe burimi i ujërave të termale.
Nga pika informuese turistike tregohet edhe "gradishta e Begjunecit", si një pikë me rrënoja historike si dhe pjesa e livadheve të Peshkut kanë qenë qendrat e manastireve dhe kishave, nga të cilat ka marë emrin edhe Peshkopia.

9:40 Ndalesë tek mulliri i ujit të Saraçëve
Shikohet stili i veçantë i ndërtimit dhe puna që bëhet në mullirin e ujit. Shikohen burimet e ujit të ftohtë, që gjithashtu përdoren për arsye kuruese.

10:25 Vrojtim i bukurive të Luginës së Shërimit nga "Hunda e qytetit"
Nga pika vrojtuse tek kodra "hunda e qytetit", mund të provohen dhe shijohen bukuritë e luginës së Shërimit, burimi e ujit të ftohtë (izvori), dhe pamja e fshatrave të Bellovës, Cerjanit dhe Rabdishtit.

10:30 Ecje tek "Lugu Arushës"
Lugu Arushës është një nga kanionet e përroit të Rabdishtit. Pyjet e bukura të Boravikut me përbërje gipsi e shkëmbinj janë një mjedis i përshtatshëm për faunën e egër. Për shkak të burimeve ujore, legjenda tregon që arrinjtë vijnë nga mali për të pirë ujë dhe prandaj e ka marrë edhe këtë emër.

13:00 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete

14:30 Ecje në plantacionet dhe agro-ferma në Rabdisht
Vizitorët mund të shikojnë plantacione me mollë, ara të mbjella me patate, tipike të zonës. Në horizont shihet gjithë lugina e Shërimit.

15:30 Vizitë në fshatin e gurtë të Rabdishtit
Fshati është një nga 100 fshatrat turistikë në Shqipëri. Pozicioni malor, dhe stili i ndërtimit i gjithi me gurë si dhe rrugicat e shtruara me kalldrëm, i japin pamjen dhe emrin fshatit si "fshati i gurtë". Vizitorët shikojnë dhe prekin me sytë dhe duart e tyre jetën tipike të fshatit.

**16:30 Akomodimi te shtëpitë pritëse.
Darkë tradicionale familjare**
Rekomandohen për shtëpi pritëse
SABRI SHAHINI 0695114003/ 0683240675
guesthousesabriu@gmail.com

FITIM GOLECI 0696429888
guesthousefitimgoleci@gmail.com

Dita 2

Ngjitje dhe ecje në Bjeshkën e Rabdishtit

8:00 Mëngjesi ke shtëpia pritëse

9:00 Vizitë në Bjeshkën e Rabdishtit
Ecje malore e moderuar në këmbë dhe për çantat përdoren kuaj ose mushka. Rrugës për në bjeshkë peizazhi është shumë i bukur, pjesë e parkut natyror Korab-Koritnik. Udhëtimi zgjat 3.5 orë.

12:30 Dreka është e paketuar dhe marrë me vete

16:30 Vizitë në fshatin Zagrad
Fshati Zagrad ka një peizazh të bukur rrëzë malit të Skërtecit, nga i cili ka marë edhe emrin si Guri i Zi. Shtëpitë janë prej guri dhe rrugët me kalldrëm.
Shtëpitë e pakta në numër kanë bagëti të imta, bletari, dhe shquhen për pataten.

16:30 Akomodimi tek shtëpitë pritëse
XHEVIT FETA 0682338056

19:00Darka në shtëpinë pritëse

Dita 3

Turi i qytetit të Peshkopisë

8:00 Mëngjesi ke shtëpia pritëse

9:00 Ecje në monumentet e kulturës dhe natyrës së Bellovës
Një peizazh i mrekullueshëm i grykës së malit të Skërtecit të ofron natyrë të mrekullueshme, ku legjendat dhe monumentet e natyrës ndërthuren me njëra-tjetrën. Vizitohen rrënojat parahistorike të "Kepit të Qytetit", një vendbanim i hershëm arkeologjik, shpella e Bellovës, një monument natyre, si dhe burimet ujore të Bellovës, një hidromonument i natyrës.

12:00 Dreka në Peshkopi
Restorant "Natyra e qetë" në lagjen Llixha, Restorant EIBA tek lagja e vjetër ne Peshkopi, Restorant "Kica", ose Restorant "Zerja" në kodrat e qytetit.

14:00 Turi i qytetit të Peshkopisë
Fillon në lagjen e vjetër, ku vizitorët njihen më historinë e vjetër të lagjes, te godina e bashkisë Dibër, ish godinën e vjetër të bashkisë së parë të qytetit, që daton në vitin 1920. Pastaj vazhdon në bulevardin kryesor të qytetit. Ecje përgjatë bulevardit dhe vizitë te Zyra e Informacionit Turistik, ku mund të njihen me atraksionet turistike të Dibrës dhe të blejnë suvenire të ndryshme. Një qëndrim para bustit të Skëderbeut, i cili, ndryshe nga qytetet e tjera, Skënderbeu është në këmbë dhe pa përkrenare, duke qenë se ai është bir i Dibrës. Ndalesë te muzeu i qytetit të Dibrës, ku janë pavijonet e arkeologjisë, etnografisë dhe historisë.

16:00 Kafe ose birë në një nga baret e shëtitores

16:30 Vizitë në lagjet e qytetit
Vizitorët njihen me ndërtimet karakteristike të qyteteve në kohën e komunizmit dhe organizimin social dhe shoqëror. Vizitojnë një qendër të fortifikuar si dhe stadiumin e qytetit.

17:00 Akomodimi në hotel
Sugjerohen:
GUEST HOUSE "KONAKU" 0692053492
hsalkurti@gmail.com
AGRO-TURIZËM DASHE ZERJA 0699377337
fabianzerja@gmail.com
GUEST HOUSE "UKA" 0673625835
udhetomegresin@gmail.com
KAMPINGU "KAPXHIU, PESHKOPI"
069-2258182 campingpeshkopi@gmail.com
HOTELET E QYTETIT
Adresat i gjeni tek www.visitdiber.al
19:00 Darka
Rekomandohen larmi darkash si ne restorane dhe darka familjare.

Ky projet u mbështet nga D2T "Dibra: Turizëm dhe traditë"

cyan magenta yelloë black



4 Maj 2019
- Big Market në Peshkopi

Nuk ka veprimtari, sidomos në Tiranë, që lidhet me kulturën e sportin, ku emri i Musait të mos jetë i pranishëm me një kontribut sado të vogël. Dhe këtë nuk e bën se është i pasur e ka miliona në bankë, se të pasur e milionerë ka më shumë se ai, por ai ka një dashuri të madhe për vendlindjen, për Dibrën. Dhe gjithmonë e ka vrarë mendjen se çfarë duhet të bëjë. Dhe duket se e ka vendosur kthimin në vendlindje me një investim me një nga markat më të njohura në vend: Big Market.

Kthimi i Musait

Prej gati 25 vitesh, ndërsa propagandonim nevojën e një rruge të re për Dibër, njëra nga pyetjet që na lodhte më shumë ishte: A ka fuqi ekonomike Dibra që ta justifikojë ndërtimin e një rruge të re?

Atëherë, kur fjala "ndihma" përmendej më shpesh se fjala "punë", përgjigjja e kësaj pyetje nuk mund të thuhej me dy fjalë. Kërkonte argumente, fakte, statistika e shifra që edhe një ekonomist do ta kishte të vështirë t'i përpunonte. Por, mes shumë argumenteve, kishim një që ishte i pakundërshtueshëm: rruga do të ndalonte braktisjen e këtyre zonave. Do të ndalonte migrimin e brendshëm, madje shtonim se rruga do t'i rikthente njerëzit në vendlindje...

Dhe sot, kur gati 30% e punimeve në Rrugën e Arbrit kanë mbaruar, pyetja që na bren më shpesh është se a do të jetë fizibile ajo? A do ta justifikojë ekonomikisht lëvizjen e mallrave dhe njerëzve?

Unë jam njëri prej atyre që besoj se pritshmëritë do të jenë më të larta se të atyre që besojnë. Sapo qeveritarët e asaj kohe e premtuan ndërtimin e Rrugës së Arbrit, pati menjëherë një rritje të çmimit të banesave, duke i krahasuar ato me çmimet në periferi të Tiranës.

Specialistë të ndryshëm kanë argumentuar se me ndërtimin e Rrugës së Arbrit shumë fusha të ekonomisë do të marrin zhvillim të shpejtë, përfshirë investimet në bujqësi, frutikulturë, blegtori, turizëm, etj. Dhe më e rëndësishmja, do t'i kthejë njerëzit në vendlindje.

Dhe një ndër të parët në këtë kthim është Musa Riçku.

Musai e ngriti biznesin e tij në Peshkopi në kushte të vështira. Pas një përvoje të shkurtër në emigracion, ai kuptoi se e ardhmja e tij ishte në vendlindje. Ka njerëz që marrin vendime çdo mbrëmje, por heqin dorë të nesërmen në mëngjes. Por Musai është njëri prej atyre që mëngjesin e pret zgjuar, për të realizuar vendimet e tij. Dhe shumë shpejt kthehet në një nga tregtarët më të mëdhenj në Dibër. Madje, në vitin e mbrapshtë 1997, në ato ditë të vështira kur bandat kishin marrë nën kontroll rrugët, Musai ishte vetë "shteti", duke garantuar furnizimet me ushqimet bazë për të gjithë rrethin e Dibrës.

Ndërsa biznesi po rritej, banorët po e

Për shumëkënd, ndërsa shikon punimet në tunel dhe i duket e largët dita e përfundimit të punimeve, Musait i duket sikur ajo është hapur. Sepse ai u kthye në Peshkopi me një investim. Tani mbetet ta ndjekim ne të tjerët, duke investuar në ndërtim, turizëm, shërbime, industri, bujqësi e frutikulturë, për t'i dhënë një mundësi Dibrës për t'u zhvilluar ekonomikisht.



braktisnin çdo ditë Peshkopinë. E mes tyre edhe Musai iku, duke ndërtuar një biznes të ngjashëm në Tiranë, por gjithnjë me kokën pas nga vendlindja...

* * *

Unë kam kontakte me Musain prej 15 vitesh, kryesisht prej bashkëpunimit në gazetën Rruga e Arbërit, e cila na ka afruar më shumë dhe na ka bërë të diskutojmë më shpesh. Kafet e mëngjesit, sidomos kur gazeta del nga shtypi, është e përbashkët. Megjithëse ka ngritur një biznes të suksesshëm në Tiranë, ai e ka kokën gjithmonë nga Dibra. Musa Riçkut i del emri te veprimtaritë e shoqatave dibrane si donator, te librat si kontributor, te gazeta si aksioner, te sporti si dhurues... Nuk ka veprimtari, sidomos në Tiranë, që lidhet me kulturën e sportin, ku emri i Musait të mos jetë i pranishëm me një kontribut sado të vogël. Dhe këtë nuk e bën se është i pasur e ka miliona në bankë, se të pasur e milionerë ka më shumë se ai, por ai ka një dashuri të madhe për vendlindjen, për Dibrën. Dhe gjithmonë e ka vrarë mendjen se çfarë duhet të bëjë. Dhe duket se e ka vendosur kthimin në vendlindje me një investim me një nga markat më të njohura në vend: Big Market. Natyrisht, në këtë investim nuk është i vetëm, por ai është ideatori dhe këmbëngulësi që ky emër i madh i rrjetit të dyqaneve ushqimorë të hapet në Peshkopi.

Përmes këtij investimi fiton qyteti i Peshkopisë. Përveçse janë punësuar 21 gra e vajza, do të ketë edhe bashkëpunim me biznesin e vogël vendas, kryesisht prodhues, artikujt e të cilëve do të gjejnë vend të veçantë në market. Gjithashtu, në një të ardhme të shpejtë, prodhimet e Dibrës do ta gjejnë veten në çdo raft të Big Market në të gjithë vendin.

Qytetarët e Peshkopisë do të kenë mundësi të përfitojnë nga ofertat e vazhdueshme të rrjetit të Big Market, njëlloj si në të gjithë Shqipërinë.

Ndërsa përgatitjet e fundit për hapjen e marketit vazhdonin, Musai iu bashkua në Tiranë grupit të ekskursionistëve që zhvilluan një ekspeditë në tunelin e Murrizit. Për shumëkënd, ndërsa shikon punimet në tunel dhe i duket e largët dita e përfundimit të punimeve, Musait i duket sikur ajo është hapur. Sepse ai u kthye në Peshkopi me një investim. Tani mbetet ta ndjekim ne të tjerët, duke investuar në ndërtim, turizëm, shërbime, industri, bujqësi e frutikulturë, për t'i dhënë një mundësi Dibrës për t'u zhvilluar ekonomikisht. Për ta kthyer Dibrën në një qendër të zhvilluar ekonomike, siç ajo i ka të gjitha mundësitë.

Bujar KAROSHI







Mësuesit Naim e Lirie Babameta, Agim e Nigjare Shqerra, Liman Deshati etj., e ngritën më lart cilësinë mësimore...

Arsimi në rrjedhën e viteve për qëndresë dhe përparim

(vijon nga numri i kaluar)

Kështu në mars të vitit 1927, merr udhë shkolla e parë shqipe e Grevës në një dhomë pranë xhamisë me mësues të parë z.Qamil Luzha nga fshati Luzhë i Gjakovës. Sipas Teki Selenicës, në këtë vit,Greva përbëhej nga 317 frymë.

Mësuesi erdhi së bashku me familjen e tij dhe menjëherë iu vu punës. Nisi pastrimin e dhomës,ndërtoi ca stola të gjatë,një si dërrasë të zezë dhe filloi rregjistrimin e nxënësve. Nga dëshira e madhe e vetë fshatarëve dhe të vetë fëmijëve për të mësuar në klasën e parë u regjistruan 28 nxënës ,të gjithë djem te moshës 8-12 vjeç.

Në këtë shkollë erdhën të vijojnë mësimet edhe fëmijë nga fshatrat: Melan e Trenë. Kështu 19 nxënës ishin nga Greva si: Iljaz Rexhepi,Liman e Avdulla Deshati ,Baftjar e Mustafa Bunguri,Hysen,Baftjar e Shaqir Ferruku,Qazim Daci, Daut,Qazim e Xhelil Kryemadhi,Nesim Baruti,Adem e Nezir Tifeku,Ferit Zerja, Shuaip Spahiu,Tosum e Met Fida. Pesë nxënës ishin nga Trena: Shaban Spahiu, Baftjar e Ramadan Fisniku, Rasim Kaja, Haxhi Xhajku. Katër nxënës ishin nga Melani: Mirvet Rama, Rasim e Eqerem Elezi, Haxhi Shkreta.

Mësues Qamili shumë shpejt hyri në zemrat e fshatarëve, i bëri për vete me babaxhanllëkun, thjeshtësinë ,kulturën e horizontin e tij. Megjithëse banonte së bashku me familjen e tij në shtëpinë e Selman Nuzit, pak i binte të rrinte në shtëpinë e tij, pasi fshati e respektonte dhe e ftonte që të ishte i pranishëm në festat ,gëzimet e hidhërimet e tyre. Afria që krijoi mësues Qamili u dha mundësi dhe disa djemve shumë të rritur në moshë që të vazhdonin shkollën si të jashtëm,ndonjëherë dhe si dëgjues në orë të veçanta, kur ato kishin kohë të lirë, pasi liroheshin nga punët e shtëpisë.

Kështu si nxënës të jashtëm mësuan shkrim e lexim shqip: Zabit Hoxha, Osman e Isa Fida etj. Mjaft nga ish nxënësit e shkollës shqipe të Grevës që përmendëm më sipër, me 4 klasë që mbaruan , përballuan mjaft detyra të rëndësishme në atë kohë si në: tregti, ekonomi, ushtri, mjeksi etj. Edhe mësues Qamili ruajti një respekt të veçantë për fshatin e Grevës e për ish nxënësit e tij të parë.

Me rastin e 60 vjetorit të kësaj shkolle në vitin 1987,mësues Qamili solli një letër falenderimi për mësuesit dhe fshatarët dhe fotografinë e tij . Në letër kërkon falje pasi atë e ka shkruar mbesa meqë ishte në moshë shumë të madhe dhe i dridheshin duart. Mësuesi Qamil Luzha qe një atdhetar i flaktë,një figurë me përmasa kombëtare.Atdhetarizmin e tij ai e tregoi gjatë tërë viteve të vepritarisë së tij si mësues,si edukator i brezit të ri. E ndoqëm me dhimbje të madhe një emizion për Kosovën që dha TVSh para disa vitesh kur njoftonte mbi vdekjen në moshën 93 vjeçare të mësuesit të parë të Grevës Qamil Luzha.

Mësimet shqip të fëmijëve të Grevës, pas trasferimit të mësues Qamilit në Muhur,erdhën të tjerë mësues të nderuar si: Adem Sharofi, Sabri Abulja, Adem Shehu etj. Këta mësues me punën e tyre edukuan tharmin atdhetar në masën e fshatarëve. Greva u bë çerdhe e rezistencës antifashiste, ku mbi 30 djem e

Me rastin e 60 vjetorit të kësaj shkolle në vitin 1987,mësues Qamili solli një letër falenderimi për mësuesit dhe fshatarët dhe fotografinë e tij . Në letër kërkon falje pasi atë e ka shkruar mbesa meqë ishte në moshë shumë të madhe dhe i dridheshin duart.



Mësuesja T.Qosja me rrethin letrari i ri



Mësuesja S.Daci me klasën e 4 Grevë

burra rrokën armët për liri dhe dy ranë dëshmor. Edhe gjatë luftës, falë kontributit të vetë fshatarëve shkolla nuk u ndërpre.

Në këtë periudhë gjurmë lanë mësuesit: Naim e Lirie Babameta, Agim e Nigjare Shqerra, Liman Deshati etj. Ata e ngritën më lart cilësinë mësimore, përgatitën dhe ngjallën dëshirën te nxënësit e tyre që të vazhdonin edhe më tej shkollën 7 vjeçare në Peshkopi, ndonëse kjo ishte jashtë çdo detyrimi.

NË VIJIM...

Pas vitit 1946 filloi masivizimi i arsimit në zonën tonë. Përreth fshatit Grevë, në vitin 1946 u hapën shkollat fillore në: Pjeçë me mësues Destan Agën, në vitin 1948 në Ilnicë me mësues Besim Fisnikun, në vitin 1951 në Trenë me mësues Ndoc Gazin nga Shkodra, pastaj në Trepçë.

Në vitin 1958 u hapën shkollat edhe dy në fshatrat e zonës: në Pejkë e në Melan, duke kompletuar të gjithë zonën me shkollat fillore shqipe. Në këtë kohë shkolla e Grevës është qendër e zonës ku drejtohej tërë puna kualifikuese, ndihmëse e kontrolluese. Duke parë kërkesat e vazhdueshme në rritje të fshatarëve për të rritur shkallën e arsimimit të fëmijëve të tyre, pasi në këtë kohë qe bërë dhe kolektivizimi (Kooperativa bujqesore u formua në vitin 1956 me 12 familje, dhe në vitin1957 u fut gjithë fshati). Në vitin 1959, (pas 42 vitesh nga hapja e shkollës së parë shqipe në Grevë) u hap shkolla e parë shtatëvjeçare në Grevë me drejtor ish nxënësin e kësaj shkolle Avni Fidën. Nxënësit në klasen e 5-të filluan të vijnë edhe nga shtatë fshatrat e tjerë përreth Grevës që nga Trepca, Pjeça, Pejka, Melani, Ilnica, Trena, Begjuneci.

Si nxënës të kësaj klase mund të përmendim: Nexhat Bungurin, Hajri Baruti, Xhide e Hajrie Fiden, Festime Kryemadhin, Shaban Xhajkun, Eshref Fida, Durmish Ferukun, Miftar Balliu, Sulejman Kata, Naim Fida, Rakip Poci etj. Mësuesit e parë të kësaj klase dhe të tërë ciklit të lartë (5-7) ishin: Skender Shatku, Hysni Çipuri, Mirush Mati, Fari Hysa, Myrteza Baboci.

Këto mësues dhanë mësim për rreth 15 vjet edhe në klasat e mbrëmjes e duke mos qenë nga fshati , banonin te shtëpia e Zeqir Bungurit. Banimi i mësuesve në fshat i lidhi dhe integroi ato më mirë me jetën .Jo vetëm rritën cilësinë e arsimit por gjallëruan dhe ngritën më tej edhe jetën kulturore, artistike e sportive të fshatit. Deri në vitin 1966 për vështirësi lokali mësimi zhvillohej me dy turne. Në po këtë vit u shkëputën shkollat e zonës së Melanit në një drejtori më vete (Melan,Pejkë,Pjeçë e Trepçë) dhe u liruan ambjente mësimi.

DREJTORI M.XHEMBULLA,MËSUESI S.MUGLICA, D.SHEHU ME RRETHIN E BIOLOGËVE DHE KIMISTËVE TE RINJ.

Në vitin 1969 drejtoria e Grevës (krahas Grevës, përfshihen dhe ciklet e ulta të Ilnicës,Trenës dhe Begjunecit) me një populsi prej 1326 frymësh kishte 248 nxënës. Më vonë cikl ulët Begjunec kaloi në vartësinë e drejtorisë së shkollës 8 vjeçare "Irfan Hajrullaj"(Peshkopi),ndërsa më vonë edhe cikli ulët Ilnicë kaloi me drejtorinë e Melanit).

Me ndërtimin e godinës së re të shkollës së Grevës (viti 1983, në pronën e Zeqir Bungurit),u krijua mundesia që mësimi të bëhej me një turn .U rrit shumë numri i klasave me hapësira më të mëdha, u krijua mundësia dhe u ndërtuan një sërë kabinetesh ,laboratorë ,si dhe një biblitekë shumë funksionale me një fond të admirueshëm librash.

Në vitin e mbrapshtë të 1997-tës ,ku me qindra objekte social kultore u dëmtuan dhe shkatërruan, në shkollën e Grevës nuk u dëmtua asnjë kabinet apo laborator, nuk iu thye qoftë edhe një xham. Dëshmi që tregon se populli i fshatit Grevë është mjaft arsimdashës dhe i kulturuar.

Në vitin 1999 pranë shkollës së Grevës vijuan mësimet 206 nxënës(109 në kl. I-IV, 97 në kl. V-VIII si dhe 49 fëmijë në kopshtet Grevë dhe Trenë). 66 nxënës ose 33 % e tërë nxënësve të shkollës që vijonin mësimet u vlerësuan me notat 9 e 10, tregues që flasin për kontigjent nxënësish shumë të mirë,dhe që motivonin mësuesit për një përkushtim dhe punë më cilësore me ta. Në këtë vit në këtë shkollë jepnin mësim 17 mësues,të gjithë me arsim përkatës (4 nga Peshkopia dhe 13 të tjerët vendas) të cilët punonin me mjaft pasion e përkushtim. Në këtë periudhë shkolla u përfshi në projektin e AEDP "Dibra 2000", ku morën udhë shumë projekte si:

- kualifikimi i drejtuesve të shkollës.
-testimet në lëndën e matematikës.
- agjitacioni figurativ në shkollë
- rrethet jashtëshkollore ,ku rrethi letrar i shkollës përgatiti dhe botoi librin me poezi (30+1), etj.

Shkolla shqipe e Grevës në vitin 1987,perkujtoi 60 vjetorin e saj, ndërsa në vitin 1999 u festua në mënyrë madhështore 70 vjetori (u spostua prej v.1997), me shumë aktivitete e pjesmarrje shumë të madhe nga i gjithë komuniteti i fshatrave të zonës .Krahas të ftuarve nga institucionet e Qarkut, arsimit të rrethit, Komunës,mori pjesë dhe ish Ministri i Arsimit z.Et'hem Ruka, i cili përgëzoi jo vetëm kolektivin e mësuesve e nxënësve por dhe komunitetin për përpjekjet dhe arritjet e kësaj shkolle. Vlen të falenderojmë për kontributin financiar, për organizimin dhe festimin e 70 vjetorit të shkollës: SNV Peshkopi dhe të gjithë familjet e fshatit Grevë.

Ja vlen të theksohet se në vite shkolla e Grevës, ka realizuar 100 % planin e edukimit dhe se asnjë nxënës nuk është shkëputur nga kjo shkollë pa e mbaruar atë. Një tregues kuptimplotë është se nxënësit e Grevës dallonin për përgatitje të lartë dhe zinin vende nderi nëpër aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive në shkallë rrethi (të cilat me thënë të vërtetën ishin të shumta e të larmishme).

Ndërsa në konkurset në shkallë rrethi, apo në konkurset e pranimit në shkollat e mesme, nxënësit e shkollës sonë kanë zënë pothuajse gjithmonë vendet e para.

Nga shkolla e Grevës kanë mbaruar në sistemin me dhe pa shkëputje nga puna, apo me korespondencë mbi 2000 nxënës klasën e shtatë, tetë e të nëntë.(sipas sistemeve të kohës).

Nga nxënësit e dalë nga kjo shkollë kanë vazhduar e mbaruar shkollën e mesme mbi 500 nxënës. Nga këto kanë mbaruar arsimin e lartë në degë e profile të ndryshme afro 100 ish nxënës: mësues 25, inxhinier 20,ekonomist 15, oficer 10, mjek 10 ,agronom 8,veteriner 7, etj).

Ndaj mund të thuhet pa mëdyshje se rruga 92-vjeçare e arsimit shqip në shkollën e Grevës, është një rrugë suksesi në procesin e qëndresës ,arsimimit, përparimit, është një rrugë e mbushur me arritje cilësore në të gjithë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Në shkollën e Grevës kanë dhënë kontributin e tyre mbi 140 mësues.Gjatë do të mbahen mend në kujtesën e ish nxënësve drejtuesit: Avni Fida, Muhamet Xhembulla, Xhevrije Kackini, Kimete Kata, Hysni Çipuri, Gani Hoxha, Nehat Daci, Behar Hoxha, Laugjen Bunguri, Lazim Fida, Agron Çenga, apo mesuesit: Qamil Luzha, Adem Sharofi, Lirie e Naim Babameta, Kibe Lleshi, Shqipe Fida, Skender Shatku, Arian Kadiu, Selami Muglica, Ajet Fida, Idriz Bulku, Bedri Shehu, Sabah Shehu, Durmish Shehu, Ahmet Caushi, Enver Zeneli, Mirush Mati, Xhevdet Tusha, Kujtim Neli, Shahin Lazri, Shpresa Bunguri, Lushe Bunguri, Premtim Kryemadhi, Suzana Daci,Teuta Qosja, Sevdije Fida, Nimet Fida,Burbuqe Barut, Aferdita Kryemadhi etj.

Përulemi me respekt për të gjithë ato mësues apo nxënës që mësuan dhe kontribuan në këtë shkollë por që nuk jetojnë më. Mbi 250 nxënës nga kjo shkollë kanë mbaruar 8 vjeçaren me rezultate të shkëlqyera. Mund të përmendim: Hajri Sula, Adem Bunguri, Setki Bunguri, Qemal Fisniku, Jahe Fida, Shaban Alija, Qazim Nurçja, Sulejman Alija, Shime ,Danjiela e Fatbardh Bunguri,Mentas ,Qeram ,Edlira Daci, Dritan Korumi, Muharem Baruti,Ylber e Elena Ferruku, Fetah e Hamza Kazia,Eduart Ferruku, Shyqyrie Hoxha, Klodiana e Dorjan Daci, Klotilda Fida, Elona Tifeku, Fisnik Spahiu , Avdulla Kaja Silva e Sovjeta Kryemadhi, e shumë e shumë të tjerë. Të na falin të gjithë ato ish mësues që nuk kemi patur mundësi për ti përmendur(ndonëse nuk janë dhe të paktë). Po ashtu dhe të gjithë ato nxënës shembullor në mësime që mund ti kem harruar apo ata nxënës që janë dalluar edhe në fusha të tjera të krijimtarisë, artit, sportit etj... që mund ti kem harruar.

SOT ...

Lokali tashmë ku zhvillohet procesi mësimor në Grevë është një lokal cilësor i rikostruktuar dhe falë përkushtimit të mësuesve e nxënësve është mirëmbajtur. Shpërngulja e familjeve nga fshati i Grevës që filloi pas viteve '90 ,e që u bë pothuajse masive pas vitit 2000 bëri që të ulet shumë numri i familjeve ,gjithësesi dhe numri i nxënësve.Dikur të gjitha klasat e V-VIII ishin me nga dy paralele,sot klasat janë teke dhe me një numër mjaft të reduktuar nxënësish, madje dhe dy klasa të bashkuara bashkë.

Në Trenë funksionon një kopësht me mbi 10 fëmijë ku jep mësim një edukatore.Cikël të ulët në Trenë nuk ka, pasi të gjithë nxënësit nga I-IX vijojnë në Grevë. Në Grevë ka një kopësht me 20 fëmijë ,me një edukatore, 8 klasa teke nga kl .1-9 me përjashtim të kl.VI dhe VII që janë të bashkuara. Pranë kësaj shkolle vijojnë mësimet 89 nxënës,ku japin mësim 14 mësues.

Ndaj mund të thuhet pa mëdyshje se rruga 92-vjeçare e arsimit shqip në shkollën e Grevës, është një rrugë suksesi në procesin e qëndresës ,arsimimit, përparimit, është një rrugë e mbushur me arritje cilësore në të gjithë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.

Nehat Daci

Ish nxënës dhe drejtor i shkollës Grevë.

portret

Muharrem Gjoka, njeriu
që la gjurmë kujtese nëpër Shqipëri...

Muharrem Gjoka, *burri i mirë i Dardhës dhe Dibrës*

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Njëri prej djemve të mirë të Dardhës dhe Dibrës, quhet Muharrem Gjoka, njeriu që edhe pse iku shpejt nga vendlindja e tij Zall-Dardha, kthen koken pas shpeshhere dhe gjindet pranë njerëzve dhe vendit të tij. Por nuk thonë kot që mbi vështirësi, ndodh që njeriu ndërton edhe një lumturi dhe si duket rrugëtimi i tij i kahershëm, i shërbeu si një shkollë e dytë, por edhe si një trampolinë për njeriun e mirë, fisnik dhe human i cili sot gëzon respektin e të gjithëve. Muharremi lindi në vitet e luftës, më 16 qershor të vitit 1943, por siduket kjo femijëri e bëri më të fortë jo vetëm fizikisht, por edhe mendërisht, ndaj në moshë fare të re, mori "arratine" nga fshati dhe eci rrjedhshëm, ashtu si Drini plak, nëpër shtigjet dhe vendet e ndryshme të Shqiperise. Ishte fare i vogel, kur me një trastë në shpinë, ai del nga dera e shtëpise bashkë me kushurinjte e tij, Sinanin, Xhaferrin dhe Osmanin dhe niset për në "kurbetin e largët", por brenda kufijve të Shqipërise. 16 vitet që kishte mbi supet e njoma, nuk e trembën djaloshin darnjan të guxonte për një tjetër jetë, në shërbim të familjes dhe Atdheut. Me bukën me gjizë me vete, orët e gjata të rrugës së vështirë e dërguan drejt Kurbneshit dhe më pas në Skuraj afër Milotit, aty ku ndodhej kantieri "Rruga Ura". Kësisoj Skuraj bëhet stacioni i parë i udhëtimit të përhershëm dhe të përjetshëm, që Muharrem Gjoka zgjodhi në jetën e tij, duke afrimuar cilësi të jashtzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë. Aty ai mori mësimet e para për jetën dhe jo pak por katër vjet, duket se e poqën më shpejt se vitet, që tashmë kishin shkuar tek 20-ta. Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej ketu dhe mbrojtja e Atdheut e kërkon në Bilishtin e larget, në kufirin me Greqinë.

Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, por duke lënë gjurmët e mira të një dibrani te guximshëm e patriot dhe të një ushtari e djali të mirë. Tre muaj përpara se të mbyllte vitet e ushtrisë, ai martohet me një vajzë po kaq të mire nga familja Hyseni në Reç e cila quhej Xharie dhe do të ishte bashkshortja dhe bashkudhetarja e jetës së tij.

Sherbimin ushtarak e kreu me sukses dhe sërish do t'i rikthehej punës, aty ku e la, në këtë kantier të Rruga Urës, por që tashmë kishte një tjetër stacion, në Ndërfushas të Mirditës. Vitet e ushtrisë i kishin dhënë personalitet e duhur djaloshit dibran, që tashmë merrte përsipër edhe role të tjera të drejtimit. Në ato vite hapja dhe ndërtimi i rrugëve kishin marrë një tjetër zhvillim dhe aty vinin shumë punëtorë nga fshtara dhe qytete të vendit.

Kësisoj Muharrem Gjoka aty bashkohet edhe me bashkfshatarët dhe miqte e tij të mirë, Met Sula, Isuf Poleshi, por edhe mjaft te tjerë që erdhën nga zona e tij. Nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Reps, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Haprripe etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin e mire, duke fituar një personalitet të padiskutueshëm. Më pas në vitin 1967, cilësitë e tij dhe vrulli i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejes, madje aty edhe kreu stduimet e shkolles së mesme teknikem duke rritur më shumë nivelin e tij jo vetëm professional, por edhe intelektual.

Tashme shkollimi i jep mundësinë edhe të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qënë edhe drejtuesi i transporit dhe jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit, etj. Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontriboj për shumë vite. Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, Rruga Ura u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002.

Dy vjet më pas, pra në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë se ndali atë në vrullin e përjetshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes dhe vendlindjes, Dibrës dhe Shqipërisë. Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar të Dibrës, që përmes punësm fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend te merituar në shoqëri dhe komunitet.

Veprimtaria më e fundit në muzeun historik kombëtar në Tiranë dedikuar legjendës së burrnisë dhe mençurisë së Dardhës, Met Sula, kishte emrin, përkujdesjen dhe mbështetjen e tij, ashtu si shumë këngë dibrane të sponsorizuara, apo aktivitete bamirësie e sportive, që gjejnë gjithnjë dorën dhe zemrën e tij të pakursyer. Gazetari i mirënjohur sportiv I RTSH Defrim Methasani, organizoi pak kohë më pare në Dibër, një aktivitet dhe festë të madhe sportive.

Në udhëtimin e tij "Kthim në vendlindje", ai kishte edhe mbështetjen dhe bujarinë e Muharrem Gjokës, që u bë krah me dhuratat për nxenesit dhe rininë e fshatit Sohodoll, por ishte edhe vetë i pranishëm, me grupin e zgjedhur dhe elitar që gazetari kish marrë me vete nga Tirana për në fshatin ku lindi, duke e promovuar më së miri atë. Ai është mbi të gjitha një prind, që ka tre trashgimtarë model dhe djem të shkëlqyer, si Lutfiun, Edin dhe Gentin, tre djem që kanë ndërtuar me mund dhe djersë biznesin e tyre dhe janë super korekt me shtetin dhe idnidividin. Prej vitesh Muharremi është edhe gjysh, sepse i gëzohet katër mbesave dhe një nipi, por mbi të gjitha është edhe një mik i mirë, që gëzon një reputacion të admirueshëm kudo, në familje, shoqeri dhe komunitet. Rrugëtimi i tij drejt Zall-Dardhes, do të vijoi përsëri, sepse një tjetër ide i ka lindur në kokë, për të mundësuar një dokumentar për familjen dhe vendin e tij, si një shërbim madhor në njohjen e brezave me origjinen e tyre dhe të parët dhe si një mesazh për ata që do të vijnë... E pra, burrat e mirë, nuk mund të bëjnë ndryshe...!



Muharrem Gjoka, njeriu që edhe pse iku shpejt nga vendlindja e tij Zall-Dardha, kthen kokën pas shpeshherë dhe gjindet pranë njerëzve dhe vendit të tij.
Por nuk thonë kot që mbi vështirësi ndodh që njeriu ndërton edhe një lumturi dhe, si duket, rrugëtimi i tij i kahershëm, i shërbeu si një shkollë e dytë, por edhe si një trampolinë për njeriun e mirë, fisnik dhe human, i cili sot gëzon respektin e të gjithëve.

Muharrem Gjoka, i miri i të gjithëve

Njoha vonë, por vërtet ia vlejti njohja. Muharrem Gjoka erdhi tek unë si produkt i një shoqërie dhe admirimi që unë kam për artistin e madh të këngës dibrane Qerim Sula. Fillimisht, kur vëllezërit Keta organizuan në Tiranë ndeshjen e madhe për titull Europe në boks, bashkë me Qerimin i pranishëm në ndeshje ishte edhe Muharremi, një pasionant dhe mbështetës edhe i sportit. Por së fundmi në momentet që mjeshtri i këngës vuante nga një sëmundje nga zemra, njeriu që gjindej çdo ditë dhe natë pranë tij, ishte Muharremi. Duke qenë kushëriri i Qerimit, unë njoha edhe njeriun fisnik, tashmë si një burrë që bënte diferencën dhe ishte pranë halleve të njerëzve. Në fakt kisha dëgjuar të flitej për një burrë të atyre anëve, që dhuronte shumë mirësi, edhe pse kish jetuar larg Dardhës dhe Dibrës. Por promovimi i figurës së Met Sulës, legjendës së atyre anëve ku Muharremi ideoi dhe mbështeti këtë veprimtari dhe mbështetja për Qerimin, ishin dy arsye më shumë që Muharremi të ishte më shumë pranë meje. Korrektesa, bisedat, veprat dhe mirësitë e tij, më bënë ta dua dhe respektoj më shumë, tashmë edhe si një vlerë e shtuar e Dradhës dhe Dibrës, veçmas kur dëgjoja edhe nga të tjerët të flitej shpesh për të. Së fundmi, dy nga veprimtaritë dhe eventet sportive që unë bëra për sportin, njërën në Ulqin dhe tjetrën në vendlindje, Sohodoll, me vete kisha edhe burrin e mirë të Dibrës, që nuk nguroj të bënte zakonin dhe të më nderonte më shumë miq dhe të ftuar, tashmë jo vetëm mua, por edhe traditën dibrane. Së fundmi, në vend të mbylljes, m'u kujtua një shprehje e Remarkut. Për njeriun nuk janë të rëndësishme vitet në kalendarin e jetës, por gjurmët që lë pas në rrugëtimin e saj. E pra, Muharrem Gjoka është rrugëtari me shumë gjurmë, në qytete dhe fshatra të Shqipërisë, si një misionar i njeriut të punës, shpirtit human dhe ruajtjes së traditës.

Defrim METHASANI



Muharrem Gjoka mbi të gjitha është edhe një mik i mirë, që gëzon një reputacion të admirueshëm kudo, në familje, shoqeri dhe komunitet. Rrugëtimi i tij drejt Zall-Dardhes, do të vijoi përsëri, sepse një tjetër ide i ka lindur në kokë, për të mundësuar një dokumentar për familjen dhe vendin e tij, si një shërbim madhor në njohjen e brezave me origjinen e tyre dhe të parët dhe si një mesazh për ata që do të vijnë... E pra, burrat e mirë, nuk mund të bëjnë ndryshe...!

Dibra edhe në fushën e kulturës e të dijes është një mozaik, ka veçoritë e saj në çdo fshat a krahinë, ka prurjet dhe ndihmesën e saj, ka koloritin e vet, ashtu siç bie fjala ka koloritin e vet kënga popullore, veshja e burrave, e grave apo edhe fjala e folur në çdo krahinë.

Tablo përmbledhëse e historikut **të arsimit në Okshtun**

Nga Prof. As. **NAZMI KOÇI**

Nuk ka asnjë dyshim që e gjithë treva e Dibrës është shquar ndër shekuj nga dëshira e zjarrtë për dije e arsim, ndërsa kultura popullore u ka paraprirë këtyre aspiratave, të cilat ajo është përpjekur t'i sigurojë me çdo mjet e në të gjitha mënyrat, aq sa mund të themi se dëshira për dije e kulturë ka ecur paralel me dëshirën për jetën. Kjo nevojë jetike e ka shtyrë Dibrën dhe dibranët në kufijtë e të paimagjinueshmes, aq sa në mungesë të institucioneve të krijojnë shkollën e tyre, shkollën e Dibrës. Bëhet fjalë jo për një nocion teorik a metaforik, por edhe për një fakt real që e kanë njohur e pranuar shumë studiues vendas dhe të huaj.

Njihet se Dibra edhe në fushën e kulturës e të dijes është një mozaik, ka veçoritë e saj në çdo fshat a krahinë, ka prurjet dhe ndihmesën e saj, ka koloritin e vet ashtu siç bie fjala ka koloritin e vet kënga popullore, veshja e burrave, e grave apo edhe fjala e folur në çdo krahinë.

Edhe zhvillimi i historikut të arsimit, ndonëse ka ndjekur një rrugë e trajektore të caktuar si në të gjithë vendin dhe në Dibër, po ashtu është e vërtetë se ka veçoritë e veta dhe spiralen e vet të zhvillimit. Në këtë kuadër ai ka specifikat e veta, ka historikun e tij të pasur e të veçantë edhe në Okshtunin malor të Dibrës.

Specialisti dhe studiuesi i mirënjohur i arsimit dibran e atij kombëtar, Elmaz Lala, duke folur në një aktivitet promovues me 14 korrik 2014 do të deklaronte: "... Një familje nga Okshtuni i thellë dhe i ashpër, por me tradita patriotike dhe mikpritjeje, një familje që ndërsa luftonte për mbijetesë, pretendonte e luftonte si pak kush për jetën dhe të ardhmen, një familje shumë arsimdashëse, që shkollimin e fëmijëve e vinte edhe mbi bukën për ta...". E vërteta është se i tillë ishte i gjithë Okshtuni, edhe pse disa familje si rasti që përmend studiuesi E. Lala spikatnin më shumë. Po përpiqem të paraqes disa argumente në dobi të kësaj teze, më tepër sesa të tentoj të bëj një historik tradicional të arsimit në Okshtun, gjë që e kanë realizuar specialistë të tjerë para meje.

Nuk ka dyshim se shkolla e parë, si kudo tjetër, ka qenë familja dhe mësuesit e parë prindërit, vëllezërit e motrat, me të mëdhenjtë, që çdo ditë kanë përçuar tek më të vegjlit njohuritë për jetën, edukatën e punës, njohjen e origjinës së familjes e të fisit, traditat, zakonet, historinë, vlerat morale të fshatit, krahinës e më gjerë, dashurinë dhe respektin për familjen, për më të moshuarit, për vendin e lindjes dhe atdheun. Në lashtësi parakaluan në vendin tonë kultura ilire, helenike, latine, por dhe romake e bizantine derisa mbërritëm në sundimin shumë shekullor të perandorisë osmane.

Një rol të patjetërsueshëm kanë luajtur dhe tubimet e ndryshme dhe dhoma e miqve e oda e burrave, ku aplikoheshin "ushtrimet e mendjes". Ruajtjen ndër shekuj të këtyre vlerave në Dibër brez pas brezi, shkrimtari ynë i mirënjohur Haki Stërmilli, e quan "Pengjet e stërgjyshërve", ndërsa ruajtjen e gjuhës amtare si "Tapia e vendit"(1).


Këto vlera e tradita të trashëguara brez pas brezi u formësuan e u fuqizuan dukshëm dhe morën formën e një shkolle të vërtetë, e cila u emërtua si shkolla e Dibrës, tashmë e njohur dhe e pranuar nga studiuesit vendas e jo vetëm ata. Lulëzoi e u bë e mirënjohur shkolla e ndërtimit, e drurit, e gurit apo ajo e famshmja, e gojëtarisë dibrane.

Përpjekja e fshatarëve të Okshtunit për një arsim të organizuar e institucional zë fill herët që në kohën e perandorisë turke, në shekujt 18-19, ndoshta dhe më herët. Të detyruar nga hallet e jetës për të emigruar në vende të tjera si në Stamboll, Selanik, në Rumani, Bullgari e gjetkë, por dhe brenda vendit si në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Krujë, Kavajë etj,, ata siguronin punë dhe mbijetesë për vete dhe familjarët e tyre. Por shpesh ata merrnin me vete edhe djemtë e tyre të vegjël që fillonin herët rrugët e kurbetit. Meqenëse mosha e njomë dhe fiziku i dobët nuk i lejonin që të përballonin punët e rënda të ndërtimit, ata shpesh i fusnin në shkollat e qyteteve ku ndodheshin dhe i shkollonin atje. Këtë unë e konsideroj një veçori të arsimimit të okshtunasve, ndoshta më herët se zonat e tjera. Kështu veproi Sulë Shermeti nga Muglica, i cili e mori djalin e tij, Hasanin, me vete në Peqin të Elbasanit dhe e futi të studionte në shkollën turke aty. Më pas ai vazhdoi medresenë e Elbasanit, që e mbaroi me rezultate të shkëlqyera në moshën 22 vjeçare, ku mori titullin mësues e predikues i fesë dhe mësoi disa gjuhë të huaja. I shkëlqyer në mësime dhe i etur për dije, më pas ai studioi për inxhinieri dhe teologji në Universitetin e Stambollit, ku mësoi përsëri disa gjuhë të huaja dhe i mbaroi studimet shkëlqyeshëm në vitin 1879. Në enciklopedinë turke me këtë rast është shkruar: "Stambolli nëpërmjet Hasan Muglicës i ka dhënë arnautllëkut mësuesin e fesë islame" (9). Edhe perandoria turke e njihte Hasan Muglicën si mësues, të tillë e ka përjetësuar atë në enciklopedinë e saj.

Okshtunasi Maliq Caka e mori me vete djalin e tij, Sadikun, (babai i dëshmorit Sabri Caka), në Elbasan, ku shkoi të punonte dhe e dërgoi atë në shkollë, në medrese. Sadiku studioi dhe u shkollua me sukses dhe i mirënjohuri Hoxhë Caka u bë një figurë e respektuar në Okshtun e më gjerë, që zgjidhi sherre e pajtoi konflikte, hoxhë Muglica e pat aktivizuar atë edhe si mësues.

Kështu, veproi edhe Ferhat Selmani nga Prodani, i cili e mori me vete të birin, Selmanin, në Mat, ku ai pat vajtur për të punuar në fshatin Lis në vitin 1928, por atje e dërgoi djalin në shkollën vendase që ishte hapur në vitin 1922 me mësuesin e mirënjohur Abdurraman Permeti. Ai studioi me shumë sukses aty dhe më vonë do të vazhdonte shkolla e kualifikime, derisa u bë një mësues i spikatur dhe që punoi më shumë se 25 vjet në Prodan të Okshtunit.

Nuk ka diskutim se përpjekjet për hapjen e shkollave, qoftë dhe të atyre turke në Okshtun,



Hoxhe Hasan Muglica (1854-1915)

janë të lidhura me emrin e patriotit dhe atdhetarit të madh Hoxhë Hasan Muglica. Është vendi që të bëj një objeksion dhe të jap mendim lidhur me mbiemrin e tij. Për Hoxhë Muglicën janë shkruar artikuj e libra, ka një monografi të studiueses Valbona Ramçi dhe një libër biografik nga stërnipi i tij Elliot Hasan Muglica me banim në Kanada. Të gjithë këta publikime përdorin për patriotin e madh okshtunas mbiemrin "Moglica". Në të vërtetë mbiemri i tij është Sula, pasi ishin pasardhësit e Sulë Shermetit nga Dibra e Madhe që pat ardhur e u vendos në Okshtun. Mbiemrin Sula e mbajnë sot një sasi e konsiderueshme e familjeve në këtë fshat, ndërsa Hoxha mori për mbiemër, emrin e fshatit të tij, Muglicë. Të gjithë banorët e Okshtunit, të vjetër e të rinj, e dinë dhe e thërrasin Muglicë. Kështu e thoshte edhe gjyshi im, Abaz Sula, njëri nga njerëzit më të afërt të gjakut me Hoxhën dhe që citohet në shumë botime për të. Kështu e thoshte edhe Hajdar Stojku, njëri prej ish nxënësve të Hoxhës, që citohet nëpër botime dhe që kam pasur rastin ta njoh personalisht. Mbiemrin "Muglica" për patriotin Okshtunas e konfirmojnë edhe botimet e mëhershme (para Luftës së Dytë Botërore) që janë bërë lidhur me të si gazeta "Tomorri" e dates 24 mars 1910, Revista "Zani i naltë" (1937), Haki Stërmilli në veprën e tij "Dibra në prag të historisë" 1940 (1,11, 12) etj. Ka dhe një arsye të qenësishme përse insistoj në mbiemrin Muglica të patriotit të madh dibran. Sipas studiuesit të Hasan Muglicës, Xhemal Koçi (5, f.123), njeri shumë i afërt i familjes Muglica (ishte nipi i Abaz Sulës), duke shqyrtuar arkivat kishte hasur në tentativë për ta tjetërsuar vendlindjen e tij nga Muglica në Moglicë, pra, nga Dibra në Korçë, çka është një shtrembërim i padiskutueshëm i së vërtetës. Në Dibër ka Muglicë, ndërsa në Korçë ka Moglicë, janë dy toponime krejt të ndryshme.

Shumë studiues që janë marrë me historikun e arsimit të Okshtunit, referojnë se Hasan Muglica hapi shkollën te ara e Martinit në vitin 1904. Në këtë shkollë Hoxha aktivizoi si mësues edhe dy hoxhallarë, Hoxhë Cakën dhe një Hoxhë nga Zabzuni që dinin vetëm turqisht. Ndërsa mësimet në gjuhën shqipe Hoxhë Muglica i zhvillonte vetë dhe këtë aktivitet e kishte filluar shumë kohë më parë. Sipas kujtimeve të Abaz Sulës dhe Hajdar Stojkut, njëri prej nxënësve të tij, mësimet në gjuhën shqipe Hoxhë Muglica i kishte filluar që në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit 19-të (13). Fillimisht ai kishte përdorur për këtë qëllim shtëpinë e tij. Shumë studiues e kanë theksuar faktin se Hoxhë Muglica e ktheu shtëpinë e tij prej 28 dhomash, veçse si shtëpi banimi, në shkollë dhe bibliotekë të librave të gjuhës shqipe. Ajo shërbeu edhe si kështjellë për t'u mbrojtur nga sulmet e panumërta që pushtuesit e ndryshëm veçmas ata



Mentor Muglica (1953-2016)

turq e serbë, i organizuan shumë herë për ta kapur e asgjësuar patriotin e dijetarin dibran. Hajdar Stojku, nxënës dhe bashkëkohës i Hoxhë Muglicës, në kujtimet e tij dhënë arsimtarit Selman Koçi, ka sjellë edhe një fakt jo të njohur deri sot. Shtëpia e Hoxhë Muglicës ka shërbyer edhe si konvikt, ku në kohë dimri, nxënësit e lagjeve të epërme kishin dhoma për studim e fjetje dhe ushqeheshim aty me shpenzimet e mësuesit (13). Për t'u mbrojtur nga regjimi i kohës ose në periudha rreziku, Hoxhë Muglica i largonte nxënësit nga shtëpia e tij dhe mësimet në gjuhën shqipe i zhvillonte te valanica në Zallë e maskuar midis shelgjeve, mes Okshtunit dhe Sebishtit. Ai pat ndërtuar aty një punishte shajaku që punonte me ujin e lumit dhe e emërtoi me fjalën e bukur shqipe valanisë (vala e nis) dhe populli e thërriste valanicë. Kjo shërbeu edhe për takime të fshehta që hoxha organizonte herë pas here, por edhe si shkollë për mësimin e gjuhës shqipe. Në vitin 1904 u hap në Okshtun shkolla te Ara e Martinit. Hoxhë Muglica solli nga Stambolli 5000 abetare të gjuhës shqipe, jo në trasta , por me karvanë kuajsh në thasët e sheqerit, dhe i strehoi ato te Shkëmbi i Patës e i shpërndau në Gollobordë, Çermenikë e gjithë Dibrën (9). "Patat dhe zoti i ruajnë abetaret e mia", u kishte deklaruar Hoxha bashkëfshatarëve (13). Shtëpinë shkolllë e bibliotekë me libra shqip të Hoxhë Muglicës e dogjën forcat ushtarake turke të Durgut Pashës në vitin 1908 së bashku me 15 shtëpi të tjera të Okshtunit. Patrioti Hoxhë Muglica mësohet se nuk u shqetësua fare për pronën dhe shtëpinë që humbi, por i erdhi shumë keq për bibliotekën dhe librat shqip që ju dogjën. Kjo mësohet nga një letër që ai i ka shkruar të birit, normalistit Osman Muglica, ku i shprehet: "... Ah medet se hasmi i kombit na e dogji bibliotekën shqipe tek shpia. Ah, ma mirë të më kishin djegun mue se sa librat shqyp. ...Na shujtën konakun, por jo bajrakun..."(5). Kjo letër ndodhet e plotë e botuar në librin e Elliott Hasan Muglicës, i cili ruan dhe origjinalin dhe i përket qershorit të vitit 1915.

Patrioti i madh Hasan Muglica luftoi gjithë jetën për mbrojtjen e territoreve shqiptare dhe zhvillimin e arsimit kombëtar shqiptar, luftoi dhe dha jetën për këto aspirata të larta. Ai përqafoi idenë e profetit: "Pa atdhe nuk ka fe" dhe punoi me moton "Një atdhe, një komb" dhe "Shqipëri e lirë". Mori pjesë në të gjithë evenimentet e rëndësishme historike të kohës, ku vendoseshin fatet e kombit, të territoreve dhe të gjuhës shqipe. Pasi e kishte mirëpritur dy ditë në Muglicë në qershor të vitit 1878, ishte së bashku me Abdyl Frashërin në Lidhjen e Prizrenit, më pas e përcolli atë përsëri nga Muglica në Martanesh dhe e shoqëroi me njerëzit e tij deri në Tiranë. Është për t'u theksuar se në të gjitha kuvendet e kohës Hoxhë Muglica mori pjesë përkrah Abdyl Frashërit dhe Iljaz Pashë Dibrës, Vebi Dibrës etj. Kjo falë arsimimit të tij dhe vetive burrërore si besa, bujaria, trimëria etj. (5,9). Mori pjesë në Kuvendin e posaçëm të Lidhjes Shqiptare në Dibër me 1 nëntor të vitit 1878, dhe Kuvendin e Dibrës të tetorit 1880. Që pjesëmarrës në Kongresin II të Manastirit në nëntor 1908, shkruante Haki Stërmilli (1). Ishte delegat në Kongresin e Dibrës në korrik të vitit 1909, ku u vendos hapja e shkollave shqipe dhe ndarja e shkollës nga kisha e xhamia. Mori pjesë më 1909 si delegat në Kongresin e Elbasanit, që u emërtua "Kongresi i shkollave shqipe", i cili hodhi themelet e arsimit kombëtar shqiptar, sanksionoi arsimin laik, bëri bashkimin e dialekteve e zgjodhi elbasanishten për gjuhën e shkruar shqipe dhe vendosi hapjen e shkollës normale të Elbasanit. Hoxha ju përkushtua energjikisht dërgimit të nxënësve në këtë shkollë dhe përgatitjes së mësuesve të gjuhës shqipe. Hoxhë Muglica, muderiz i Gollobordës, organizoi një takim të zgjeruar në fushën e Klenjës, i cili u quajt Kuvendi i Klenjës. Aty pati pjesëmarrje shumë të gjerë dhe ai u foli të pranishmëve për rëndësinë e shkollës e të gjuhës shqipe dhe mbrojtjes territoriale të vendit. Me entuziazëm të madh u vendos që të gjitha shtëpitë e mëdha të dërgonin djemtë e tyre në shkollën normale të Elbasanit dhe takimi u shpërnda nën bataret e armëve nga gëzimi që u krijua. Por siç vëren një nga biografët e Hoxhë Muglicës, nga presioni i ushtruar paria u tërhoq. (5,6,9). I paepur Hoxhë Muglica nuk u tërhoq, organizoi fshatin e tij. Ai dërgoi në atë shkollë 7 nxënës nga Okshtuni, tre nga shtëpia e tij (Hazizin, Qazimin dhe djalin e tij të vetëm, Osmanin), si dhe dy djemtë e Kurt Ballës nga Okshtuni i madh. Hoxha Muglica dërgoi në shkollë me shpenzimet e veta edhe djalin e Nun Bedinit e të Abdulla Likës (5) dhe djalin e një miku të tij nga Sebishti (9). Vetëm momenti që nga Okshtuni u siguruan 7 kandidatë për t'u dërguar në Shkollën Normale të Elbasanit (1909), e ben te padiskutueshem faktin se në Okshtun shkolla shqipe kishte kohë që ishte hapur dhe po jepte frutet e veta. I bën nder Okshtunit dhe gjithë Dibrës fakti i dokumentuar në botimet e kohës se midis 29 nxënësve që u regjistruan për herë të parë në Shkollën Normale të Elbasanit (1909), 7 prej tyre ishin nga zona e Okshtunit. Asnjë rreth tjetër veç Dibrës nuk e kishte arritur një kuotë të tillë. Kontributi i Okshtunit dhe i Hoxhë Muglicës ishte i pa diskutueshëm (1,4,5,9, 11, 12). Me 28 nëntor të vitit 1912, Hoxhë Muglica ngriti flamurin kuq e e zi në ballkonin e kullës së tij në Muglicë të Dibrës.

Kontributin e tij të madh për mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, Hoxhë Muglica do të paguante me jetën e tij.

cyan magenta yelloë black

arsim

Largimi i shumë banorëve të Okshtunit nga trojet e veta në zona të tjera për një jetë më të mirë, nuk duhet t'i largojë ata nga varret e të parëve, nga historia dhe lavdia e Okshtunit.



Nje grup arsimtaresh te Okshtunit ne vitin 1975

Ai u ekzekutua barbarisht nga shovinistë serbë të Ara e Shermetit me 15 qershor të vitit 1915 së bashku me bashkëpunëtorin e tij të ngushtë, Avdi Sallaku, dhe u groposën ende të gjallë në varrin që i kishin detyruar të hapnin vetë. Hoxhë Muglica jetoi dhe vdiq me dinjitet. Ai nuk pranoi të nënshkruante një dokument që ju kërkua, sipas të cilit rajoni nga Fusha e Kolgrekut e në perëndim në Kaptinë, në Vorvjak, Qafë Buall, Qafë Murrë e deri në Lurë të quheshin toka serbe.(6,9). "Nëse do të firmosej deklarata nga Hoxhë Muglica, serbët jo vetëm do ta lironin, por ai do të përfitonte shpërblime dhe ofiqe të majme", shkruante gazeta "Zani i naltë" në nr.11 të viti 1937 (11). Ai shkoi krejt i bindun drejt vdekjes, duke deklaruar: "Mos m'i lidhni sytë, dua të shoh tokat shqiptare nga Çermenika e deri në Korab" dhe "në ktë vend ku unë po bi, ka qenë asht e do të jetë Shqipni". Hoxhë Muglica nuk vdiq i ulur ne mutaf duke numruar tespiet, por vdiq në këmbë dhe u varros për së gjalli nga dora e hasmit, prandaj nuk mund te harrohet e as te anashkalohet.

Pishtari i dijes e arsimit që ndezi Hoxhë Muglica rreth 140 vjet më parë është i ndezur edhe sot. Nga familja Muglica kanë dalë mbi 15 arsimtarë në 5 breza të kësaj familje atdhetare e arsimdashëse. Por kësaj çështjeje mund t'i kthehem ndonjëherë tjetër.Përpjekjet për konsolidimin e shkollës shqipe në Okshtun nuk reshtën kurrë edhe pas Luftës së Parë Botërore. Ka pasur një rregullshmëri të admirueshme në funksionimin e shkollës në Okshtun pas Shpalljes së Pavarësisë, sidomos pas Kongresit të Lushnjes. Ishte koha kur për arsye të frekuentimit shkollat herë hapeshin e herë mbylleshin, sidomos ata që kishin më pak se 30 nxënës. Nga viti 1924 dhe deri në vitin 1934 mësues në Okshtun ishte i biri i Hasanit, normalisti Osman Muglica, i cili vdiq papritur me 5 qershor 1934. Më parë ai kishte shërbyer në Çermenikë, kryesisht në Zdrajsh, ku i ati dhe familja e tij ishin strehuar kur përndiqeshin nga serbët. Parimor siç ishte Hoxhë Muglica u pat dërguar djalin e tij atje si mësues në shenjë mirënjohjeje për shërbimet e tyre. Në vitin 1926 shkolla e Okshtunit kishte 4 klasë, ku mësonin 41 nxënës (4). Nga viti 1934 deri në vitin 1938 në Okshtun ka shërbyer si mësues Shaban Ostreni. Në të gjitha statistikat e kohës rezulton se numri i nxënësve është ruajtur konstant dhe ka pasur frekuentim normal. Në vitin shkollor 1937-1938 në shkollën e Okshtunit ishin të regjistruar 34 nxënës, midis të cilëve 5 femra, të cilat kaluan të gjitha pa mbetje. Në vitin shkollor 1939-1940 në Dibër funksionuan 40 shkolla, midis tyre dhe shkolla e Okshtunit me mësues Gafurr Rada. Mësuesi Okshtunas Tufik Balla, që kishte mbaruar Normalen e Elbasanit, filloi punë në vitin shkollor 1938-1939 në Muhurr. Emri i tij figuron edhe në listën prej 37 mësuesish që u dërguan në Dibër, në "zonat e lirueme" në vitin 1940. Më vonë ai u dërgua dhe në Dibër të Madhe e në nënprefekturën e Strugës, që do të hapnin kurse për mësimin e gjuhës shqipe për të gjitha moshat gjatë periudhës së verës.

Pas çlirimit të vendit në nëntor të vitit 1944, këshillat popullore që u krijuan, mbështetur nga etja e pashuar e banorëve për shkrim e këndim dhe për dituri, hapën kurse kundër analfabetizmit e shkolla në të gjitha fshatrat e Okshtunit dhe u përgatitën edhe mjaft mësues vendas, të aftë e kompetentë. Në vitin 1946 në fshatin Prodan populli ndërtoi me kontribut vullnetar shkollën e fshatit dhe vendosi aty mësuesin vendas Rexhep Tahir Koçi. Në vitin 1985 në Okshtun kishte 6 shkolla fillore, dy shkolla 8 vjeçare, një në Okshtun të madh dhe një në lagjet e sipërme me qendër në Shulla. Kishte dhe një shkollë të mesme me drejtor mësuesin e mirënjohur të matematikës, Mentor Muglicën, që ishte stërnipi i patriotit të madh Hasan Muglica, aty te Ara e Martinit ku e pat hapur me 1904 vetë ai, mësuesi i madh.

Okshtuni ishte çerdhe mësuesish. Kur unë bëja klasën e pestë në vitin 1957 në Ostren, pata fatin të kem mësues Idriz Bibën, Selami Muglicën (nipi I Hasan Muglicës), Muhamet Sulën, Arif Briçin nga Okshtuni dhe Jonuz Muçën nga Sebishti. Drejtori i shkollës ishte Idriz Biba, ndërsa mësuesi kujdestar ishte i mirënjohuri Halim Shehu, që kishte ardhur nga Sllova.

Okshtuni në optikën time pati disa kategori mësuesish. Një kategori mësuesish që unë po i konsideroj si 'Elitë", nuk punuan në Okshtun, por dhanë kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit në Dibër dhe më gjerë në shkallë vendi. Po sjell disa shembuj: I mirënjohuri Idriz Biba, të cilit i peshonte truri më shumë se trupi i imtë që kishte, ishte një normalist Okshtunas, mësues i shkëlqyer matematike, shok shkolle me Selim Alliun e Xhelil Kulejmanin, pat qenë drejtor shkolle, më pas shef i kabinetit pedagogjik të rrethit Dibër dhe punoi në vitet e fundit në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Adem Sallaku nga Okshtuni i Madh punoi si shef arsimi në Shkodër e më vonë në Ministrinë e Arsimit në Tiranë. Arif Briçi nga Muglica ishte inspektor në seksionin e arsimit të rrethit Dibër, u dërgua për studime të larta në Vietnam dhe shërbeu shumë kohë në Diplomaci. Riza Lika, një tjetër Okshtunas, pasi kreu studimet e larta për ekonomi në B.S., shërbeu si profesor në një nga shkollat e larta të kohës, derisa doli në pension. Kështu mund të dallojmë edhe mësuesin nga Okshtuni Esat Caka (vëllai i dëshmorit Sabri Caka), që punoi si mësues e drejtor shkolle në Peshkopi. Të tillë ishin edhe mësuesit Selami Muglica e Muhamet Sula, ndërsa stërnipi i Hoxhë Muglicës , Elliott Hasan Muglica kryen aktualisht me mjaft sukses mjeshtërinë e mësimdhënies në Kanada. Edhe pse ka edhe shumë shembuj të tjerë, besoj se është e mjaftë për të kuptuar se Okshtuni dha kontribut në zhvillimin e arsimit më gjerë se territori i vet.

Ne kujtimet e veta , mjeku i pare dibran i shkolles shqiptare, dr. Ahmet Alliu, ka deklatuar: ' Me vone kam vazhduar shkollen unike (keshtu e quanim athehere arsimin 7 vjeçar, me vone 8 vjeçar) ne Peshkopi ku rrinim ne konvikt. Kisha shoke nga krahina ime Selami Muglicen, Esat Caken , Adem Sollakun dhe Riza Liken (per kuriozitet te lexuesit keta jane te kater nga Okshtuni). Keshtu gjate viteve 1946, 47 dhe 48 e kryem me sukses shkollen unike ne Peshkopi" (14). Te gjithe keta u bene mesues te nderuar te fushes se vet.

Një kategori tjetër arsimtarësh në Okshtun do t'i konsideroja si "Veteranë " të arsimit vendas. Pati mësues që me kontributin e tyre ndikuan që në ndërtimin e pajisjen e shkollave dhe punuan për një kohë të gjate aty. Mësuesi Selman Koçi nga Prodani, edhe pse më parë kishte qenë nëpunës në lokalitete dhe në Qarkun e Peshkopisë, filloi mësuesinë në vitin 1951 në Borovë. Nga viti 1952 dhe deri kur doli në pension, ai punoi në shkollën e Prodanit, gjithmone me kater klase kolektive, ku përgatiti mjaft nxënës që më vonë u bënë kuadro të lartë e me reputacion në sektorët e tyre. Po paraqes vetem nje episod te mare nga libri i shkrimtarit Velo Cfarku "Mozaik episodesh e ngjarjesh , rrjedhes se Drinit te zi ". Ai kujton:..." Nje here ne nje mbledhje fshati ne Prodan, ne ate shkolle ngulur mes ahishteve shkon Sekretari i pare (ne vitin 1967) Sul Baholli. Ulet ne tavolinen afer rrjeshtit te pare te bankave . I pranishem edhe mesuesi Selman Koçi, per te cilin kishin respekt te merituar e gjithe zona e Golloberdes dhe Dibres . Duke ndjekur me vemendje diskutimin e bamnoreve, per nje moment Sekretari i pare nxjerr stilolapsin per te shkruar diçka ne ballorin e bankes qe shkelqenin si te lyera me llake. Per çudi brofi ne kembe mesues Selmani dhe pune sekondash i kapi doren e djathte duke ja shternguar si me dare. I drejtohet me nje lutje therese : -Aman mos shkruaj ne banke! Jane 30-40 vjeçare dhe asnje nxenes nder vite nuk kane lene qofte edhe nje shenj me te vogel. Duke pare kete skene , si ne teater, ngrihet Sekretari pare ne kembe duke i thene mesuesit: "Me fal, me fal Selman!" Kur i lexova keto radhe s' di perse mu kujtua diçka nga jeta e mesuesit Mirash Ivanaj, Minister arsimi i qeverise se mbretit Zog., aso kohe Drejtor ne gjimnazin e Tiranes. Mbreti kishte vendosur ta bente Minister dhe dergoi njerzit e tij ta therrisnin mesuesin ne takim. Ata vajten dhe e gjeten ate ne oren e mesimit. Kur i thane se e kerkonte mbreti , mesuesi qe pergjigjur : " I thoni mbretit une nuk mund te vij, une jam ne mesim , le te gjeje ndonje kohe tjeter dhe vazhdoi oren e mesimit". Kohet dhe vendet ndryshojne , por mesuesit dhe portretet e tyre ngjasojne.

Mësuesi Hysen Sallaku shërbeu për një kohë relativisht të gjatë në shkollën e Okshtunit të Madh, derisa doli në pension. I tillë ishte edhe mësuesi Bilal Salku, i cili bëri dhe nëpunësi të tjera, por që mësues punoi pa u lodhur në shkollën e Okshtunit të Vogël. Më pas ai u transferua në Tiranë, ku përfundoi studimet e larta dhe u bë një mësues e historian i mirënjohur në Tiranë e më gjerë. Figura të tilla të arsimit në Okshtun kanë qenë edhe Jashar Stoku, Hysni Imeri, Mersim Biba e mjaft të tjerë. Për rreth 30 vjet dha kontributin e tij në zhvillimin e arsimit në Okshtun , i paharruari Mentor Muglica, nipi i Osmanit dhe stërnipi i Hasan Muglicës. Nxënës e sportist shembullor, ai u bë promotor i zhvillimeve në Okshtun. Ishte mësues, kryetar i Këshillit të bashkuar, sekretar i byrosë dhe drejtor shkolle. Ai shkëlqeu si mësues matematike, por dhe si organizator, gjahtar e sportist i talentuar. Të gjitha përparimet e arsimit në Okshtun gjatë dekadave të fundit para vitit 1990, kanë mendimin dhe firmën e tij. Vitet e fundit ai u transferua e dha kontributin e tij në Tiranë. Mjerisht u nda nga jeta para kohe me 8 shkurt te vitit 2017. Punen ne arsim e vazhdon me dinjitet ne Tirane bashkeshortja e tij Lefteria dhe vajza e Mentorit Vilma Muglica qe perfaqeson brezin e peste pa shkeputje te arsimtareve nga familja e te pa harruarit Hasan Muglica.

Edhe mësuesi Hamdi Koçi, që shërbeu herë si mësues e herë si drejtor, ka kontributin e vet të pacenueshëm sidomos në Okshtun të Vogël. Për një kohë relativisht të gjatë shërbyen edhe mësuesit Idriz Koçi, Lefteri Muglica, Nafije Koçi etj. Në gjeneratën e më të rinjve, duke ju kërkuar falje se mund të kem harruar ndonjërin , bëjnë pjesë edhe Dashurie Gega në Oreshen, Jashar Koka në Plepe, Flutra Balla , Atlie Balla e Shqipe Balla, Besnik Ceni e pa dyshim mësuesi I talentuar Osman Sallaku etj.

Okshtuni pati dhe mjaft mësues të ardhur nga krahina e rrethe të tjerë. Kontributi i tyre nuk mund të mohohet kurrsesi. Para vitit 1952, pasi u largua për në Elbasan, mësuesi Rexhep Tahir Koci, në Prodan erdhën Xhemal Baxhaku nga Elbasani dhe Ramadan Duka nga Qafë Murra. Okshtunasit u janë mirënjohës mësuesve Naxhi Hasa, Muharrem Bardhi e Drita Bardhi, Shemsi Ceka, Lutfi Cami, Zihni Methasani, Fais Gjeleshi, Tahir Veliu, Selim Meziu, Shazimir Koci, Bari Sejdini etj. Gjenerata të tëra ish nxënësish i përmendin me respekt të veçantë Naxhi Hasen, Shemsi Cekën, Zihni Methasanin, Ramazan Pikun e mjaft të tjerë, për punën aq me pasion që zhvilluan në Okshtun për arsimimin e brezave. Një nga ish nxënëset e shkollës së Okshtunit, që më vonë u shkollua, u bë mësuese, që punoi mbi 7 vjet në Okshtun dhe më vonë si e tillë derisa doli në pension në rrethin e Lushnjës, tregon se kur në klasën tonë me më pak se 30 nxënës erdhi një ekip i seksionit të arsimit të rrethit Dibër, klasa mori 17 nota 10 në lëndën e matematikës ku jepte mësim me pasion mësuesi Ramazan Ilnica.

Kohët e fundit shfletova një material voluminoz mbi problemet e arsimit në Dibër. Më duhet ta komplimentoj autorin për punën e madhe që ka bërë dhe përpjekjet për të sjellë sa më shumë material mbi këtë problem. Megjithëse autori i këtij punimi është një miku im i kahershëm, po veproj sipas parimit: "Mik e kam Sokratin, por më mik kam të vërtetën". Meqenëse si metaforë autori ka përdorur termin "...në hulli të historisë…", më duhet t'i them se hullinë bujku i mirë dibran e ka nxjerrë gjithmonë deri në qosh të arës. Ai është dalluar pikërisht për atë që i ka punuar po aq mirë cepat e arës së tij, ashtu siç edhe mesin e saj dhe të gjithë cepat njësoj. Bëra përpjekje që të gjej disa nga faktet që kam paraqitur më sipër lidhur me historikun e arsimit në Okshtun, por hasa vetëm në disa të dhëna jo krejtësisht të plota. Duhet t'i kujtoj lexuesit edhe faktin që bëhet fjalë për një zonë jo vetëm arsimdashëse, por edhe në kontakt fizik e gjeografik me treva të tjera si Elbasani, Tirana, Kruja, Mati. Kjo ka pas ndikimin e vet jo vetëm në zhvillimin e arsimit, por edhe në gjuhën e folur që ka theks përafrues me atë të Shqipërisë së Mesme, përndryshe nga zonat fqinje. Boll të përmendim faktin se fshati me jugor i Okshtunit, Prodani, është i baraslarguar nga Elbasani po aq sa nga Dibra e Madhe, ndërsa Tiranën këmbësorët e dikurshëm e kanë bërë edhe brenda një dite vajtje e ardhje.

Është e nevojshme, gjithashtu, të përmendim faktin se Okshtuni ka pasur një muze për arsimin, besoj i vetmi në rrethin e Dibrës, të vendosur pikërisht aty në fshatin Muglicë, ku lindi, jetoi, punoi dhe ra atdhetari i madh Hasan Muglica. Ndër figurat e shquara të arsimit dibran këtë personalitet të madh të arsimit kombëtar nuk e gjeta në materialin e sipërcituar. Muzeu i arsimit në Muglicë nuk është më. Një stuhi jo natyrore që kaloi atyre anëve e fshiu atë dhe shumë dokumente të afishuara aty që kam pasur rastin t'i shoh me vëmendje disa herë. Por historia është aty. Shkëmbi i patës, Livadhet e Muglicës, Miligjanja, Kodra e Xhengut, Ara e Shermetit ku ra hoxhë Muglica aty janë. Shoku i Abdyl Frasherit, Iljaz Pashë Dibrës, Vebi Agollit, Ndre Mjedës e Luigj Gurakuqit, bashkëstudiues me Nikollë Kaçorin e Gjergj Fishtën e shumë të tjerë, Hasan Muglica është aty. Ndoshta edhe stërkalat e gjakut që u shpërndanë nga trupi i tij pas batares së armëve të armiqve të gjuhës shqipe e të trojeve shqiptare janë aty përmbi gurët e murrmë te Ara e Shermetit.

Si një intelektual dhe djalë i një mësuesi veteran, por dhe si njeri që punova rreth 25 vjet në arsim, u formova e vlerësova edhe në fushën e arsimit me tituj e ndere, nuk mund të mos them një të vërtetë të qartë e të pamohueshme se jo vetëm historiku i arsimit dibran, por as historiku i arsimit kombëtar shqiptar nuk mund të bëhen pa i dhënë vendin e vet Hoxhë Muglicës dhe Okshtunit malor, por arsimdashës. Për të gjitha kontributet e tij Hoxhë Muglica është shpallur në vitin 2000 "Dibrani i shekullit", duke konkurruar pikërisht me figurat e shquara të epokës së vet (9).

Një histori e ngjashme me atë të Hoxhë Muglicës për një patriot tjetër ka shërbyer si subjekt për filmin e mirënjohur "Udha e shkronjave". Me jetë e pagoi edhe patrioti okshtunas dashurinë për gjuhën shqipe, për shkronjat dhe trojet shqiptare. Duhet të jemi objektivë në trajtimin e figurave të tilla madhore të historise sonë kombëtare. Asnjë harresë nuk mund ta zbresë atë nga piedestali i lavdisë dhe historisë së arsimit kombetar ku jeta dhe vepra e tij e lartësoi dhe e vuri për të mbetur përjetësisht aty. Pse jo, edhe për patriotin dibran të mos ketë filma e botime të tjera, veç atyre që tashmë njihen. Për të mund të shkruhet si strateg ushtarak, si diplomat, si inxhinier që la vepra, si klerik i zoti, por jo fanatik, si udhëheqës i administratës shtetërore që edhe në kushtet e tij dinte ta vinte në shërbim të njerëzve, si figurë popullore që siguronte unitetin e njerëzve, dinte t'i printe e t'i çonte me një fjalë goje në luftë dhe plot gjëra të tjera. Largimi i shumë banorëve të Okshtunit nga trojet e veta në zona të tjera për një jetë më të mirë, nuk duhet t'i largojë ata nga varret e të parëve, nga historia dhe lavdia e Okshtunit. Posaçërisht për ata dhe për të rinjtë po i shkruaj këto radhë.

BURIME:
1. Haki Stërmilli: "Dibra në pragun e historisë". 1940; 53,54 etj.
2. "Shtigjet e lirisë". Tiranë, 1967
2. Kristo Frashëri: "Historia e Dibrës", Tiranë 2012
3. Adem Bunguri: "Prehitoria e Dibrës", Tiranë 2010
4. Xhemal Domi: "Dibra në hulli të historisë". Tiranë 2012
5. Elliott-Hasan Moglica: "Burri i madh Hasan Moglica", Tiranë 2012
6. Bilal Salku: "Historiku i Okshtunit, Dibër", 1987 (Dorëshkrim)
7. Zabit Lleshi: "Jashar Zeneli (Bllaca)", Tiranë 2015
8. Selman Koci: Historiku i fshatit Prodan, (Muzeu i rrethit) Dibër, 1969
9. Valbona Ramçi: "Hoxhë Hasan Moglica, klerik dhe luftëtar i shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe". Tiranë 2012.
10. Sotir Andoni: "Në gjurmët e inkursionit", Tiranë 1970
11. Revista "Zani I Naltë"; 1937. nr.11.,f. 340
12. Gazeta "Tomorri", datë 24 mars 1910
13. Selman Koci: Kujtime të ish nxënësit të Hoxhë Muglicës, Hajdar Stojku (marrë në vitin 1972).
14. Dr. Ahmet Alliu mjeku i pare i Dibres , gazeta "Rruga e Arberit" nr.3, 2018
15. Velo Cfarku: " Mozaik episodesh e ngjarjesh , rrjedhes se drinit te zi" Tirane 2018, f.173.

Në veprat letrare, në biografitë e njerëzve të shquar gjejmë mjaft detaje. Kur ato përdoren me vend, e rrisin vlerën artistike të veprës.



Detaji artistik

Nga **XHAFER MARTINI**

Detaji në gjuhën shqipe ka kuptimin «hollësi», në sferën e ligjërimit të përditshëm. Në përdorime të tjera kjo fjalë mund të marrë edhe kuptime të ndryshme. Ne do ta përdorim në sferën e letërsisë artistike ose dokumentare kur për një ngjarje, personazh ose protagonist jetësor jepen detaje artistike, që rritin shkallën e emocioneve. Në veprat letrare, në biografitë e njerëzve të shquar gjejmë mjaft detaje. Kur ato përdoren me vend, e rrisin vlerën artistike të veprës. Kur përdoren pa vend dhe pa masë, shkaktojnë një efekt të kundërt. Për ta kuptuar lexuesi ç'është detaji, po japim një shembull nga monografia «Napoleoni», shkruan nga Emil Ludvig. Napoleoni tashmë jeton ditët e fundit në ishullin e Shën Elenës. Las Kazin, një nga shoqëruesit e tij, jep një rast të tillë:

«*Kur arritëm në një fushë, që po e punonin, perandori zbriti nga kali, hoqi plugun nga dora e fshatarit. Për një kohë të gjatë, me shpejtësi të pabesueshme, hapi brazda të përkryera. Nuk tha asnjë fjalë, vetëm mbasi mbaroi, më urdhëroi t'i jepja fshatarit një napolon.*» *Kur e pyetën perandorin se a kanë ndonjë ambicie tjetër ata njerëz apo veç të punojnë tokën, ai u përgjigj se ka shumë Napoleonë që punojnë tokën. Atyre nuk u është dhënë rasti të bëhen perandorë.* 1)

Po kështu një detaj interesant jep R. Roland në librin «Jeta e Tolstoit», për shkrimtarin e madh rus. Tolstoi kishte ide të çuditshme, një pjesë e të cilave ishin utopi. Ai provoi për të jetuar si muzhikët për t'u afruar shpirtërisht me ta dhe për më zhdukur diferencën ekonomike. Për këtë ai kap parmendën të lërojë tokën. Humb shumë kohë me kështu budallallëqesh në një kohë kur Zoti e kishte falur për tjetër gj. Një nga ata punëtorët që shtypte në shtypshkronjë librat e tij të mrekullueshëm, i thotë: «*Mjeshtër i madh, nuk është ajo vegla juaj...Vegla juaj është pena, fusha juaj-shpirti njerëzor, i cili ka nevojë dhe ai të shërohet dhe të ushqehet.*» 2)

Një detaj tjetër me plot domethënie për Abraham Linkolnin është edhe ai kur një grua e thjeshtë takohet me presidentin dhe tërë frikë dhe shqetësim i thotë: «ata», domethënë kundërshtarët politikë, nuk do të rrinin pa të vrarë» dhe Linkolni i përgjigjet: «Epo, më vranë, më vranë, Hana...njeriu një herë lind e një herë vdes..

Plutarku tek «Jetë paralele», me anë të një detaji tregon se trimëria buron edhe nga përçmimi i jetës: «...*në ushtrinë e Antigonit ndodhej një luftëtar trim, por i dobët nga trupi dhe shëndetlig. Kur mbreti e pyeti përse ishte aq i zbehtë, ai iu përgjigj se vuante nga një sëmundje e fshehtë. Mbreti u dha urdhër mjekëve, që, po të kishin mundësi shërimi, të mos linin mjet pa përdorur. Mirëpo trimi, si u shërua, nuk kuturisej më nëpër rreziqe e as nuk hidhej në mes të përleshjeve. Kur Antigoni e thirri dhe i shprehu habinë për këtë ndryshim, luftëtari u përgjigj pa e fshehur të vërtetën:»Ombret, ti vetë ma hoqe guximin duke më shpëtuar nga ato të liga, që më bënin ta përçmoja jetën*...» 3)

Autori Coulter me anë të një detaji të fuqishëm dëshmon se ka raste kur autori i veprës ndjen njësoj si personazhi që ka krijuar; ai hyn kaq shumë në «lëkurën» e personazhit sa identifikohet me të: «*Floberi ishte njeri i jashtëzakonshëm; natën, kur shkroi skenën e vetëvrasjes së zonjës Bovari, ai e kishte ndjerë me të vërtetë shijen e strikninës në gojë, ai volli shumë dhe, kur pena e tij shkroi fjalët e fundit, e mbuluan djersë të ftohta dhe me dhembje të tilla, u desh që të thërrisnin një doktor*.» 4)

Karl Sendberg në biografinë për presidentin e Amerikës, Abraham Linkoln, u ka dhënë një vend të gjerë përdorimit të detajeve për karakterizimin e kësaj figure interesante të politikës së një shteti të madh. Ai vë në gojën e tij një detaj ironik për të kuptuarit e Lirisë: «*Të gjithë çirremi për liri, por tek shqiptojmë këtë fjalë, gjithkush e kupton sipas mënyrës së vet. Kuptohet qartë se delet dhe ujku nuk mund të jenë në një mendje për përcaktimin e nocionit të lirisë*.» Një detaj tjetër me plot domethënie për Abraham Linkolnin është edhe ai kur një grua e thjeshtë takohet me presidentin dhe tërë frikë dhe shqetësim i thotë: «ata», domethënë kundërshtarët politikë, nuk do të rrinin pa të vrarë» dhe Linkolni i përgjigjet: «*Epo, më vranë, më vranë, Hana...njeriu një herë lind e një herë vdes...*» 5)

De Goli ka qenë presidenti i parë i Francës pas luftës. Dihet kontributi i tij i madh jo thjesht për të shpëtuar Francën, por për të shpëtuar nderin e Francës. Por ai qëndroi gjatë në detyrë dhe filloi ta kompromentojë demokracinë dhe autoritetin e tij. Por në detajin që jepet më poshtë, tregohet se thelbi i këtij njeriu të shquar ishte shpirti demokratik, pavarësisht nga ndonjë shfaqje despotizmi: «*De Gol refuzoi të nënshkruante një urdhër arresti për Sartrin, i cili në mënyrë demonstrative e provokuese kishte dhunuar një dekret të qeverisë që ndalonte shpërndarjen e një gazete të vogël maoiste, ...ai haptazi theksonte një sentencë mjaft cinike se «gjeniu» është figurë qendrore e jetës politike të kombit*.» 6) Detajet japin hijeshi dhe bukuri, ngjallin ndjenja të fuqishme vetëm kur përdoren me vend. Ata duhet të bëhen pjesë organike e gjithë strukturës së veprës, ndryshe duken si një rrobë e bardhë qepur me pe të zi.

Ka libra që janë ngritur pothuaj të gjithë mbi detajin. Një shembull i drejtpërdrejtë është romani *I Huaji* i Kamysë. Kjo duket një pjesën e dytë të tij, që ka të bëjë me kalvarin e hetimit dhe të gjyqit. Ata nuk duan ta dënojnë për krimin, -vrasjen e zezakut- që nuk e përmend askush. Ata kanë si qëllim ta cilësojnë Mersonë si kriminel të lindur,si njeri pa shpirt. Kamy jep një varg detajesh që hedhin dritë pikërisht mbi këtë qëllimshmëri të trupit gjykues. Merso,personazhi kryesor i romanit, është një djalë që e ka dërguar nënën plakë në azil jo vetëm që nuk mund ta mbante, por më kryesorja qëndronte në faktin se «*Për më tepër, shtova unë, ajo i kishte mbaruar muhabetet me mua dhe mërzitej fare vetëm*.» Kur mori vesh lajmin e vdekjes së nënës, u nis për në azil me bezdi të madhe. Vapa e tmerrshme, rruga e largët dhe me shumë kthesa, prania e një trashaluqi që e kishte afër gjatë udhëtimit, djersë e pluhur, e bezdisën pa masë gjatë gjithë udhëtimit. Kur mbërriti në azil, personeli e pyet nëse ai do që të hapë arkivolin për ta shikuar nënën për herë të fundit. Nuk dua ta shikoj, thotë ai dhe personeli habitet. Ai fle pranë arkivolit të nënës, nuk bën rojë siç bënin pleqtë azilantë. Pi kafe dhe cigare. Pret që ajo të varroset sa më parë dhe të marrë rrugën e kthimit. Kur e pyesin për moshën e nënës, thotë që «nuk e di.» Kjo e habit edhe më shumë personelin e azilit. Sapo bëhet varrimi, kthehet në shtëpi. Takohet me të dashurën me të cilën sheh një film humoristik, bëjnë dashuri. Përveç një copë shiriti prej bezeje të zezë që ka vënë si shenjë në jakën e xhaketës,asgjë tjetër nuk flet për zi. Kamy është mjeshtër për dhënien e detajeve. Procedohet kaq natyrshëm,sa lexuesi nuk vëren ndonjë qëllimshmëri të posaçme. Kur bëhet gjyqi,»paudhësitë» që ka bërë, ia kanë mbledhur pikë-pikë, siç mblidhet uji i shiut kur kullojnë strehët. Ato janë bazë për akuzën, jo vrasja e zezakut. Përfundimi që duan të nxjerrin është se ai njeri nuk është një vrasës i rastësishëm, por një «kriminel i lindur.»

Këtë mënyrë ndjek edhe Cvajgu për të dhënë portretin e Balzakut tek monografia me të njëjtin titull. Por, ndryshe nga Kamyja, Cvajgu nuk i mbledh dhe nuk i organizon detajet, ai i le ato rrugës si të ishin gurë kilometrikë që tregojnë drejtimin që duhej ndjekur. Balzaku i ri ndryshon shumë nga Balzaku i pjekur. Kjo është një ndarje e çuditshme e moshës së tij në dy pjesë të barabarta. Gjatë gjithë monografisë së tij Cvajgu këtë rreh ta tregojë nëpërmjet detajeve të ndryshme. Po e fillojmë me detajin e parë :

«*Gjer në moshën tridhjetëvjeçare ai, si artist, nuk guxon t'i vërë vetes detyrën që ia kërkon talenti,dhe në jetën private si burrë, u rri larg grave. Sado e çuditshme të duket, por Balzaku i rrëmbyer e i papërmbajtur në vitet e pjekurisë, në të ritë ka qenë i druajtur, thuajse tej mase*.» 7) Cvajgu më poshtë e vë Balzakun të tregojë shkakun e kësaj tërheqjeje ndaj jetës:

«*Unë isha,pa dyshim,shumë naiv në një shoqëri kaq artificiale, ku njerëzit rrojnë për sytë e botës e shprehin mendimet me fraza të stisura ose me fjalë që i dikton moda. Kështu që nuk dija si të flisja...*» 8)Një detaj tjetër me rëndësi është ai që shënon kthesën në jetën e Balzakut, që tashmë është zgjuar nga gjumi letrargjik. Këtë e bëri dashuria. Por Balzaku në çdo gjë ka qenë i veçantë, edhe në dashuri. Djaloshi tridhjetëvjeçar dashuroi zonjën Laura dë Berini, grua 45 vjeçe, nënë e nëntë fëmijëve. Po pikërisht Balzakut i kishte munguar dhembshuria prej nëne, prandaj «*instinkti i fshehtë, që, si një engjëll e shoqëron gjithnjë gjeniun në rrugën e jetës, i tregon Balzakut se forca e tij e brendshme ka nevojë për udhëheqje, për drejtim, për një dorë të dashur dhe të arsyeshme, që mund ta çlirojë, t'ia shkrifërojë tendosjen, të zbutë e të lëmojë tek ai gjithçka të vrazhdë, pa ia lënduar ndjenjat*.»9)

Balzaku nuk do të kishte qenë ky që është sot sikur të mos e kishte përndjekur

Kemi detaje-ngjarje, kemi detaje episode, detaje shprehje, detaje citime. Ta fillojmë nga fundi: Përdorimi thënieve të njerëzve të shquar është diçka që i shtohet veprës tënde, pra, nga ana funksionale është një detaj, pa të cilin vepra edhe bën, por me detaj plotësohet më mirë, bëhet më e argumentuar dhe merr më shumë frymëmarrje. Por, nëse për të argumentuar mendimin tënd, kërkohet një mbështetje nga një mendimtar i madh, kjo duhet bërë tamam në vendin e duhur, në çastin e duhur dhe me mjeshtrinë e duhur...

fati. Fati atë e kishte paracaktuar për ta ngritur në lartësinë e gjenialitetit, prandaj, sa herë Balzaku nisej një rruge të lehtë, për ta gëzuar jetën dhe për të jetuar me moskokëçarje, Fati i dilte në rrugë ia priste shetitoren e sheshtë dhe e çonte buzë greminave dhe rrëpirave, atje ku ishte më vështirë, sepse ai e dinte fuqinë titanike të këtij njeriu që mund të mposhtte gjithçka. Pikërisht një gjë të tillë ngre Cvajgu si më kryesoren për Balzakun: përndjekjen e fatit. Dhe këtë Cvajgu e jep përmes këtij detaji që merr një vlerë të madhe përgjithësuese sepse pasohet dhe plotësohet me shumë detaje të tjera të kësaj natyre:

Fati «*nuk pranon që Balzaku të kënaqet para kohe me gjëra të vogla, sepse kërkon prej tij gjëra të mëdha. Ai s'e lë mendimtarin e shtetit të shkrijë forcat e të banalizojë talentin në kolltukun ministror. Ai ia pret Balzakut afarist për të fituar me anë të spekulimit pasurinë e dëshiruar. Ai ia heq nga rruga të gjitha vejushat e pasura që ia do aq shumë zemra. Ai ia kthen pasionin për gazetari në një neveri të tmerrshme. Ai ia ndez urrejtjen për çdo zhgrapsje të kot gazete, e të gjitha i bën vetëm e vetëm që ta gozhdojë në tryezën e shkrimit. Dhe këtu gjenia e tij mund të pushtojë jo vetëm sferat e kufizuara të Dhomës së Deputetëve apo të bursës, jo vetëm botëzën e ngushtë të shkapërdarëve elegantë, por të pushtojë mbarë botën*.»10)

Dhe kjo ka ndodhur se Fati nuk ka dashur vetëm Balzakun, por edhe Francën. «*Në Francë forca morale e kombit shfaqet me një qartësi të veçantë në dy tipa: në tipin e hollë, delikat, aristokrat të Rishëliesë, të Volterit, të Valerisë, dhe në tjetrin ku merr shprehjen e vet forca dhe shëndeti i popullit, në tipin e Miraboit dhe të Dantonit.*

Balzaku bën pjesë tërësisht në këtë klasë të rëndomtë të masave të gjëra dhe aspak në aristokratët, në natyrat e çoroditura. Lidhini një përparëse dhe vëreni tek banaku i një pijetoreje në Jug të Francës dhe Balzakun shpirtmirë dhe gazmor nuk mund ta dallosh nga ndonjë mejhanexhi analfabet që i gostit klientët me verë dhe bën muhabet.» 11) Sa herë Balzaku është përpjekur të dalë prej qyrkut të njeriut të thjeshtë, sa herë ka dashur ta ndërrojë lëkurën dhe të bëhet elegant, aq herë ka dështuar dhe jo vetëm ka dështuar, por është bërë qesharak, lolo oborri. Shikoni me ç'detaj i jep Cvajgu kundërshtitë që e kanë pasë kapërthyer Balzakun:

«*Sa gjenial është Balzaku krijues, aq i patalentuar është në rolin e luanit mondan. Një paradoks i çuditshëm: që të ngrihet në këtë sferë, ai do të përkulet tërë jetën; që të rrojë mes luksit, do të gozhdohet në galerën e punës së përhershme; që të duket elegant, duhet të bëhet qesharak dhe pa kuptuar ai vërteton atë ligjin që e ka parashtruar njëqind herë, sipas të cilit njeriu që është mjeshtër në sferën e vet, duket kokëtrashë kur përpiqet të futet në një sferë të huaj për të.*» *12) «Sa herë që Balzaku del nga caqet e sferës së vet, gjenia*

dhe intelekti i tij i kthjellët nuk punon mirë. Ante në truallin e vet, ai me t'u futur në zonat e huaja, bëhet loli i xhuxhëve.» 13) Mund të jepnim shembuj të tjerë pa mbarim, por edhe me kaq besojmë se del i qartë roli i madh i detajit në paraqitjen e esencës së personazhit ose të protagonistit jetësor. Për Balzakun janë shkruar shumë libra, monografi e studime, të natyrave të ndryshme, por monografia e Cvajgut fiton një peshë të madhe dhe zë një vend të veçantë pikërisht pse nëpërmjet këtyre detajeve ai jep esencën e Balzakut, tregon kush ka qenë në të vërtetë Balzaku dhe ku qëndron gjenialiteti i tij.

Kemi detaje-ngjarje, natyrisht ngjarje shumë të shkurta, kemi detaje episode, detaje shprehje, detaje citime. Ta fillojmë nga fundi: Përdorimi thënieve të njerëzve të shquar është diçka që i shtohet veprës tënde, pra,nga ana funksionale është një detaj, pa të cilin vepra edhe bën, por me detaj plotësohet më mirë, bëhet më e argumentuar dhe merr më shumë frymëmarrje. Por, nëse për të argumentuar mendimin tënd, kërkohet një mbështetje nga një mendimtar i madh, pra, përmendja e një fraze, nganjëherë edhe të një pasazhi, kjo duhet bërë tamam në vendin e duhur, në çastin e duhur dhe me mjeshtrinë e duhur. Nuk ka gjë më të pështirë se sa *citatomania* kur këtë *miell* të marrë hua nuk din ta përdorësh. Kështu, si shembull, nëse do të studiojmë raportin e krijimtarisë letrare ose çfarëdo krijimtarie tjetër me autorin e saj, me kuptimin se cilës duhet t'i japim përparsi, veprës apo biografisë së autorit, citojmë thënien e Arbën Xhaferit që thotë: «*Në fushën e estetikës kur ka antagonizëm ndërmjet krijimtarisë dhe biografisë, sugjerohet që të lexohen veprat e autorit. Vetëm ato janë indikatorë të vepërs*.» 14)

Një lloj i veçantë detaji është i ashtuquajtururi detaji krahasues. Kjo është forma më e lartë e përdorimit të detajit dhe është karakteristikë për shkencën. Edhe në këtë lloj detaji Cvajgu paraqitet mjeshtër dhe pikërisht me përdorimin mjeshtëror të detajeve bën të njohur thelbin e gjithçkaje. Në librin «Tre mjeshtër: Balzak, Dikens, Dostojevski», Cvajgu na njeh me detaje interesante që në fakt na bën të dallojmë këto tre personalitete të shquara krijuese në esencën e tyre. Libri është fund e krye krahasues, por po japm vetëm pak nga këto detaje:

Sipas tij Balzaku është: «*Metereologu i rrymave shoqërore, matematikani i vullnetit, kimisti i pasionit,gjeologu i formave kombëtare primitive; qenia e një shkencëtari enciklopedik aq sa të depërtonte në trupin e kohës së tij dhe ta hetonte atë me të gjitha mjetet, e, në të njëjtën kohë, ishte një koleksionist i të gjitha fenomeneve, një ushtar i çdo ideje, kjo formonte krenarinë e Blazakut, e, si rrjedhim, prandaj qe i palodhur në regjistrimin e gjërave sa madhore aq edhe të vockla*.»15) Kjo që thotë Cvajgu është shumë e saktë: Balzaku jep kaq shumë hollësi, është kaq skrupuloz në paraqitjet e jetës, hyn kaq thellë në zhbirimin e karaktereve sa, kur ta mbarosh së lexuari një vepër të tij, natyrisht, një nga më të mirat, si shembull, romanin «Fshatarët», të lodh me kuptimin që të ngop dhe për mjaft kohë nuk do të kapësh libër tjetër me dorë. Balzaku përshkruan me hollësi rrugë, sheshe, kanale të nëndheshme, bilme, oda, kthina, oborre,shkallë,kalime të fshehta etj. Ti si lexues, nëse je i pajisur me atë durim që e kërkojnë gjenitë, më vonë e shikon se asgjë nuk ka qenë e panevojshme se në të gjitha ato mjedise që Balzaku ka përshkruar, tani veprojnë personazhet e tij të shumtë; ai, si të thuash, i ka bërë ata me shtëpi, njërin që të banojë në pallat, tjetrin në një izbë të ndyrë,sipas karakterit dhe fushëbetejës të secilit prej tyre me jetën.

Kurse Dikensi,në përdallim nga Balzaku, është moralisti i Anglisë së kohës së tij,është pedagogu dhe edukatori, shkrimtari që mban përgjegjësi për edukimin moral të njerëzve, ai kujdeset për çdo fjalë që shkruan që ajo të mos tingëlloi banale dhe të të vrasë veshin. Për Dikensin Cvajgu jep këto detaje:

«*Dikensi censuron ndiesitë në vend që t'i lërë të veprojnë lirisht; nuk i lejon ato siç bën Balzaku që të vërshojnë me fuqi të natyrshme, por me anë digash dhe hendekësh, i çon në kanale ku vihet në lëvizje mulliri i moralit anglez*.» 16) «*Kur vdiq Dikensi, ipeshkvi i Uinchester-it, duke lavdëruar veprën e tij, pat thënë që ajo mund t\i lihet në dorë qetësisht çdo fëmije ...për t'u bërë hero tek Dikensi duhet të jesh arkë virtytesh, një puritan ideal*...» 17)

Vërtet kjo është esenca e Dikensit. Personazhet e tij mbahen mend për butësinë dhe bukurinë e shpirtit:kujtoni Mikoberin, Anjezën, Dorën,Davidin...Të gjithë të paharruar, të praruar dhe të modeluar nga pena e matur dhe perfekte e Dikensit.

Kurse Dostovjeski është në antipod me të gjithësh shkrimtarët e tjerë. Cvajgu e krahason së pari me bashkëkombësin e tij të madh, Tolstoin. Të dy të mëdhenj, por krejt të ndryshëm!

«*Tolstoi ngrihet i shqetësuar nga puna e tij, ndalet, lë artin dhe torturohet gjithë jetën në përpjekje për të dalluar të mirën nga e keqja, për të shqyrtuar nëse jeton me drejtësi apo gabimisht; prandaj jeta e Tolstoit është didaktike, një libër shkolle, një pamflet, kurse ajo e Dostojevskit është një vepër arti, një tragjedi, një fat*.» 18) Nuk ka si thuhet më bukur. Dhjetëra dhe qindra faqe mund të shkruheshin për gjigantin e madh rus, por kaq bukur dhe kaq saktë sa e ka karakterizuar Cvajgu zor se mund të bëhej nga dikush tjetër. Kjo është forca e detajit kur përdoret me mjeshtëri.

Për Dostojevskin «...*njerëzit janë heronj dhe kanë vlerë artistike për sa kohë janë natyrë problematike: ata të përsosurit, të pjekurit, i shkund nga vetja si pema frutat e saj*.» «*Dostojevski i do njerëzit vetëm sa kohë vuajnë, sa kohë ata kanë formë gjallëruese dhe të çarë në dysh, sa kohë ata janë në kaos, i cili dëshiron të shndërrohet në fat*.» *19) «Heronjtë e Dostojevskit ...nuk kërkojnë as gjejnë ndonjë lidhje me jetën e vërtetë; kjo ishte veçoria e tyre. Ata nuk duan të hyjnë në realitet, duan ta kapërcejnë atë që në fillim në kërkim të pafundësisë. Fati për ta nuk ka kuptim të jashtëm, por vetëm të brendshëm. Mbretëria e tyre nuk është e kësaj bote. Gjithë format e dukshme të vlerave: titull, pushtet, para, gjithë pasuritë për ta nuk kanë vlerë...*» *20) «Komoditetet tona, rrugët e rrahura, të mbrojtura me parmakë moralë dhe udhërrëfime etike për ata janë të panjohura: gjithmonë dhe kudo ata shkojnë përmes shkurrnajës më të pakufishme, në pambarim*.» *21) «Njerëzit e Dostojevskit ...janë njerëz të një fillimi të ri. Ata,me gjithë gjenialitetin dhe mendjet e tyre të ndritshme, kanë zemër fëmijënore: ata nuk duan këtë apo atë gjë, por duan gjithçka*.» 22)

Dhe në fund, për ta mbyllë me një hollësi tragjike, Cvajgu duke nëpërmendur heronjtë e Dostojevskit, thotë:

«*Për njeriun nuk ka ankth më torturues sesa përpjekja për të gjetur një gjë para të cilës të përkulesh*.»

---

1. *Emil Ludvig: "Napoleoni", Tiranë 1999, f. 456*
2. *Roland: "Jeta e Tolstoit", Tiranë 2001, f. 91*
3. *Plutarku: "Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë", Tiranë 1980, f. 123*
4. *Stephen Coulter: "Jeta pasionante e Mopasanit", Tiranë 2004, f. 37*
5. *Karl Sendberg: "Abraham Linkoln", "Apollonia",Tiranë 1993, f. 161*
6. *Tomash, Agnesh: "Filozofia dhe tranzicioni", "Arbëria", pa vit botimi, f. 21*
7. *Stefan Cvajgu: "Sh.B. "8 nëntori", Tiranë 1989, f. 65*
8. *Aty, f. 68, 9. Aty, f. 72, 10. Aty, f. 122, 11. Aty, f. 130,*
12. *Aty, f. 151, 13. Aty, f. 282*
14. *Enver Robelli: "Arbën Xhaferi rrëfen në Tetovë, në kërkim të kuptimit", "Koha", Prishtinë 2011, f. 83*
15. *Stefan Cvajg: "Tre mjeshtër: Balzaku, Dikensi, Dostojevski", Tiranë 2006, f. 38*
16. *Aty,f. 63, 17. Aty, f. 102,18. Aty, f. 106, 19. Aty, f. 108*
20. *Aty, f. 110, 21. Aty, f. 112, 22. Aty, f.167*

Ç'kemi asaj Dibre

Nga BUJAR KAROSHI

Këtë muaj po e nisim nga fundi: Jemi të mërzitur shumë që kryeministri na refuzoi titullin Qytetar Nderi. Por ne do t'ia "fusim" prapë: Do t'i bëjmë një bust e do t'ia vendosim te Tuneli i Murrizit, një në Qafë të Buallit dhe një te Ura e Drinit... Që, sa herë të kalojmë, ta kujtojmë e ta urojmë që na bëri Rrugën e Arbrit. Ndërsa në qytet do t'i bëjmë një shtatore e t'ia vendosim në krah të Skënderbeut, aty ku e meriton...

Pastaj do të ngrihen ndjekësit e Saliut dhe ata do të bëjnë nga një bust edhe më të madh, dhe në fund ndjekësit e Nanos, edhe ata me nga një bust... Kështu do ta bëjmë rrugën histori e buste, se për ta bërë rrugën - rrugë do shumë rrugë për t'u bërë...

Për arsimin folëm shumë muajin që shkoi. Ka plasur debati me heronj e heroina ta bëjmë gjimnazin 1 apo 2. Dhe debatin që ta bëjmë gjimnazin 1 e në qytet nuk e bën kush. Sepse hallin e kanë t'ia kafshojnë një godinë për ta kthyer në zyra qeverie...

Në Bulqizë plasën sërish betejat. Ato për prerjen e pyjeve i fituan banorët muaj më parë, por për këtë për ujin vështirësi po dalin. E kanë kuptuar bizneset afër qeverisë se për t'i marrë edhe pyjet duhen larguar banorët, e për të larguar banorët u duhet marrë uji... Si ajo "kuçedra" në përrallat që u tregojmë fëmijëve në mbrëmje... Dhe për të luftuar kuçedrën, po kërkohet një trim... Dhe trima në fshat po bëhen gratë dhe pleqtë...

Një viktimë tjetër u regjistrua në minierat e Bulqizës. Një minator ndërroi jetë dhe një tjetër u plagos. Media shkroi se shkak u bë shpërthimi i gazit, ndërsa prokuroria pritet të nxjerrë fajtor viktimën, ashtu siç ka bërë edhe në të kaluarën...

Po vazhdon ëndrra për t'u bërë i pasur. Ca kërkojnë të marrin ujin, ca të tjerë të presin pyjet... Ca të tjerë të gërmojnë për florinj në vende historike... Pas ca vitesh do të mbetemi pa asgjë: as ujë, as pyje, as histori...

Në Dibër të Madhe i mbaruam zgjedhjet. Qyteti votoi njërin doktor, fshati votoi doktorin tjetër... Por, sidoqoftë, një doktor është përsëri kryetar komune... Tani pritet veç ta shërojë Dibrën. Si doktorët këndej kufirit...

Një grup qytetarësh bënë një ekspeditë në Rrugën e Arbrit. Panë ç'po bëhej dhe u mbushën me shpresë... Por që të shkatërrohet mjedisi, pyjet, tokat e lumenjtë, nuk i sheh kush...

A e mbani mend para ca ditësh për problemin e ujit të llixhave? Duket se çështja u mbyll. Por që ka rënë numri i pushuesve dhe që shërbimet ndaj tyre janë minimaliste, nuk merret kush... Sepse është pasuri e jona e është më mirë të prishet e të shkatërrohet sesa ta marrë dikush e ta kthejë në një atraksion turistik...

BOTIM I RI

"Kronike e jeteve te humbura" nga dr. Orhan Sakiqi

Ditët e fundit, doli në qarkullim nga shtëpia Botuese *M&B*, botimi më i ri, me titull:"**Kronikë e Jetëve të Humbura**", me autor Dr. Ing. **Orhan Akil Sakiqi.**

Libri përmban ngjarje të jetuara nga jeta e autorit Sakiqi, pjesë e kujtimeve të jetuara ndër vite, që nga fëmijëria e deri më sot. Autori, ngjatjet më të spikatura, së bashku me gëzimet dhe hidhërimet e jetës, të gërshetuara edhe me hapësirat kohore, i ka sintetizuar në këtë botim.

Renditja e tregimeve është bërë nga autori jo duke ndjekur kronologjikisht rrjedhën e viteve, por duke i dhënë hapësirë më të gjërë, personazheve të njohura e të panjohur nga ai.Në fund të librit janë renditur disa artikuj të shkruar në kohë të ndryshme në shtypin e kohës, për të cilat z. Orhan Sakiqi i ka vendosur në libër pasi mendon se e ruajnë aktualitetin e tyre edhe sot.

Libri fillon me hyrjen nga autori dhe me parathënie nga studiuesi e shkrimtari i njohur Sulejman Mato. Libri i dedikohet në hyrje me një fotografi të veçantë prindërve të autorit, me prejardhje nga Dibra e Madhe. Botimi i librit "***Kronikë e Jetëve të Humbura***", u mundësua nga dy djemtë e autorit Eglin dhe Erald Sakiqi.

Dr. Ing. Orhan Sakiqi, është anëtar i "Këshilli të të Urtëve" në Shoqatën "Bashkësia Dibrane" në Tiranë e një personalitet i respektuar i komunitetit dibran në Tiranë. Ka botuar mjaft artikuj problemor mbi urbanistikën dhe inxhinierinë civile urbane, në shtypin e përditëshëm dhe periodik, si dhe librat: "Gjurmët e Shallvares"-2009, "Homazhe e Mesazhe"-2011, "Infrastruktura e Tiranës"-2014, "Profile Kolegësh"-2017. Për të gjithë kontibutin e tij disa vjeçar, është vlerësuar me titullin "Mirënjohja e Tiranës" dhe është dekoruar në vitin 2017 nga Presidenti i Republikës me titullin "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut".



Librin mund ta gjeni duke kontaktuar me autorin, pranë zyrave të Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë ose pranë librarisë së botimeve M&B, rrjetit të librarive Adrion ose libraria Art's te stacioni i trenit në Tiranë.

Me rastin e 90-vjetorit të lindjes dhe 10-vjetorit të vdekjes

Sali Jakup Hoxha – njeriu i kontributeve dhe sakrificave

***Nga* SEFER DUKA**



Krahina e Matit, përveç veçorive dalluese fiziko-gjeografike, përbën dhe veçorinë dalluese të familjes së madhe patriarkale me shumë frymë. E tillë familje ka qenë dhe ajo e Jakup Hoxhës në fshatin Gërman në rrethin e Matit, me mbi 40 frymë. Në gjirin e kësaj famije bën pjesë edhe Saliu, i cili ishte djali i parafundit i Jakupit (Pas Hamitit, Mehmetit, Isufit, vetë Saliu dhe i fundmi, Xhemali) si dhe i tri motrave (Zela, Fatimja dhe Lutfija), gjithsej 8 fëmijë që përbënin këtë familje të madhe.

Saliu u lind më 3 maj 1929, në një familje me të shkuar e të tashme atdhetare e patriotike, një familje punëtore e bujare. Qysh fare i vogël, Saliu, shquhej për zgjuarsi e shkathtësi midis shokëve të tij. Edhe pse pak imcak, në lojrat popullore të kohës vazhdimisht dilte fitimtar. Vëllai i madh i tij, Hamiti, duke qenë se kishin mbetur jetim nga babai si fëmija më i madh, iu desh qysh fare i ri të kryente detyrën e kryefamiljarit të familjes së tij. Gjatë LANÇ, ai u lidh ngushtë me Lëvizjen dhe me LANÇ, duke qenë edhe kryetari i këshillit antifashist nacionalçlirimtar për fshatin, dhe shtëpinë e tij e pati kthyer në një bazë të rëndësishme të kësaj lufte, për të cilin kontribut ka fituar dhe statusin e veteranit të kësaj lufte. Edhe dajat e tij, Mehmet e Dërvish Molla, nga fshati Gërman, kanë qenë partizan të LANÇ. Edhe vëllezërit e tjerë, sipas mundësisë qenë të lidhur me LANÇ, por në veçanti, Saliu, qe ndër vëllezërit që u radhit në radhët partizane, efektiv i batalionit partizan "Mati", i cili luftoi në të gjitha luftrat që ky formacion luftarak kreu kundër pushtuesit nazifashist gjerman.

Vetëm në krahinën e Matit ka qenë pjesmarrës në 13 beteja, ku së bashku me efektivin e batalionit ka dalë fitimtar mbi armikun. Më pas luftoi për çlirimin e Tiranës, Vorës, Krujës, Milotit, Lezhës dhe të Shkodres, në përbërje të Brigadës 23 sulmuese. Për veprimtarinë dhe kontributin e tij luftarak, në dobi të LANÇ, është dekoruar me medaljen e "Trimërisë" dhe atë të "Çlirimit" akorduar nga ish-Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Pas çlirimit të vendit erdhi pranë familjes, ku për pak kohë u mor me punët e bujqësisë e të blegtorisë. Ka qenë pjesmarrës në aksionet kombëtare të rinisë për ndërtimin e veprave social-ekonomike të vendit. Më vonë u bë pjesë efektive dhe aktive në policinë e shtetit, ku ka punuar si punonjës policie në Ulëz e Shkopet në kohën kur ndërtoheshin dy hidrocentralet, respektivisht ai i Ulëz dhe i Shkopetit, si dhe në Rezervat e shtetit në rrethin e Matit. Më pas, me kërkesën e tij për arsye familjare lirohet nga policia dhe punon në ndërmatrrjen e grumbullim-përpunimit në Burrel, në detyrën e përgjegjësit.

Saliu ishte dhe një familjar e prind shembullor. Me krijimin e familjes së tij të re, me bashkëshorten Mihane, bijë e familjes së Ramkurtajve në Midhë, familje dhe kjo e dëgjuar për atdhetarizëm e patriotizëm, lindën, rritën dhe edukuan gjashtë fëmijë, djemtë Arifi, Jakupi, Kadriu, Skënderi, Agimi dhe vajza Nuria, të gjithë sot janë familjar dhe me kontribute të rëndësishme e respekt të veçantë në komunitetet e punës e të banimit të tyre.

Gjatë gjithë punës e veprimtarisë së tij, Sali Hoxha, ka qenë korrekt, i disiplinuar, i përkushtuar dhe i sjellshëm, kurajoz, si dhe një aktivist shoqëror me vlerë. Edhe pas daljes në pension, pavarësisht se humbi shikimin e tij, qe dhe mbeti një aktivist i dalluar dhe tepër human. Të gjendej në çdo kohë pranë, si në gëzime ashtu dhe në hidhërime. Si një njeri inteligjent me humor, të jepte kurajo dhe të relaksonte me ato shakatë e tij të kripura bukur. Gjatë aderimit në organizatën e veteranëve të LANÇ, deri në momentin që iu nda jetës, ka kontribuar në luftën për mbrojtjen e vlerave dhe idealeve të larta të LANÇ. Si veteran i abonuar rregullisht në gazetën "Kushtrim brezash", e lexonte atë mendihmën e të tjerëve me dëshirë e pasion dhe e përdorte me efektivitet të lartë në punën propagandistike me antarësinë e organizatës dhe jo vetëm, sidomos me të rinjtë e fshatit. Por në moshën 80-vjeçare, dhjetë vite më parë, më 3 shkurt 2009, Sali Hoxha iu nda gjirit të familjes, miqve dhe shokëve të tij të dashur, duke lënë mbrapa një kontribut dhe emër të mirë, që në vazhdimësi kujtohet, por që edhe në të ardhmen nuk do të harrohet, sepse puna, veprimtaria dhe kontributi i tij kanë qenë me shumë rëndësi, që na bëjnë ta kemi këtë figurë të kompletuar, gjithnjë pranë në gjirin e shoqërisë tonë. Kur neve po ndërtojmë demokracinë e vërtetë, që edhe ai e deshi dhe dha kontribute me vlerë, na bie detyra që figura të tilla si Sali Hoxha, jo vetëm t'i vlerësojmë serozisht e me dashuri të veçantë, por dhe t'i promovojmë për t'i respektuar dhe për të mësuar prej tyre.

Kur **populli të ngre këngë**, veprat dhe emri nuk shuhen kurrë

Kushtuar 105-vjetorit të lindjes dhe 80-vjetorit të rënies së dëshmorit, SHAHIN TOÇI

Nëse ndodhesh në fshatin Urxallë, të Njësisë Administrative Macukull, Bashkia Mat dhe kërkon të njohësh figurë të historisë si atdhetar e patriot, menjëherë bashkëbiseduesi vendas të prezanton emrin e Shahin Toçit. Kjo situatë të ndodh edhe në fshatin tradicional, Macukull, ku dikur fshati Urxallë administrativisht ka qenë lagje e tij. Sigurisht, lista e atdhetarëve dhe e patriotëve të dëgjuar në këto fshatra është e gjatë, por ajo "shkurtohet" në një ku në memorien popullore ekziston emri i Shahin Toçit.

Shahin Toçi u lind më 15 prill 1914, në një familje me tradita atdhetare, patriotike e luftarake, një familje punëtore e bujare, por dhe arsimdashëse. Qysh fare i vogël, Shahini shquhej midis shokësh për zgjuarsi e shkathtësi. Si fëmija i parë i familjes Toçi, nën kujdesin e prindërve, Osmani dhe Merjemja, mori dhe tërë kujdesin e veçantë të shkollimit dhe arsimimit. Për të, 15 shtatori i vitit 1925, qe ditë e veçantë, sepse e gjeti Shahinin në bankat e shkollës së Derjanit, i cili nën kujdesin e mësuesit Rrapush Stringa nga Elbasani, ai do të bëhej njëri nga nxënësit më të dalluar ndër shokë për përparim në mësime dhe për sjellje shembullore në shkollë e jashtë saj. Përveç bankës së shkollës, i pëlqenin dhe i frekuentonte shpesh dhe odat matjane, në formatin e një institucioni popullor tradicional, që shërbenin dhe ato si një shkollë e madhe formimi dhe edukimi. Etja për të vijuar mësimet më tej, falë dhe rezultateve shumë të mira, i mundësuan këtij djaloshi të ndiqte mësimet në shkollën mbretërore ushtarake në Tiranë, për katër vjet, midis viteve 1930 – 1934, mësime të cilat i përfundoi po me rezultate shumë të mira. Rezultatet e tij të shkëlqyera në mësime i hapën rrugën për më tej, më lart, por tashmë jashtë vendit, në Itali. Iu akordua e drejta me bursë e studimit në Kolegjin Ushtarak të Napolit. Në tetor të vitit 1934 nisi kursin "Bianchini" midis 120 studentëve të tjerë, midis të cilëve katër ishin bashkëkombas shqiptar. Kjo shkollë ishte me sistem tre vjeçar, të cilën e përfundoi në korrik të vitit 1937, po me rezultate shumë të mira, duke qenë në listën e ekselencës. Këto rezultate i shërbyen, që sapo erdhi në Shqipëri, të rikthehej përsëri në Itali, këtë herë në Akademinë Ushtarake të Modenës, në specialitetin e Kombësorisë e Kavalerisë, në kursin "Audercia" dhe "Impero" të cilin e përfundoi në maj të viti 1938. Për afro pesë javë, pasi u kthye në Shqipëri, punoi si oficer kariere NË Ministrinë e Mbrojtjes, në një zyrë të rëndësishme dhe përsëri dërgohet për specializim në kursin pasuniversitar që përgatiste kuadro ushtarakë për nivelet e larta të shtabeve të Shtamadhorisë.

Pushtimi i Shqipërisë nga fashizmi Italian në 7 prill 1939, Shahinin e zuri atje në Itali. Ky pushtim e zemëroi dhe e indinjoi shumë.



Ngritja e një Muzeu në fshatin Urxallë në banesën e tij është pak për Shahin Toçin. Këtë e thotë edhe bashkëmoshatari dhe bashkëstudenti ushtarak i Shahin Toçit, Mark Arapi nga Mirdita, i cili në formën e një mesazhi thotë: "Atë që ka bërë Shahin Toçi për Matin dhe Shqipërinë, të tjerët nuk e kanë bërë për Shahini".

Edhe pse ishte larg vendit të tij, mendja dhe zemra e tij rrinte se si do të kontribonte për të shporrur këtë pushtues barbar nga vendi i tij, Shqipëria. Qarqet qeveritare italiane për të ndryshuar imazhin e keq të këtij pushtimi, mendoi dhe organizoi ceremoni festive me studentët shqiptar, për të servirur pushtimin e Shqipërisë si një vullnet i vetë popullti shqiptar dhe këtë e tregon edhe ceremonia me studentët që u betuan për flamurin Italian. Përgatitjet zgjatën rreth një muaj e gjysëm, ku çdo ditë kuadratet me student zhvillonin stërvitje ceremoniale.

Në ditën finale do të asistonte dhe ndihmës sekretari i shtetit i Luftës së Mbretërisë Italiane, gjeneral Alberto Periani. Më 13 maj 1939 do të zhvillohej prova gjenerale e ceremonisë, ku ndër studentët shqiptar do të ishte edhe Shahin Toçi, por jo me uniformën ushtarake fashiste. Ai ishte veshur me uniformën kombëtare të oficerit shqiptar. Ky fakt, paraqitja e këtij oficeri me uniformën shqiptare, i tërhoqi vëmendjen gjeneralit, i cili e thirri: "Ç'është kjo uniformë? Tashmë mbreti i juaj ka rënë". Oficeri Shahin Toçi iu paraqit ushtarakisht dhe i shpjegoi gjeneralit: "Zoti Gjeneral! Gaboheni, mbretërit bien, por Atdheu mbetet po ai. Ne jemi shqiptar dhe me uniformën tonë të ushtarakut mund të betohemi vetëm para flamurit tonë kuq e zi". Pas këtij shpjegimi me zë të lartë dhe kumbues, të gjithë shokët e Shahin Toçit njëzëri thirrën: "Të lumtë Shahin". Nga ky moment, prova e ceremonisë u shthur dhe dështoi. Shikimi i egër e kërcënues i gjeneralit ndaj Shahin Toçit nuk e ndryshoi situatën, betimi i studentëve për mbretin dhe flamurin italian dështoi. Por shërbeu si një paralajmërim për oficerin shqiptar, eleminimin fizik të tij, si protagonist kryesor në këtë dështim të madh. Shahin Toçi, në qëndrimet e tij si atdhetar iu referohej edhe figurave të mëdha historike botërore, ku njëri prej tyre ishte Ciceroni i cili thotë: "Njeriu nuk lind për vete, por për Atdheun e tij", citat ky i gjetur në ditarin e xhepit të tij të shkruar me shkronja kapitale.

Policia sekrete italiane (SIM-i) e evidentoi oficerin shqiptar Shahin Toçi, i cili për disa ditë u përndoq deri sa më 27 maj 1939 u vra në gjumë në dhomën e tij, me pesë plumba pas shpine. Për disa ditë ky akt makabër u mbajt sekret. As studentët shqiptarnuk u lejuan të marrin informacion dhe të jenë pjesë e ceremonisë së varrimit të tij. Lajmi u përhap më vonë edhe nga agjensitë e huaja të lajmeve, si Radio Londra, Praga, Varshava, Parisi etj, dhe ky akt u vlerësua prej tyre si një vrasje politike nga qeveria dhe policia italiane, si një shenjë hakmarrje, por dhe për terror ndaj të gjithë atyre studentëve shqiptar që mund të ndërmerrnin akte të tilla në të ardhmen.

Populli matjan dhe më gjerë, ai mbarë shqiptar, trimit Shahin Toçit i thuri vargje dhe këngë që e përjetësuan atë përgjithmonë. Vargjet "e vranë me marifet/ mbas shpine në gjumë tuj fjet" apo "kjo Shqipëri ka rritur burra/ që nuk njohi dy flamura" etj, tregojnë dhe evokojnë rolin fuqishëm aktin dhe trimërinë e këtij burri atdhetar, patriot dhe luftëtar i lirisë.

Ngritja e një Muzeu në fshatin Urxallë në banesën e tij është pak për Shahin Toçin. Këtë e thotë edhe bashkëmoshatari dhe bashkëstudenti ushtarak i Shahin Toçit, Mark Arapi nga Mirdita, i cili në formën e një mesazhi thotë: "Atë që ka bërë Shahin Toçi për Matin dhe Shqipërinë, të tjerët nuk e kanë bërë për Shahini". Në këtë 105-vjetor të lindjes dhe në 80-vjetorin e rënies, i madh e i vogël, përulemi përpara Shahin Toçit, duke treguar së është i pavdekshëm, jeton midis nesh përgjithmonë.

Lavdi aktit dhe veprës heroike të dëshmorit të LANÇ, Shahin Toçi! Mati dhe matjanët kanë në mendje dhe në zemër, të kanë në çdo shtëpi, sepse ti dhe jetën për liri. Busti i Shahin Toçit vendosur në qytetin e Burrelit është nder që iu bëhet banorëve të komunitetit, për sot dhe për të ardhmen e tyre.

SEFER DUKA
RENATO TOTRAKU

histori

Albert Kotini: Ali Maliqi në historinë e Dibrës dhe Shqipërisë
Botimet BOTART / 272 faqe, me fotografi.
ISBN: 978-9928-219-87-9
Çmimi: 1000 lekë
E GJENI NË ÇDO LIBRARI

Kontributi i Ali Maliqit në Luftën Antifashiste

Nga **ALBERT KOTINI**

(Vijon nga numri i kaluar)

NDARJA IDEOLOGJIKE ME HAXHI LLESHIN

Aty nga fundi i janarit 1942 më vjen një natë një grup prej 10 vetash nga Martaneshi, ndërsa Baba Faja ishte te shtëpia poshtë. Duke zbritur në stanet, vjen edhe Haxhi Lleshi. Rreziku nga italianët shtohej nga lëvizjet e tyre lart e poshtë, se mos përplaseshin. Fati e deshi që deri në atë moment nuk pati luftë. Italianët ruheshin po ashtu nga ndonjë përplasje pa dashje me armë. Kështu, ai grup prej 10 vetash, në fund të janarit 1942 u vu nën urdhrat e Ramadan Çitakut, Zoi Themelit, Pajo Islamit, Sotir Vullkanit, Qazim Prishtinës për të qenë në krahun e komunistëve serbë kundër italianëve në territorin e Dibrës. Si rezultat, Dali dhe Esat Ndreu, Nazmi Rushiti etj., vinin për t'u takuar me palët e mësipërme, kur edhe ata që ishin të implikuar si vrasës ordinerë dhe që përbënin organizimin e parë antifashist të PKSh-së në Dibër. Për një bashkëpunim me këto grupe erdhi edhe Baba Faja me 4-5 veta nga Martaneshi, pastaj këta shoqërues mbetën si ndërlidhës, ndërsa Baba Faja u largua në zonën e vet.

Siç e theksova disa herë, u bë organizimi në dy grupe, në Sllovë (Pajo Islami, Sotir Vullkani) te Dali Ndreu dhe tjetri (Zoi Themeli dhe Qazim Prishtina) te familja e Ali Maliqit. Këtu qëndronte edhe më shpesh Haxhi Lleshi. Siç e shihni, në farefisin dhe miqësinë tonë Ramadan Çitaku lëvizte sa në Dibër, Martanesh pastaj në Tiranë. Këtu për herë të parë dëgjoja se ç'ishte komunizmi, çfarë lufte do të bënim. Fillova aty nga klasa e pestë fillore të ndjek edhe unë mësimet e komunizmit, duke u pjekur në moshën 12-vjeçare me këtë propagandë marramendëse. Atë lloj teorie nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë e më pëlqente tema e barazisë etj. Grupi i parë më energjik ishte nga oficerë të çmobilizuar, si Esat Ndreu, Mehdi Ndreu, Bedri Spahiu dhe Dali Ndreu, të cilët flisnin dhe organizonin vrasje. Kur mendoj tani për ato që flisnin atëherë, se do ta bëjmë Shqipërinë ashtu e kështu, teori të pazbatueshme si filozofi, por që kënaqnin tërë diskutantët për ato që ëndërronin, të gjithë të mësipërmit dihet se ku i përfunduan ato ëndrra. Kur erdhi faza tjetër, ajo e lëvizjes antifashiste masive, sipas përvojës së Revolucionit të Tetorit, me të arratisurit e kthyer nga Jugosllavia apo të çmobilizuarit nga ushtria e të tjerë të mbledhur në atë zonë me kokrra për vrasje, filluan luftën ndaj italianëve. Të parët ishin ata që u larguan nga batalioni "Tomori" gjatë Luftës Italo-Greke, si Shaban Strazimiri, Ahmet Jegeni etj., që ikën nga izolimi në Shijak dhe u strehuan në Kërçisht, si dezertorë për italianët. Midis tyre erdhi edhe Prokop Murra, duke u bërë kështu 50-60 veta në shtëpinë time. Më 22 korrik 1942 në shtëpinë tonë u krijua çeta e parë e Dibrës me komandant Haxhi Lleshi, komisar Qazim Prishtina e zëvendëskomisar Zoi Themeli. E theksoj këtë fakt tani, në përfundim të jetës sime, se nga celulat e para me 2-3 veta e deri në këto aksionet e çetës së parë më 22-24 korrik 1942, kur u prenë shtyllat elektrike, edhe shtëpia jonë, përfshi mua 12-vjeçar, u aktivizuam totalisht kundër armikut të përbashkët. Atëherë të dyja motrat e Sul Baholli, Qefsere dhe Sadoshe Baholli, u strehuan me nënën dhe gratë e familjes sime. Ndërsa nëna ime, me Shyrete Turkeshin kishte të bënte dhe të gjitha i trajtonte si vajza shtëpie, e jo si partizane. Shyretja më vonë u martua me Eqrem Çabjen. Një natë, më 24-25 korrik 1942, u bë alarm për prerjen e shtyllave telefonike në



Maqellarë – Dibër e Madhe. E ndieja veten të organizuar; më thoshin se je anëtar i çetës e, për të ma bërë qejfin, më quanin komandant baze. Për moshën, mburresha me kënaqësi e më dukej vetja se po bëja diçka. U nisa me pushkën në dorë, të gjithë me nga një sëpatë dhe drejt e te shtëpia që dinim. Haxhi Lleshi m'u drejtua:

- Ku shkon?

- A jemi partizanë,- pyeta unë.

- Jemi. Po ti,- më tha,- je për në bazë, jo atje.

- Po mirë,- i thashë,- ju merrni femrat, e jo mua për në aksion. Po unë?

Ma mbushën mendjen që me 3-4 shokë të mbroja bazën se mos vinin italianët. Pas 3-4 orësh u prenë shtyllat. E çfarë ishte? Një aksion i marrë. Në gusht 1942 më thotë një mik se Azis Kaloshit i vdiq nëna, i cili me këtë shkak mori 15 ditë leje nga internimi në Ventotene, e nuk u kthye më. Këtë metodë e shfrytëzuan për babanë, kur më vdiq gjyshja. Erdhi Ferik Maliqi. Mirëpo, theksoj se kur vinin në ato anë italianët, nuk i ngacmonim. Edhe ata po ashtu. Secili në postet e veta. Ky qëndrim asnjanës deri në dhjetor 1942, sa u kalua në ilegalitet dhe u organizuan disa grupime. Grupi i Myftar Kaloshit, grupi i Sllovës me Esat Ndreun, grupi i Haxhi Lleshit në Kërçisht, i Ferik Maliqit në Kërçisht. Të gjitha forcat, së bashku fillimisht përbënin deri në 2000 vetë. Të gjithë bënin kujdes të mos dilnin në skenë, për sa kohë Ali Maliqi mbahej në kështjellën Korpo - Darencia të Italisë. Ishte kjo gjendje e nderë, kur qarkkomandant ishte major Verdi, ndërsa prefekt ishte Vehip Runa. Ky i fundit ndërhyri: "Pse të vriteni? Sa armë doni me leje?". Për të arritur në marrëveshje u vu kusht lirimi i Ali Maliqit nga internimi në Itali. Myftari, Feriku e Haxhi Lleshi i thanë:

- Ne bëjmë paqe, po të lirohet Ali Maliqi.

Palët ranë dakord. Armët, italianët i donin t'i kishim me leje. Ishte janar 1943 kur e sollën babanë, sipas marrëveshjes, me dy oficerë italianë, duke e dorëzuar me shkrim në familje. Ky moment për mua do ngelet i gjallë deri në fund të jetës sime, sepse aludoja që kishte ndonjë ndryshim pas internimit në të gjitha bisedat me grupet komuniste të Dibrës. Në veçanti, debati me Zoi Themelin, kur i tha babai:

- Dëgjo ti, Zoi, mua s'më vjen keq për ty,- dhe nisi t'ia numëronte tërë pasojat e Revolucionit të Tetorit në Rusi. Pastaj, duke përmendur emrat e Haxhi Lleshit, Daliut e Ahmet Jegenit, mjaft dibranëve u tha:

- Këtyre do t'ua hajë kokën, në veçanti këtyre intelektualëve ish-oficerë, ose do të bëhen baltë e komunistëve. Por edhe ju proletarëve do t'ju vijë radha, kur s'do i hyni më në punë.

Këto e të tjerat, që i kam shkruar në "Bllokun e zi", më dalin tani përpara si një bilanc për jetën time, se sa të drejtë paska pasur babai im. Koha e vërtetoi edhe për mjaft biseda të tjera, të cilat gjatë diktaturës, po t'i ballafaqoje me të vërtetën, të përlanin për agjitacion e propagandë e drejt e në burg. Madje, për herë të parë dëgjova në ato vite të luftës, nëpër këto debate për bolshevizmin, se edhe Fane Kapllani, atentatorja e vetë Leninit, ishte vajza e vet ilegale. Edhe tani pyes se ku i dinte babai im këto fjalë që janë akoma herezi për komunistët.

Këtu është momenti i parë i ndasisë së Aliut nga grupi i Haxhi Lleshit. Çështje tjetër e ndasisë midis tyre dhe babait tim, që unë e analizoj aktualisht nga debati midis tyre, ka të bëjë kryesisht në qëndrimin pro dhe kundër serbëve titistë. Dibra e dibranët e njihnin mirë serbin, prandaj Aliu u tha: "Në qoftë se ju do të bashkoheni me serbët, do shkoj e shkëputem për të gjetur shtresën time. Në asnjë mënyrë bashkë me serbët". Pastaj ky debat politik i ndau, prandaj Aliu krijoi grupin e vet atdhetar. Pra, ndarja ideologjike e Dibrës i çoi të dyja palët të ngrihen kundra traditave shekullore të farefisit në miqësi e në një qëndrim ndaj okupatorit dhe të lidhej "besa e internacionalizmit në njërën anë e tjetra e nacionalizmit". Mirëpo masa e popullit përtypte më tepër propagandën e re të bolshevizmit që e bënte të ardhmen si një sistem ku do të plotësoheshin tërë dëshirat e tyre. Ndërsa propaganda nacionaliste këtij populli i kujtonte të kaluarën, ku mangësitë e sistemit feudal ndikuan shumë në dyshimin ndaj parisë së tyre.

Me sa më kujtohet,- vijon më tej Avniu,- aty nga fillimi i korrikut arritëm të nxjerrim, nëpërmjet miqve, një akt vdekjeje për gjyshen (nënën e Aliut) dhe së bashku me një lutje – kërkesë ia përcollëm Ministrisë së Drejtësisë të njoftonte të bijtë se nëna u kishte vdekur. Kështu iu mundësua Ferikut, aty nga fillimi i gushtit 1942, të vinte 15 ditë me leje, me kusht paraqitjeje çdo ditë në karabinierinë e Maqellarës. Arrestimi i Ferikut ishte trondítës për ne, jo vetëm si i burgosur, por nga nevoja e familjes në shtëpi për të qenë një burrë në drejtim të ekonomisë. Kjo, sepse edhe gjyshe Hajrija ishte në moshë të thyer, një grua me shumë përvojë; e përplasur në jetë me shumë dallgë e vështirësi, përsëri e tregoi veten zonjë fisnike për të qenë në krye të familjes pa u trembur nga mungesa e burrave. Ajo diti t'i bënte ballë asaj situate, por shqetësimi për bijtë e saj, meraku i fatit të tyre e hante çdo ditë. Edhe pse i vogël, mbaj mend se gjyshja tregonte se tri herë kishte parë shtëpitë e djegura nga serbët, pa llogaritur ndjekjet e reprezaljet e shumta, porse në moshën që kishte, shqetësimi për të bijtë në tokë të huaj e brente çdo ditë. Italianët, përveç arrestimeve, na vendosën edhe një tabelë ku shkruhej: "Familje armiku, askush nuk duhet ta vizitojë". Gjyshja më kujtonte se isha zot i gjithë kësaj pasurie, prandaj të hapja sytë se mund ta shpërdoronin. Kështu, me dashje apo pa dashje, tek unë filloi të lindte përpjekja për mbijetesë. Gjyshja vinte nga derë e madhe e në zë për Dibrën; ishte bija e Llan Kaloshit dhe e rritur në dallgët e jetës. Po ashtu, edhe aty ku kishte ardhur e ishte ndeshur me ato furtuna. Burri i saj, Maliqi, pas vdekjes së shpejtë kishte lënë jo vetëm atë, por edhe fëmijën e parë, Aliun 13 vjeç. Kjo fatkeqësi tek ajo kishte formuar një karakter të pathyeshëm dhe burrëror. Në këtë periudhë e në këto kushte që u krijuan për ne, gjyshja ngjalli tek unë një formim të parakohshëm, ndoshta siç kishte bërë edhe me bijtë e vet. Më ka quajtur zot shtëpie, ku do të bëja jo vetëm mikpritje, por edhe vizita dhe rite të tjera familjare për dasmë apo fatkeqësi. Duke përfaqësuar respektin e familjes, si i pari i saj, u poqa që në moshë të vogël.

DITARI I ISUF LUZAJT: SI I NJOHA VËLLEZËRIT AGOLLI NË VENTOTENE

... Në Cortonë gjeta edhe tre të internuar shqiptarë: Ali e Ferik Agolli nga Dibra dhe Ali Klisurën, siç e shkruante ai vetë emrin e tij. Ali Agolli, një burrë shumë i zgjuar e fisnik në shpirt; Ferik Agolli, një djalë shumë besnik; Ali Klisura, një shqiptar i mirë, orator shumë i mirë, burrë energjik e trim, me një kulturë relative me kohën e me jetën e movimentuar të tij, në mes të politikës e imigracionit.

Aliu e Feriku jetonin në të njëjtin pension ku jetoja unë, ishin në katin e sipërm, në një dhomë të vogël, për arsye se kishin një radio klandestine për të dëgjuar lajmet e luftës drejt e nga Londra, për pesë a gjashtë orë në ditë rresht.

Ali Klisura jetonte në Udhën e Jezuitëve. Ishte me gruan e me vajzën e vogël, Bubushin. Kur i lexova Ali Klisurës procesverbalin e Partisë Socialdemokrate, të themeluar në Ventotene, refuzoi të merrte pjesë, "megjithëse jam,- tha,- me mish e me shpirt qind për qind me programin e saj shumë të mirë".

Më pohoi se bënte pjesë në një organizatë nacionaliste të formuar prej Koculit, në të cilën bëjnë pjesë edhe shumë personalitete të tjera, që sot janë fashistë me emër, por që në shpirt janë me ne,- më tha. Përmendi Mehdinë e Mit'hatin, Çobën – plakun, dom Ndre Nikajn, Lef Nosin, Isuf Agallinë nga Kosova e shumë të tjerë. Më pyeti, nëse unë isha në korrent a në kontakt me këtë organizatë, që do të quhej Fronti Nacional i Lirisë, e unë i thashë të drejtën. Përballë një sinqeriteti të thellë, është vështirë që njerëzit të jenë shumë misteriozë. Atëherë, më puthi me lot në sy.

***

Jetën time të përditshme në Cortona e rregullova kështu: Që prej orës 7 deri më 12 të drekës – mësime private, latinisht, frengjisht, inglisht, arithmetikë, fizikë, kimi, studentëve të gjimnazit. 5 orë të përditshme.

Prej orës 12 deri më 13 pushim. Prej 13 deri më 14 drekë në restorant; 14 deri në 16 pushim. 16 deri në 19 studime private psikologji e sociologji italiane, që njihja shumë pak, për arsye të programeve universitare franceze, që ishin shumë franceze. 19 deri 20 restorant; 20 deri 21 ose 22 shëtitje me shokët shqiptarë në bisedime politike, shoqërore, miqësije e tjera. 22 deri 24 lajmet me radio me të dy vëllezërit Agolli. Prej orës 00 deri 6.30 të mëngjesit gjumë.

Një jetë e rregullt lë kohë edhe për argëtim; një jetë e rregullt pasuron shumë magazinën e memories me njohuri të reja kulturore; një jetë e rregullt është kënaqja më e mirë e jetës, qoftë edhe pse artistët e mëdhenj thonë: me riprodhue me memorie njoftime të mësuara nuk është punë e madhe. Punë e madhe është me krijue gjëra të reja e vepra të panjohura prej mendjes së njeriut. Pas mendimit tim modest, mëndja më fisnike e njeriut është me njoftë, me shkue në thellësi të problemeve; me shtrue e me zgjidhë probleme, me kërkue me kureshtje të etuar misteret e natyrës, me zbulue sekretet e natyrës e gjithnjë me njoftë, me njoftë e me njoftë.

Tre muajt e Ventotenes më vlejtën me njoftë shoqërinë italiane, opinionin inglez, sepse ishin më se 50 inglezë të internuar dhe leximin e bluarjen (përvetësimin) e pothuaj njëqind volumeve të filozofisë italiane moderne...

Marrë nga libri "Ali Maliqi në historinë e Dibrës dhe Shqipërisë", botim i Shtëpisë Botuese BOTART.

Brezat që do të vijnë do të kujtojnë, nderojnë e do të kenë nevojë për njerëz të mençur e mendjendritur si Nezir Haxhi Selita i Matit.

Nezir Selita, njeriu i mençur i Matit

Nga **MEVLUD BUCI**


Të urtët popullorë u ngjajnë thesareve, sikur rilindin e jetojnë nëpër brezni. Ata lënë gjurmë mençurie, dritë mendje e zemre, dritë shpirti. Sot e kësaj dite si i thonë kur ndizen bisedat e odave në Mat, Dibër e më gjerë thonë më të moshuarit: Ka pas thënë Zirë Selita... Mendja e ndritur, kultura e odave, "akademia" e filozofisë matjane, dibrane e kombëtare u bë pronë e Nezir Haxhi Selitës, së Vinjollit të Matit. U lind, rrit dhe edukua në kullën e fisin bujar e trimëror të Selitës në Vinjoll të trevës së Lisit. Viti 1888 shënon lindjen e këtij burri të urtë e mendjehollë, fjalëpeshuar e tepër të thellë në mendime, urtësi e alegori të odës. Nezir Selita mësoi nga traditat e kullës e të fisit, nga odat e gjurmët e brezave të urtësisë matjane, dibrane e kudo. Kultura e të atit Haxhiut, e gjyshërve, kultura e dajave Ndregjonët e Lukanit të Dibrës ndikuan shumë në urtinë dhe zgjuarsinë, në "latimin" e kulturës së leme si i thonë të këtij filozofi popullor.

Rilindësi i madh Sami Frashëri thoshte: "Kur shteron pusi i dihet vlera ujit". Pra, jo vetëm ne, por edhe brezat që do të vijnë do të kujtojnë, nderojnë e do të kenë nevojë për njerëz të mençur e mendjendritur si Nezir Haxhi Selita i Matit.

KRENARI BREZASH...

Qysh në Mat e deri në Lukan rrëzë Runjës, kudo që kemi takuar nipin e Zire Selitës, Petritin, kemi parë krenarinë legjitime për gjyshin, nderimin dhe dashurinë e zjarrtë për të. Koha, familja, fisi e mbarë shoqëria më shumë se kurrë sot ka nevojë për dashuri, për lartësim të vlerave.

Petriti, nipi i organizator e i kudondodhur në ballë të punëve krenohet se 100 vjet pas lindjes gjyshit i lindi djali Erioni. Edhe bashkëshortja e Petritit; Lindita, bija e Koçit të Burgajetit, edhe tri vajzat dhe djali Erioni krenohen me dritëurtinë më të paharruar Zirë Selita. Edhe fëmijët e Zirës: Asllani, Bajrami, Rizaja, vajzat: Selvija e Mineja, nipat e mbesat krenohen me burrin e kullës, me gjurmët e provat e urtësisë të këtij burri të nderuar të Matit e të breznive. Gjurmë në fisin Selita kanë edhe Jashari, Nuzi, Sefa, Agimi, Aliu, të cilët kurdoherë janë krenuar me të urtin Zirë Selita. Është njerëzore, por edhe hyjnore dhe e domosdoshme që secili të lartësojë vlerat e të parëve. E thjeshtë, rrezatuese dhe gjurmëlënëse për bijtë e Selitës të Matit e më gjerë: krenari brezash...



TË KËNDOFTË ZEMRA XHOVALIN SHANA...

Tek po bisedonim në Mat në një mjedis me poetin e nderuar Esenian matjan Basir Bushkashi i kërkuam nipit të Zirë Selitës; Petritit të na tregojë nga fejsbuku këngën kushtuar këtij filozofi popullor. Vargjet, melodia dhe interpretimi mjeshtëror të ngjallnin emocione e krenari. E ka shkruar dhe e këndon këngëtari shkodran Xhovalin Shana. Autori ka gdhendur portretin e të urtit popullor, peshën e fjalës dhe dritën e mençurisë. Pas pak miku im Basir më tha: Bëjë një shkrim për Zirë Selitën në stilin tënd... Disi u zura ngushtë, por edhe e falënderova Basirin. Për këtë të urtë popullorë jo një këngë apo një shkrim, por mund të shkruhen libra, poema, poezi, tregime a monografi, sepse kanë prova e gjurmë mençurie, gjurmë që janë model urtie për brezat.

Kënga melodia dhe zëri i këngëtarit shkodran lartësonin figurën e birit të Matit e nipit të Dibrës Nezir Haxhi Selita. Cilido që e ndëgjon uron me të drejtë, me përzemërsi: Të këndoftë zemra Xhovalin Shana.

PROVAT E FJALËS DHE TË ALEGORISË

Dituria ka prova. E prova me e madhe është drita e pesha e fjalës, rrezatimi i urtisë e i maturisë. Nezir Selita ishte dhe mbeti burri i urtisë, i karareve, mjeshtri i fjalës e i alegorive, burri që luante mjeshtërisht me fjalën në valle të odave. Ishte i lindur për urti, për alegoritë, rrotullat retorikën, gjetjet filozofike nëpërmjet të cilave ai shpërfaqte dukuri të karakterit njerëzor, vlerat e veset e shoqërisë, traditat... Pothuajse i plejadës të të urtëve popullorë në Mat, ortak të urtësisë që përmenden si Kros Skura, Ibrahim Hoxha, Kurt Skura, Ibrahim Hoxha, Kurt Ruçi, Nurë Frangu, Sulë Bushi apo si Taf Kola, Mane Kacani, Selim Leshi, Mudë Hasi në Çidhën, Maliq Nikolli, Elez Murrja, Bajram Mera, Rrem Manuka, Beqir Uka, Sali Palluçi, Ibrahim Nikolli në Luzni, Dine Hoxha në Muhurr, Isuf Lala e Sali Duka në Qafëmurrë e plot të tjerë. Fjalët e alegoritë e Zirë Selitës përbëjnë një thesar të vërtetë, dëshmojnë talent e mençuri prej filozofi popullor. Shpesh sot ndëgjon të thonë: Ka thënë Zirë Selita: "I ligju ka gjuhë brrylash, i meri (i miri) ka gjuhë bylbylash", "Tri të mera (të mira) të japin burrni: kur ke besë, kur grue e fomi, shokë e miqësi", "Goja mjaltë, goja spece", "Trimi që asht trim ka maturi e guxim", "Burri e peshon veten e thotë vetëm të vërtetën", "Burri fol me karar, mba me vete metër, gërshanë e kanar". Janë të shumta fjalët monument të Zirë Selitës, apo retorikat, filozofike të odës, këto e plot të tjera mund e duhet të jenë objekt i një studimi të veçantë. Të një bukurie të rrallë janë edhe alegoritë, meselet, rrotullat në oda. Ato përmbajnë vlera, tone satirike, lartësojnë apo godasin me mana (me shifra) me hidh e prit. Në Qafëmurrë 85 vjeçari Bajram Dik Daçi na tregoi disa prej tyre.

***

Gjuha e urtisë e këtij mjeshtri të rrallë të fjalës përcillte mesazhe jete, mirësie, paqe, pajtimi. Çdo herë edhe mbronte me argumente, por edhe godiste me takt, me durim e humor dukuritë negative. Ishte i thellë, i matur, i qetë, vëzhgues i hollë e mbi të gjitha i respektuar, dashamir, i mprehtë, i drejtë e i prerë.

***

Këtu e mbi 50 vite kur isha mësues i ri i sapo dalë nga bankat e Normales së Elbasanit më thotë babai im (ndjesë pastë): Or bir sot na vjen Zirë Selita dhe Sufë Lala, shko e thirri të vijnë për darkë Dali Kurtin, Tafë Limanin e Allaman Saliun, të tre nga fisi Totraku edhe xhaxhai im i shtrenjtë (Bajram Buci). Nata e parë tek kulla ime dhe nata e dytë tek xhaxhai Bajrami (i dyti) pas Hoxhë Bucit, Molla Bajramit dëshmor i kombit me babë edhe djalë; rritur jetim tek Molla Liman Ndregjoni (prijs popullor – M.B). Duke ndëgjuar Zirë Selitën, Sufë Lalën, Totrakët, në odë të dukej vetja fare i vogël, por përbrenda meje më vlonte dashuria për fjalën e mençurisë për të urtit popullorë si Zirë Selita i Matit të barotit e nipi i Ndregjonëve të qëndresës, nipi i Dibrës trime. E nga zemra ime më burojnë vargjet e thjeshta për një vigan të urtësisë popullore:

... E ka vendin n'faqe t'librës / Mal ka fjalën edhe meritën / Biri i Matit e nipi i Dibrës / Lum, o Mat për Zirë Selitën..

Në kohëra e brezni rron e do të rrojë dritëurtësia e Zirë Selitës.

Shaqir Shaban Perhati tregon:

Isha në një dasëm tek Kalaverët në Urxallë të Matit. Bëmë muhabet sa u tund konaku gati gjithë natën. Të nesërmen, kur vija për Qafëmurrë në Qafë-Dardhë, në Viç ku ndahet udha këmbësore për Vinjoll më thotë vjehërri im Sefë Selita: "Or Shaqir fol ma kadalë me mue, mbrëmë ke folë dibrançe e na ke coptue. Kujdes se besa, ta mbaj nusen (ishte fjala për bijën e vet, Sarien, nusja e Shaqir Perhatit – M.B).

- Po si të duash, or mik, le të zgjedhë vajza vetë.

Ndërkohë që u ndanë Saria shkoi mbas burrit, Shaqirit...

Shaqiri kishte thënë në valle të odës: "Burri i mirë fol mirë e ban mirë, burri i keq fol mirë e punët haje dreq..."

Sa shkon Sefë Selita në shtëpi takon Zirën, i tregon ngjarjen si u ngatërrova me dhëndrin Shaqir Perhati nga Qafëmurra.

- Or Sefë e paskë nga (ke gabue me Perhatin). Ai ka folë me vend, pra, shko e kërkoi falje në shtëpi, në Qafëmurrë. A e din – thotë Zira, - përse i ka mbet Perhat? Sepse din! – vijoi Zira, - e ban spat, din me i da ujët në sfrat, ka prova fjale, sofre, lufte, pune e bese... Të nesërmen në mbrëmje Sefë Selita shkon tek kulla e Shaqir Perhatit në Qafëmurrë. Shaqiri fton gjithë kushërinjtë: Çupin, Aqifin, Ademin, Feritin, Sadikun etj.

Pasi ulen në sofër të bujarisë u thotë Sefa: Or miq kam ardhë t'i kërkoj falje dhëndrit tim Shaqirit se kararin ma ka da Zirë Selita im, se kisha nga mikun. Në odë vazhdoi humori e alegoria... Pra ky ishte Zirë Selita që kudo e kurdoherë ndante drejt, fjala e tij latonte edhe gurin, hijeshonte konakun, gëzonte zemrat e kthjellonte mendjet. Njerëz me vlera si Zirë Selita, janë pak, fare pak, këta lindin rrallë ndaj janë një vlerë e shtuar e familjes, fisit, trevës dhe e kombit, vlerë e çmuar për breznitë...

Alegori nga Nezir Selita

(Sipas tregimeve të Bajram Dik Daçit)

"Gjyshi – Halil Daçi (ish prijs popullor, burrë i urtësisë) kishte qenë një natë në Vinjoll ke kulla e Zirë Selitës... Në mëngjes i hip kalit në kurt (oborr) të Zirës pa u falë me Zirën. Në këtë kohë Zira iu mbështet një trungu peme...

- Ku shkon or Zirë? – i thotë Halili.

- Të hipi në pemë, or Halil e të të jap dorën se unë në tokë e ti në kalë me shalë s'un të mrre (nuk të arrij)...

Halili qeshi e menjëherë zbriti nga kali e u përqafue me Zirën...

***

Xhelal Neli nga Dibra shkon tek Zirë Selita në Vinjoll. Në bisedë e sipër i tha:

- Or Zirë ke pas do pasuri, por a ke ndërmend me ia lanë kujt?!

- Po, or mik – i thotë Zira, - por nuk kanë enë...!

***

"Sa qesh i ri mbolla arat e shokëve, kur fillova me mbjellë arën time nuk u poq, mbetën haliça për lopë, asnjë s'mbet me e fut në koshar".

Çmime shumë të mira për tirazhe 20-100 kopje

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 068 65 08 441

fotoreportazh

Njeriu që zgjonte shatërvanë…

Në kujtim të Bajram Stojkut, njeriut - NJERI…

…
Nga fotoarkivi i gazetarit

Ai iku duke lënë pas një emër me germa të mëdha: BAJRAM STOJKU.

Mbase, në nderin e tij, Këshilli Bashkiak i Dibrës, Rrugën e Stojkeve, siç emërtohet në gjeografinë e përditshme të banorëve të qytetit të Peshkopisë, autoktone me histori brezash trimërie e përkushtimi atdhetarë do ta përjetësojë me emrin "RRUGA BAJRAM STOJKU"…

Do të shkrihen në NJË e kaluara dhe e sotmja…

Unë e propozoj, nga larg në mërgim…



E kërkova në arkivin tim fotografik:

Të pasur në ato që kam fiksuar ndër vite…

Të varfër në ato që në udhëtimin tim larg e larg humbën për të mos u bashkuar kurrë…

Kërkova shumë…

E gjeta në një portret të 9 tetorit 2007…

E gjeta në një duet fotografik të po asaj dite…

Unë dhe Ai…

Ishim ulur në një lokal në hollin e ish Shtëpisë së Kulturës. Gjerbnim kafe, e në shije të saj, gjerbnim kujtime të kohës që jetuam maleve e fshatrave të Dibrës…

Nuk qe e thënë që të uleshim më së bashku…

Koha na ndau për të jetuar mes kujtimesh e respekti që vetëm Ai dinte të ta fuste në shpirt për ta marrë me vete tërë jetën.

Nuk do të shkruaj për Të se kur lindi e ku hodhi rrënjë jetës së tij të vrullshme.

Ai, ndër të tjera ishte njeri i DRITËS në profesion e në udhëheqje për ta bartur mbi shpinë deri në shtëpitë më të largëta maleve të Dibrës…

Nuk kam shkrepje aparati fotografik në portretin e tij, monopateve të dritës.

Kam një film të tërë kur zgjonte shatërvanë…

Nuk e kam kur shpërndante ujin e burimeve të Korabit në Sllovë, Shumbat, Sohodoll, Pilafe…



I shmangesh fotografisë, bujës në gazeta…

E kapa në Burimet e Kovashicës…

E kapa dhe nuk e lëshova…

Shik si Ai, gjithnjë veshur bukur, përherë me kollare e i qeshur, më erdhi dhe nuk po e mbaj për vete.

Bajram Stojku është pjesë e atij brezi që iu përkushtuan me mish e me shpirt Dibrës.

Vështrojini me përqendrim fotografitë…

Ato flasin, flasin, flasin…

Nuk pushojnë.

Bajram Stojku iku për të mbetur i nderuar dhe i respektuar për Dibrën dhe Dibranët.



Respekt për Të…

Respekt për familjen dhe të afërmit e Tij në gjak e gjini…

Abdurahim Ashiku

Athinë, 11 prill 2019



Dr. Ahmet Alliu

(1933 – 2019)



Ditët e fundit te Marsit, familjarët, shokët dhe miqtë nga Dibra, Tirana dhe e gjithë Shqipëria i dhanë lamtumirën e fundit njërit prej mjekëve më të shquar të Dibrës, shokut, mikut, kolegut, prindit dhe familjarit shembullor, njeriut tonë të dashur, Dr. Ahmet Alliut.

Do të duhej atë ditë të ishim mbledhur për ditëlindjen e tij, pasi ai u lind me 25 mars të vitit 1933, plot 86 vjet më parë, në familjen e Ramadan Alliut në fshatin Strikçan të Dibrës. Rridhte nga një familje shumë patriote e arsimdashëse e Grykës së Madhe dhe u rrit e u edukua me tiparet më të mira të një dibrani të mençur, të ditur dhe veçanërisht human. Ishte vëllai i mësuesit të mirënjohur të Dibrës e të gjithë Shqipërisë, mësuesit të popullit Selim Alliu, nga i cili mori mësime e edukim vazhdimisht.

Viti 1944 e gjeti në klasën e parë fillore në shkollën e Zerqanit, ku kreu arsimin fillor. Në vitet 1946-1948 kreu shkollën 7-vjeçare në Peshkopi dhe i ofruan të studionte në arsim. Por prirjet e tij e shtynë drejt një profesioni tjetër human, me të cilin do të lidhte jetën, drejt profesionit të mjekut.

Në vitin 1948 shkoi të studionte në Politeknikumin Mjekësor që sapo ishte hapur në Tiranë. E përfundoi atë në vitin 1952 dhe menjëherë shkoi të studionte në Institutin e lartë Mjekësor që u hap po atë vit dhe në vitin 1957 do të ishte mjeku i parë dibran i shkolluar në shkollën shqiptare dhe po ashtu Diploma Nr. 1 e Mjekut që lëshonte Fakulteti i ri i Mjekësisë në vendin tonë.

Shërbeu me devocion për më shume se 40 vjet në Dibër, si një mjek i kompletuar e i gjithanshëm, si patolog, pediatër, radiolog, anatomo-patolog, ekspert mjeko-ligjor dhe në çdo sektor tjetër të shëndetësisë ku pati nevoje për të.

U shqua si një mjek erudit, i aftë e kompetent, i pa lodhur asnjëherë, i gatshëm në çdo kohë. Në të katër cepat e Dibrës dhe më tej në Mat, ku nuk shkeli këmba e tij. I përgatitur profesionalisht dhe mjaft human, ai do të ishte ndër figurat më të spikatura e të dashura të mjekësisë dibrane, njeri që bëri epokë e la historinë e tij në zhvillimin e përparimin e saj.

Intelektual me interesa të gjera, njohës nga me të shquarit e letërsisë botërore e asaj kombëtare, por dhe i filozofisë, i muzikës, i historisë, i sportit dhe i artit. Ai do të fliste me dashuri për Dante Aligerin, Balzakun, Shekspirin, Eseninin, Niçen etj., por edhe për korifejtë e letërsisë e të historisë së Shqipërisë dhe ishte i gatshëm të recitonte në çdo kohë pjesë nga krijimtaria e tyre. Dr. Ahmeti ishte mik i mire i figurave të ndritura të mjekësisë shqiptare që nga Frederik Shiroka, Bajram Preza, Fejzi Hoxha, Selaudin Bekteshi, Besim Zyma, Hysni Rusi e Koço Poro, Mark Mirashi e deri te idhulli i tij Petrit Selenica. Ai ishte mik i mirë për të gjithë ne.

I pa përtuar në punë, hokatar në jetë, komunikues me të gjitha moshat e profesionet, ai do të ishte një figurë simpatike dhe e pëlqyer në çdo ambjent familjar dhe shoqëror ku merrte pjesë.

Dr. Ahmeti krijoi një familje model me mësuesen e mirënjohur Anastasi Alliun dhe rriti dy vajza të mirëedukuara e të shkolluara, Ilda dhe Anjeza Alliun.

I dashur në familje, i respektuar në profesion e shoqëri, i këndshëm në biseda e i thellë në mendime dhe me një humor që nuk i shterri kurrë, ky mund të ishte portreti më i shkurtër dhe më i plotë i tij.

U nda nga jeta në mënyre të papritur, kur familja dhe miqtë e tij ishin përgatitur për ta uruar në përvjetorin e 86 të lindjes. Fluturoi pa pritur si një zog që ka qëndruar në një degë peme dhe papritmas ngihet në fluturim dhe ikën drejt lartësive, drejt qiellit, drejt pafundësisë. Kështu iku dhe miku ynë.

Ahmet Alliu jetoi si princ dhe iku si mbret, pasi i kishte realizuar të gjitha synimet e tij në jetë. Do të na mungojë të gjithëve, veçanërisht familjes së tij, por dhe ne, miqve e shokëve dhe të gjithë atyre që e deshën dhe i deshi aq shumë.

Na mbetet thjeshte të krenohemi që ai ishte midis nesh dhe ne patëm fatin e mirë të ishim të dashurit e tij.

Për atë si jetoi e si u largua, për atë që bëri në jetë e na la si kujtim, Dr. Ahmet Alliu do të mbetet i pa harruar dhe do të kujtohet përjetësisht.

Lamtumirë miku ynë i shtrenjtë, dr. Ahmet Alliu.

Nazmi Koçi, Abdulla Hoxha, Tajar Petani, Xhevat Kotili

Tirane, 26 mars, 2018


Big market në Peshkopi 4 Maj

Oferta të shumta

















Ulje të mëdha

Hapur 7:00 AM - 10:00 PM

Unaza e Vogel Peshkopi, Dibër, Albania

bigpeshkopia@gmail.com

cyan magenta yelloë black